



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

RAPORT AUDITIMI

“Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet”.

NR	PËRMBAJTJA	Faqe
I	HYRJA (Të dhëna mbi Projektraportine auditimit) a. Objektivat e qëllimit b. Identifikimi i çështjes c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese d. Përgjegjësitë e audituesve e. Kriteret e vlerësimit f. Standardet e auditimit	
II	Përshkrimi i auditimit 1.Mbi sigurimin e mbikqyrjes së zbatimit të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik në tërësi, si dhe respektimin e procedurave ligjore nga ana e autoriteteve kontraktore, konform ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. 2. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit. 3. Organizimi dhe administrimi i të ardhurave jashtë buxhetore. 4. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. 5. Auditimi mbi prokurimin e fondeve publike. 6. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm 7.Të tjera çështje gjatë auditimit.	
III	Gjetjet dhe rekomandimet	
IV	Konkluzione dhe opinioni i auditimit	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

I. Hyrje

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 859/1, datë 11.9.2017 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 12.9.2017 deri në datë 15.11.2017, në subjektin Komisioni i Prokurimit Publik (këtu e në vazhdim KPP) Tiranë, u krye auditimi i përputhshmërisë me objekt “Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionët janë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet “

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi përputhshmërinë e aktivitetit të Komisionit të Prokurimit Publik (këtu e në vazhdim KPP) Tiranë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e parimeve të transparencës, argumentimit dhe arsyetimit të vendimeve të KPP-së, në përputhje me kërkesat e ligjit për prokurimet publike, aktet nënligjore në zbatim të tij si edhe bazës ligjore që rregullon e aktivitetin e institucionit. Zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në menaxhimin financiar dhe kontrollin, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, në miratimin e respektimin e strukturës organike dhe të nivelit të pagave sipas klasifikimit të funksioneve, në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, në administrimin e vlerave materiale e monetare, në prokurimin e fondeve publike etj.

a)Titulli. “Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionët janë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet “.

b)Marrësi. Komisionit të Prokurimit Publik, Tiranë.

c)Objektivat dhe qëllimi.

Objektivi i auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për zbatimin korrekt dhe me paanshmëri të Ligjit për Prokurimin Publik në vendimmarrjen e KPP në lidhje me ankesat e paraqitura pranë saj nga operatorët ekonomikë.

Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Raportimi i devijacioneve ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

Auditimi jonë ka për qëllim **promovimin e transparencës** duke ofruar raporte te besueshme mbi vlerësimin e aktivitetit të Komisionit të Prokurimit Publik në respektim të kuadrit ligjor rregullator në fuqi dhe të drejtave të subjekteve të ndryshëm ankimues.

Gjithashtu auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).

d)Subjekti i audituar: Komisioni i Prokurimit Publik është krijuar me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Komisioni i Prokurimit Publik është një organ shtetëror specifik, quasi-gjyqësor, me juridiksionin për të siguruar mbrojtje ligjore në prokurimin publik. KPP-ja ushtron funksionin e saj, sipas parimit bazë të prokurimit publik – transparencës.

Komisioni i Prokurimit Publik u krijua me qëllimin për të koordinuar sistemin e prokurimit publik në Shqipëri, me traditat ligjore të Bashkimit Europian.

Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj duke mbajtur parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 2, të këtij ligji edhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.

KPP-ja garanton mbrojtje ligjore për tenderuesit dhe *interesat publike* në të gjitha fazat e procedurave të prokurimit publik, koncesioneve, ankandeve dhe lejeve minerare.

Çështjet e audituara:

- 1.Mbi sigurimin e mbikqyrjes së zbatimit të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik në tërësi, si dhe respektimin e procedurave ligjore nga ana e autoriteteve kontraktore, konform ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- 2.Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
- 3.Mbi krijimin dhe administrimin e të ardhurave jashtë-buxhetore
- 4.Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.
- 5.Auditimi mbi prokurimin e fondeve publike
- 6.Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm
- 7.Të tjera çështje që dalin gjatë auditimit.

d) Identifikimi i çështjes.

Referuar çështjeve të audituara të cilësuar më sipër, objektivi kryesor është dhënia e një opinionin nëse nga strukturat përkatëse të këtij institucioni:

- janë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, mbi ankimet e drejtuara në KPP në lidhje me procedurat e prokurimit.
- janë përdorur fondet në funksion të veprimtarisë institucionale në përputhje me detyrimet ligjore,

e) Kriteret e vlerësimit.

- Kushtetuta e Shqipërisë, neni 162-163
- Ligji nr 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,
- Rregullore e procedurave të auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.107, datë 08.8.2017,
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- VKM 184, datë 17.3.2010.,
- VKM nr.914/2014 I NDRYSHUAR ETJ.

f) Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës janë:

- Standardet INTOSAI-t (ISSAI 4100,4200)
- eksperienca në terren (KPP).

g) Përgjegjësitë e audituesve. Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100 dhe 4200 ¹) e vlerësimit nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Audituesit në këtë Projektraport duhet të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjen që është nën këtë auditim.

¹ **1.ISSAI 4100** – Objektivi i audituesve në një auditim pnrputhshmërie nshtn tn japn siguri tn arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çnshtjeje tn veçantn nshtn në pnrputhje, në tn gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bñhet lidhur me çnshtje tn veçanta.

2.ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim pnrputhshmërie nshtn tn japn siguri tn arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çnshtjeje tn veçantn nshtn në pnrputhje, në tn gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

h) Kriteret e vlerësimit. Projekt Raporti duhet të identifikojë legjislacionin bazë e dytësor, dhe/ose dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu janë referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Mbi sigurimin e mbikqyrjes së zbatimit të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik në tërësi, si dhe respektimin e procedurave ligjore nga ana e autoriteteve kontraktore, konform ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1.1. Vendimi i KPP nr. 515, datë 31.7.2015 lidhur me procedurën e tenderit me objekt “Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga “Elbasan – Banjë”, Loti I”, me fond limit 874.138.927 lekë, zhvilluar në datën 02.06.2015, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH).

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “N. P” & “V.I.”

Objekti ankimimit:

- Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë (BOE) “N. P.V” & “V. I.”
- Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “V.H.” sh.p.k. & “V. E.” sh.p.k. nga Loti I i procedurës së mësipërme.

1.1.1. Parregullsi e konstatuar:

KPP pas shqyrtimit të dosjes, me vendim nr. 515, datë 31.7.2015 ka vendosur “Të mos pranohet” ankesën e BOE “N. P. V.” & “V. I.” sh.p.k.për skualifikimin e tij dhe kualifikimin e ofertës së BOE “V.H.” & “V. E.” në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në pikën 2.3. “Përvojat e mëparshme” dhe 2.3. germa “ç” të “Kapaciteti teknik” të pikës 2 të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” (KVK) të shtojcës 9, të miratuar me DST.

Në përgjithësi arsyetimi/vendimi i KPP, bie ndesh me:

- nenin 19/1 “Komisioni I Prokurimit Publik” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin public” I ndyshuar në të cilin është përcaktuar se ...

Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj...

- Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime mbi ankesat e paraqitura para tij, duke mbajtur parasysh, **përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 2, të këtij ligji edhe parimet e mëposhtme:** paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.

- Nenin 27/2 të VKM nr. 184, datë 17.10.2010 në të cilin është përcaktuar se ... Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve, apo veprimeve të tjera të AK gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre...



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

- nenin 28 pika 1/b, të VKM nr. 184, datë 17.10.2010, në të cilin është përcaktuar se ... *Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar ... Ndalimin e AK të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor... dhe mbështetur në pikën 2/d ... Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë AK për rifillimin e procedurës së prokurimit.*

Komisioni në dhënien e vendimit, nuk ka marrë në shqyrtim në tërësinë e tij objektin e ankimit dhe konkretisht pjesën e dytë që lidhet me shfuqizimin e vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e BOE “V. H.” & “V. E.” sh.p.k., oferta ekonomike e të cilit është 868.485.486 lekë, ose 76,054,343 lekë më të lartë se sa oferta e ankimuesit BOE “N.P.V I&V.I.”, i cili renditet i parafundit për nga vlera, ose 129,722,199 lekë më të lartë se sa oferta e ofertuesin “Albstar” sh.p.k. i cili ka paraqitur ofertën me vlerë më të ulët.

Argumentim:

1.1.1.1.1. Në datën 02.06.2015, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) si më poshtë:

- “A” sh.p.k. me vlerë 738.736.287 lekë, skualifikohet
- “C. S.EBG me vlerë 777.083.185 lekë, e cila është skualifikuar.
- BOE “N. P.V” sh.p.k. & “V.I.” sh.p.k. me vlerë 791.504.143 lekë, e cila është skualifikuar.
- BOE “V. H.” sh.p.k. & “V E” sh.p.k. me vlerë 868.485.486 lekë (ose 0.6 për qind me pak se sa fondi limit), e cila është kualifikuar e në vijim është shpallur fituese e tenderit.

Në datën 12.06.2015 bashkimi i operatorëve ekonomikë “N. P. V” sh.p.k. & “V. I.” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

1.1.1.1.2. Për këtë përfundim të AK, BOE “N. P.V” sh.p.k. & “V. I.” sh.p.k. në datën 18.06.2015 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e saj me arsyetimin se ...

1.1.1.2.1. dokumentacioni i saj është i plotë, në zbatim të DST të kërkuara,
kurse,

1.1.1.2.2. Dokumentacioni ligjor kualifikues i BOE “V. H. sh.p.k. & “V. E” sh.p.k. nuk është i plotë/I rregullt pasi ai nuk plotëson kriteret e kërkuara në KVK, pikën 2.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim kapaciteti teknik në lidhje me eksperiencat e mëparshme.

- Operatori ekonomik V. H. nuk plotëson kriterin në lidhje me kontratat e ngjashme pasi dokumentacioni i paraqitur prej tij për plotësimin e këtij kriteri nuk është i vlefshëm.

- Kërkojmë nga AK verifikimin e të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga V. H. sh.p.k. & V. E sh.p.k. në lidhje me mjetet, pasi ky operator nuk i disponon këto mjete ... dhe për këtë arsye, KVO duhet ta skualifikonte

1.1.1.3. AK datë 01.07.2015, me shkresën nr. 5414/3 prot., datë 26.06.2015 i ka kthyer përgjigje, duke e refuzuar ankesën.

1.1.1.4. BOE ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik datë 03.07.2015 me të njëjtin objekt, nëpërmjet së cilës ka kundërshtuar skualifikimin e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit si edhe kundërshton kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “V. H.” sh.p.k. & “V.E.” sh.p.k.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

1.1.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik ka marrë në shqyrtim në themel objektin e ankesës të BOE ankimues.

KPP në lidhje me pretendimet e BOE ankimues “N. P. V” sh.p.k. & “V. I.” sh.p.k. është shprehur me vendim nr. 515, datë 31.7.2015. Në pjesën arsyetuese të tij, KPP është shprehur se ... dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “N. P V” sh.p.k. & “V. I.” sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ... për këtë arsye nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “N. P.V” sh.p.k. & “V. I.” sh.p.k” nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “N. P.V.” sh.p.k. & “V. I.” sh.p.k., për kualifikim të padrejtë të BOE “V. H.” sh.p.k. & “V. E” sh.p.k.

Komisioni i Prokurimit Publik ka sqaruar se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (përkundrejt atij imagjinar) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi

Për rrjedhojë, ky pretendim i bashkimit të operatorëve ekonomikë “N. P V” sh.p.k. & “V. I” sh.p.k. nuk merret në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet. Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “N. P.V” sh.p.k. & “V. I.” sh.p.k. për procedurën e prokurimit me objekt: “Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga “Elbasan – Banjë”, Loti I”, duke e lejuar AK të vazhdojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.

1.1.1.6. KPP me këtë arsyetim/vendim, në përgjithësi bie ndesh me:

- nenin 19/1 “Komisioni i Prokurimit Publik” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin public” I ndryshuar në të cilin është përcaktuar se ...

1.1.6.1. Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, **në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.**

1.1.1.6.2. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime mbi ankesat e paraqitura para tij, duke mbajtur parasysh, **përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 2**, të këtij ligji edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit (në nenin 2 “Parimet e përgjithshme” të fituesve ... është parashikuar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

ndër të tjera ... **mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve).**

- Nenin 27/2 të VKM nr. 184, datë 17.10.2010 në të cilin është përcaktuar se ... *Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve, apo veprimeve të tjera të AK gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre...*

- nenin 28 pika 1/b, në të cilin është përcaktuar se ... *Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar ... Ndalimin e AK të vazhdojë veprimet e palijshme, duke l caktuar një afat kohor... dhe mbështetur në pikën 2/d ... Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të ushëzojë AK për rifillimin e procedurës së prokurimit.*

Mbështetur në sa më sipër, KPP ka për detyrë minimalisht të shqyrtojë në themel “Ankimimin”, të paktën për OE ankimues dhe OE që rezulton fitues I procedurës së prokurimit.

Mos shqyrtimi i ankesës në themel, ka krijuar premisa për vendimmarje jo të sakta nga KPP, të cilat kanë çënuar përzgjedhjen e OE fitues të kontratave publike në përputhje me parimet e përgjithshme të përzgjedhjes, shpeshherë të shoqëruara më dëm ekonomik.

KPP megjithëse në vendim është shprehur se ... *baza ligjore mbi të cilën shqyrtohet ankesa është ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues ... Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”nenin 28 e të tjerë, ... Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues... rezulton se sa më sipër, **nuk është konsideruar** në vendmarrje.*

KPP në rastin konkret, padrejtësisht nuk ka marrë në shqyrtim ankesën e OE “K.C” sh.p.k. për kualifikim të gabuar nga KVO të BOE “V. H.” sh.p.k. & “V. E.” sh.p.k. i cili është klasifikuar i pari dhe në vijim është shpallur fitues i procedurës së tenderit.

1.1.1.7. U verifikua plotësia/saktësia e dokumentacionit të paraqitur nga BOE “V. H.” sh.p.k. & “V. E.” sh.p.k. që është shpallur fitues dhe u konstatua se nuk plotëson disa nga elementët e kërkuar në pikën 2.3. të KVK, shtojca 9 të miratuara me DST si më poshtë:

1.1.7.1. OE “V. H.” sh.p.k., nuk plotëson kriterin:

a. *“Kapaciteti teknik” për “punë të ngjashme” për një object me vlerë jo më të vogël se 300,000,000 lekë që është realizuar gjatë tre viteve të fundit ... për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, të paraqitet vërtetim ilëshuar nga një ent public... formulari I v conform shtojcës 8 si dhe kopje e kontratës së nënshkruar më autoritetin kontraktor.*

Për realizimin e këtij kriteri, sipas dokumentacionit (përfshirë CD) që ndodhet në dosje, OE “V. H.” sh.p.k., ka paraqitur:

- një kontratë me object “Sistemim asfaltin rruga e Gjinarit” lidhur datë 3.2.2009 midis ARRSH dhe shoqërisë “A” sh.p.k. e cila përfaqëson bashkimin e përkohshëm të shoqërive “A” sh.p.k. dhe “V. H.” sh.p.k. ... e cila është firmosur nga përfaqësuesi i ARRSH dhe OE “A” sh.p.k. Vlera e kontratës pa TVSH është 347,016,953 lekë. Sipas Akt marrëveshjes noteriale datë 1.12.2008 lidhur midis palëve, OE “A” sh.p.k. do të kryente 90 për qind të punimeve ose 312,315,258 lekë, kurse dhe OE “V. H.” sh.p.k. do të kryente 10 për qind të vlerës së punimeve, ose 34,701,695 lekë.

I njëjti raport në kryerjen e punimeve do të ruhej edhe për “Shtesë kontrate” me vlerë 69,403,852 lekë gjithsej.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

- Vërtetim nr. 3,973 , datë 8.5.2015 I lëshuar nga ARRSH me object “Vërtetim punimesh” drejtuar shoqërisë “V. H.” sh.p.k. sipas të cilit ... *Punimet për objektin “Sistemim asfaltim rruga e Gjinarit janë kryer nga OE “V. H.” sh.p.k. në masën 93,39 për qind mbështetur në akt marrëveshjen nr. 2982, datë 11.5.2010. Bashkëngjitur është formulari i vlerësimit I plotësuar (shtojca 8).*

Në formularin e “Vlerësimit” të lëshuar nga ARRSH, në seksionin “Bashkimi I OE dhe përshkrimi I punëve të kryera nga secili anëtar, është përcaktuar: “A” sh.p.k. 90 për qind dhe “V. H.” sh.p.k. 10 për qind dhe po aty .. Nënkontraktorët “V. H.” 93,39 për qind.

Nga sa më lart konstatohet se OE “V. H.” sh.p.k. kanë paraqitur “punë të ngjashme” me vlerë rreth 35,000 mijë lekë, ose rreth 12 për qind të vlerës së kërkuar nga AK., për këtë shkak KPP (dhe më parë AK) duhet të kishin skualifikuar OE “V. H.” sh.p.k.

KPP në dosje ka pasur gjithë dokumentacionin e nevojshëm që të vërtetonte se ky “Vërtetim për kryerje punimesh” ishte i pavërtetë, jo vetëm nga mënyra kontradiktore që është plotësuar formulari i vlerësimit, por mjafton që të lexohesh kontrata bazë dhe kontrata shtesë për “Shtesë punime” lidhur/firmosur midis ARRSH dhe OE “A” sh.p.k., në të cilin OE “V. H.” sh.p.k. nuk ka firmosur, pasi është përfaqësuar nga OE “A” sh.p.k.

Bashkëngjitur në dosje gjenden dhe një numër I mjaftueshëm dokumentesh të tjerë që vërtetojnë se OE “V.H.” sh.p.k. manipuluar, abuzuar me dokumentacionin, për të plotësuar këtë kriter padrejtësisht si:

- “Kushtet e veçanta”, në të cilat padrejtësisht gjendet dhe një vulë e “V.H.” sh.p.k.

- Akt marrëveshje për nënkontraktim punimesh, e noterizuar nr. 1296 rep, datë 5.2.2009, lidhur midis OE “A” sh.p.k. dhe OE “V.H.” sh.p.k. sipas së cilës *Punimet për objektin “Sistemim asfaltim rruga e Gjinarit” me vlerë 388,908,466 lekë me TVSH merr përsipër t’i kryejë OE “V.H.” sh.p.k. sipas preventivit të kësaj akt marrëveshje.*

- Akt marrëveshje për nënkontraktim punimesh, e noterizuar nr. 2982 rep, datë 1.5.2010, lidhur midis OE “A” sh.p.k. dhe OE “V.H.” sh.p.k. sipas së cilës (Neni 1) *pala e parë merr përsipër të kryej 466,728,840 lekë që kap 93,393244 % me TVSH të vlerës së plotë të kontratës dhe 6,606756 % të vlerës për “Arifaj” sh.p.k.*

-Deklaratë noteriale nr 307 rep , datë 31.01.2011 lidhur midis OE “A” sh.p.k. dhe OE “V.H.” sh.p.k. për pagesa të ndryshme etj.

b. Nuk ka paraqitur autobot uji. Si të tillë ka paraqitur një makine vetshkarkuese me kapacitet 32 ton, me targë EL 3523 C dhe një fatuë që ka blerë një çisternë. Sa më sipër nuk plotëson kriterin e kërkuar.

- nuk ka paraqitur “Vinç” me kapacitet 10 ton, nuk e ka as në deklaratën “Mbi disponimin e mjeteve” shtojca 9 e KVK të DST.

- Nuk ka paraqitur “çekiç pneumatic”. Për të tillë ka paraqitur një faturë blerje “eskavator me goma” dhe një çekiç pneumatic”. Eskavatori nuk është i shoqëruar me fotografi dhe dokumentacionin përkatës si “leje qarkullimi, siguracion” etj.

Për “çekiçin pneumatic” ka një foto vetëm për pjesën goditëse të çekiçit.

- Nuk ka paraqitur mjetin “Impiant për prodhimin e asfalt rubber-sipas standardit ASTM 6114”.

Për të tillë ka paraqitur kontratë qiraje nr.869 rep dhe nr.523 kol, datë 28.5.2015, si dëshmi për “Impiant për prodhimin e asfaltit rubber sipas standardit ASTM 6114”, e cila është marrë në konsideratë nga KVO. Kontrata e qirasë është lidhur me qiradhënës shoqërinë “R.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

S.P.A.ALBANIA-Degë e shoqërisë së huaj në Shqipëri”, pikërisht për mjetin “impianit i prodhimit të asfaltit*rub metodo ëet astm 6114* makineri perzjerje bitumi e përdorur” document i cili është paraqitur dhe në lotin 3 nga ky operator.

Gjithashtu dhe dëshmia për disponimin e këtij mjeti, të paraqitur nga R. S.P.A. Albania për lotin 3 dhe kontrata e qirasë lidhur me R. Albania, paraqitur nga Operatori ”V. H.” për lotin 1, nuk mund të merren në konsideratë nga KVO, pasi jemi në kushtet e nenit 65 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Ndërhyrje në ofertë”. Për më tepër në DT shtojca 10, pika 2.3/ç në mënyrë eksplicite thuhet se “Administratori i shoqërisë ofertuese duhet të paraqesë deklaratë që makineritë e mësipërme nuk do të jenë **të angazhuara në kontrata të tjera** por vetëm për këtë objekt si dhe nuk janë deklaruar në procedurë tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi”. Në respect të kësaj kërkesë të AK si për lotin 1 ashtu dhe për lotin 3, nuk ka deklaram nga administratorët e shoqërive respektive ”V.H.” dhe R. Spa Albania që konkurrojnë me të njëjtin mjet (shih të dhënat në dokumentet përkatëse). Për pasojë, nga KVO nuk janë respektuar dispozitat e nenit 65 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Ndërhyrje në ofertë” si dhe DT, shtojca 10, pika 2.3/ç. Përbërja e KVO është e njëjtë në dy lotet e zhvilluara në të njëjtën ditë. Në kushte të tilla të dy këta BOE duhet të ishin skualifikuar automatikisht për mos plotësim të këtij kriteri.

Theksojmë se konstatimi i sipërm, është trajtuar dhe në Raportin Përfundimtar të auditimit të ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, në zbatim të programit të auditimit nr.787/1, datë 10.9.2015 (më hollësisht është trajtuar në auditimin e vendimit të KPP nr. 516, datë 31.7.2015).

Sa më sipër nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2.3. germa “ç” të shtojcës 9 “Mbi disponimin e makinerive”, të KVK ët miratuara me DST, për rrjedhojë KPP (më parë KVO) duhet të kishte skualifikuar OE “V.H.” sh.p.k.

1.1.7.2. OE “V. E” sh.p.k., nuk ka paraqitur (nuk i ka as shtojcën 9 “Mbi disponimin e makinerive”:

- “Impiant për prodhimin e asfaltit rubber sipas standardit ASTM 6114”,
- Mjet për vendosje parmakë (guardrail),
- Mjet për vizim.

Sa më sipër nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2.3. germa “ç” të shtojcës 9 “Mbi disponimin e makinerive”, të KVK të miratuara me DST, për rrjedhojë KPP (më parë KVO) duhet të kishte skualifikuar OE “V.E.” sh.p.k.

KPP nisur nga sa më sipër, duke ruajtur të njëjtin standard, mbështetur në në mangësitë/parregullsitë në dokumentacionin ligjor kualifikues të përshkruar duhet të skualifikonte BOE “V.H.” sh.p.k. & “V.E.” sh.p.k.

Në përfundim, duke ju referuar të gjithë konstatimeve sa më sipër, në kushtet kur ankuesi “N.P V. & V. I.” i renditur sipas vlerës i parafundit, si dhe BOE “V.H.” sh.p.k. & “V.E.” sh.p.k. i renditur sipas vlerës i fundit, nuk plotësojë kushtet për kualifikim, duhet të ishin skualifikuar dhe procedura duhet të ishte anuluar sipas kërkesave të nenit 24, pika 1/ç të LPP-së.

Konkluzion: Për sa sipër konstatuar, Vendimi nr. 515, date 31.7.2016 i KPP-së nuk është në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik neni 19/1, pika 3, VKM nr.184, date 17.3.2010 neni 27, pika 2, neni 28 si dhe DT të miratuar nga AK (ARrSH)-Kriteret e vecanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3, germa ç, pasi Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim sipas objektit të ankimit, pretendimin e BOE ankimes për shfuqizimin e vendimit të Autoritetit Kontraktor në lidhje me kualifikimin pa të drejtë të BOE “V.H.” sh.p.k. & “V.E.” sh.p.k. nga KVO, oferta e të cilit pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit rezulton se, nuk përmbush kriteret e vendosura në DT “Kapaciteti teknik”, duke lënë në fuqi kualifikimin pa të drejtë BOE



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

“V.H.” sh.p.k. & “V.E.” sh.p.k. nga Autoriteti Kontraktor”, me vlerë oferte më të madhe se oferta e ankimuesit me diferencë prej 76,981,343 lekë (duke e krahasuar me ofertuesin “Albstar” sh.p.k. i cili ka paraqitur ofertën me vlerë më të ulët, diferenca është 129,749,199 lekë). Ndodhur në këto kushte, Komisioni në vendimmarrjen e tij si pasojë e mosshqyrtimit të ankimit në tërësinë e objektit të tij, nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë operatorët ekonomikë pjesmarrës në prokurim dhe pse çështja ka karakter publik dhe ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimit të autoritetit Kontraktor (ARrSH), duke sjellë dëm në buxhet. Për sa sipër mban përgjegjësi Komisioni i përbërë nga **G. K.-Kryetar, S. K, L. G dhe H.B.** (J. H. ka dhënë mendim kundër).

(Shënim: Në këtë rast vlen të evidentohet gjykimi/vendimi i KPP nr. 692/2015 datë 16.11.2015, në të cilin OE “J. C.” sh.p.k. është skualifikuar me argumentin se ... *mjeti ekskavator me gomë, nuk është i pajisur me certifikatën e kontrollit teknik* ... megjithëse oferta e tij ishte më e ulët se sa e OE të kualifikuar nga KPP, i cili në vijim është shpallur fitues i procedurës së prokurimit. Ky rast është trajtuar hollësisht në akt konstatimin nr. 1 mbajtur me KPP.

Sa më sipër është trajtuar në akt - konstatimin nr. 5, datë 15.11.2017 mbajtur me z. G.K-Kryetar, S. K. zv/kryetar, L. G. dhe H. B. anëtarë).

1.1.8. Z. H. B. me shkresë nr.1700/5, datë 22.11.2017 përmbledhur, ka bërë komente/shpjegime si më poshtë:

Nga shqyrtimi I pretendimeve të BOE “N.P V & V. I.” sh.p.k. në lidhje me skualifikimin e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit nga KPP është analizuar dhe arsyetuar se ky OE mbetet i skualifikuar në këtë procedurë për shkaqet e arsyetimit të dhëna nga AK. Ky fakt është pranuar edhe nga grupi i auditimit, përse kohë që nuk janë shprehur fare në lidhje me shkaqet e skualifikimit të tij. KPP në rastet kur një OE i skualifikuar paraqet ankesë pranë KPP ku ngre pretendime në lidhje me skualifikimin e tij dhe më pas pretendon kualifikimin e gabuar të OE të tjerë, ka mbajtur një qëndrim konstant e të pandryshueshëm se në rast se ankimuesi mbetet i skualifikuar atëherë pretendimet e tij në lidhje me OE të tjerë, nuk merren në shqyrtim pasi ai nuk legjitimohet... Mbështetur në nenin 63 pika 1 e ligjir 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar ... I njëjti argumentim vlen edhe për vendimin e KPP nr. 516, datë 31.7.2015.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së: Komentet/shpjegimet e dhëna nga anëtarë i KPP për vendimin nr. 515 datë 31.7.2015, nuk prekin argumentet e paraqitura hollësisht nga audituesit në Akt konstatim dhe projektraport, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e anëtarit të KPP, **nuk qëndrojnë.**

1.2. Vendimi nr. 516/2015, datë 31.07.2016 me të dhënat si më poshtë:

Ankues	Objekti	F. limit pa TVSH	VL. Ofertes ankues	Dif. OE fitues dhe ankuesit	Pranuar/Jo
NPI&V. I.	Riveshje dhe sistemim asfal.rruga Elbasan-Banjë Loti 3 (AK-ARrSH)	980,844,927	848,658,756	101,181,925	jo

Objekti i ankimit: “Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “N. P V.” sh.p.k. & “V. I.”sh.p.k. nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt: “Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga “Elbasan – Banjë”, Loti 3”, me fond limit 980.844.927 lekë (pa TVSH), nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar. Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “R. spa Albania”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

sh.p.k. & “E”, nga Loti 3 i procedurës së mësipërme të prokurimit”, **nuk është në përputhje me:**

-legjislacionin e prokurimit publik-ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 19/1, pika 3,

- VKM nr.184, datë17.3.2010 neni 27, pika 2 dhe neni 28.

Argumentat:

Me Vendimin **nr. 516, date 31.7.2016** Komisioni ka vendosur:

“1.Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “N.P. V.” sh.p.k. & “V. I” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt: “Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga “Elbasan – Banjë”, Loti 3”, me fond limit 980.844.927 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 02.06.2015, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3.....
4.....”.

Nga auditimi i materialeve të dosjes konstatohet se:

Komisioni në dhënien e vendimit, nuk ka marrë në shqyrtim në tërësinë e tij objektin e ankimit dhe konkretisht pjesën e dytë që lidhet me shfuqizimin e vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “R. spa Albania” & “E”, i cili ka vlerën më të lartë të ofertës 949,840,681 lekë se ankimuesi “N.P. V&V. I.” me vlerë 848,658,756 lekë (diferenca mes tyre **101,181,925** lekë).

Komisioni në lidhje me këtë fakt argumenton se:

1.2.1. “Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm. Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur,operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Për rrjedhojë, ky pretendim i bashkimit të operatorëve ekonomikë “N.P V” sh.p.k.& “V. I.” sh.p.k. **nuk merret në shqyrtim**, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet”.

Për sa sipër, **KLSH** konstaton se:

1.2.2. Në respekt të nenit 19/1, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime **Komisioni**, ka detyrimin “të marrë vendime në lidhje mbi ankesat e paraqitura para tij, duke mbajtur parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 2, të këtij ligji edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit”.

Komisioni si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, ka detyrimin ligjor të bëjë vlerësimin e ankesave mbi bazën e parimeve të mosdiskriminimit të pjesëmarrësve në tender, transparencës në procedurat e prokurimit etj. Vlerësimi i ankesave bëhet mbi bazën e vlerësimit të kriterëve të vendosura në Dokumentet e Tenderit (DT), respektimit të procedurës nga Autoritetet Kontraktore në mënyrë që, procesi i shqyrtimit të ankesave të bazohet në verifikimin dhe vlerësimin e veprimeve/vendimeve të AK në Sistemin Elektronik të Prokurimeve, me qëllim shmangien e diskriminimit apo vlerësimit subjektiv. Në këtë këndvështrim, Komisioni për aq kohë sa merr në shqyrtim vlerësimin e kualifikimit/skualifikimit të BOE ankimes, që në kuptim të nenit 1 të LPP-së qëllimi i ligjit është ndër të tjera “të sigurojë mirëpërdorimin e fondeve publike” duhet të bëjë njëkohësisht dhe vlerësimin e kualifikimit/skualifikimit të BOE të shpallur fitues, që është edhe objekt i ankimit të BOE “N.P V & V. I.”, në mënyrë që të detyrojë autoritetin kontraktor të korrigjojë vendimet/veprimet e tij. Në rastin konkret, Komisioni duhet të marrë në konsideratë shqyrtimin e kualifikimit të BOE “R. spa Albania” & “E”, pasi çështja merr karakter publik në kuptim të mirëadministrimit të fondeve buxhetore.

Gjithashtu neni 63, pika 1, e LPP-së nuk çënon të drejtën e askujt që ka interes në një procedurë prokurimi (jo vetëm ankuesit) të ankohet ndaj vendimeve të autoritetit kontraktor.

Më tej, bazuar në nenin 27, pika 2 të VKM nr.184, datë 17.3.2010 “Kufijtë e shqyrtimit të ankesës”, sipas të cilit “Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre” dhe pika 1. Në këtë kontekst, objekti i ankesës ka lidhje me veprimet/vendimin e autoritetit kontraktor dhe për këtë qëllim ankesa duhet të ishte marrë në shqyrtim, përse i takon kualifikimit të BOE “R. spa Albania” & “E”.

Gjithashtu Komisioni ka vepruar në kundërshtim dhe me nenin 28, pika 1/b dhe 2/b,d të VKM nr.184, datë 17.3.2010, pasi duke mos shqyrtuar çështjen në themel nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e neneve të sipërcituar.

1.2.3. Nisur nga fakti që objekt i ankimit është edhe shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së BOE “R. spa Albania” & “E” që në këtë proces ka vlerë oferte më të lartë se ankimesi, KLSH pas auditimit të dokumentacionit të këtij BOE si dhe pretendimeve të ankuesit konstaton se:

1.2.4. Pretendimi i ankuesit se “.....Kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacionin e shtetit të origjinës të pa vulosur me vulë apostile...” nuk qëndron, pasi nga auditimit në SEP I dokumentacionit të këtij BOE, rezulton të jetë i vulosur me vulë apostile dhe i noterizuar sipas kërkesave të ligjit.

1.2.5. Lidhur me pretendimin se “... operatori nuk plotëson elementin kryesor-punë të ngjashme” konstatohet se:

OE “R. spa Albania”, si pjestar i bashkimit të operatorëve ekonomikë “R. spa Albania” & “E” në raportin 70.64% sipas kontratës së bashkëpunimit nr. Rep. 3597, nr. kol. 1668, datë 28.5.2015, nuk përmbush kriterin për **“punë të ngjashme** për një objekt të vetëm në vlerë jo më të vogël se 300,000,000 lekë që është realizuar gjatë tri viteve të fundit (2012, 2013, 2014)”, shtojca 10, pika 2.3/a “Kapaciteti teknik” të Dokumenteve të Tenderit (DT) me arsyetimin si më poshtë:

Operatori i regjistruar në QKR (sot QKB) si degë e shoqërisë së huaj në Shqipëri, ka paraqitur për punë të ngjashme kontratën datë (e palexueshme në SEP) gusht 2007 e lidhur mes Bashkimit të Operatorëve ekonomikë “R. L. S.P.A. (shoqëria mëmë) & Konsorciumi i kooperativave të Ndërtimit & S. s.r.& S. s.r.l. dhe Komunës së Pistoias (Itali) me vlerë 12,000,000 euro (pjesa e parë), në të cilën operatori R. SPA ka 49% të punimeve. Sipas kontratës, afati i fillimit të punimeve është datë 2.9.2008 me kohëzgjatje 450 ditë, punime të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

cilat kanë përfunduar (pas disa pezullimesh) me datë 15.12.2010, vërtetuar me procesverbalin mbajtur po këtë datë. Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se operatori “R.spA Albania” ka paraqitur kontratë për punime të ngjashme/punim të ngjashëm që nuk është realizuar gjatë tri viteve të fundit, pasi sipas kontratës së lidhur në vitin 2007, punimet kanë mbaruar në vitin 2010, vit i cili nuk përfshihet brenda periudhës 3 vjecare të kërkuar DT. Për pasojë, OE Rosi nuk ka përmbushur këtë kriter që është kusht skualifikues për operatorin.

1.2.6. Lidhur me pretendimin tjetër se “...operatori nuk disponon në pronësi ose me qira Impiant të prodhimit të bitumit....” konstatohet se:

Operatori referuar pikës 2.3/ç “Kapaciteti teknik” për mjetin “Impiant për prodhimin e asfalt rubber-sipas standardit ASTM 6114” ka paraqitur:

-akt zhdoganimi datë 25.5.2015 për “impiant i prodhimit të asfaltit*rub metodo wet astm 6114* makineri perzjerje bitumi e përdorur (matrikull 061506) copë 1,

-urdhër clirimi nga zyra doganore 321-Tiranë për “Impiant i prodhimit të asfaltit*rub copë 1”,

-faturë datë 18.5.2015, nga R. L. SPA për R.spA Albania për (Impiant prodhimi bitumi asfalt rubber metoda wet astm 6114&impant perzjerës lëndësh minerale dhe bitumi) cop1.

Në faturë të rubrika “Lloji i operacionit” është cilësuar në mënyrë eksplicite “*Transferim i pajisjes sonë nga selia italiane për filialin tonë në Shqipëri*”.

-Faturë shitje në emër të shoqërisë “R. L. S.P.A. me nr.C1102590207, datë 13 gusht 2011për “Impiant asfalt rubber (Asfalt gome) 1 njësi, nga shoqëria Zhejiang Machinery&Equipment I/E CO.LTD.Fatura (nuk është faturë tatimore) nuk shoqërohet me akt zhdoganim (hyrje në Shqipëri) dhe për më tepër nuk ka asnjë akt qiraje/përdorim nga pronari “R. L. S.P.A. Për pasojë, dokumenti (fatura) nuk merret në konsideratë.

Njëkohësisht në lidhje me dokumentacionin e paraqitur më sipër, konstatohet se ankuesi ka bërë ankim dhe për skualifikimin e tij për lotin 1, me të njëjtin object tenderimi dhe me të njëjtin pretendim si më sipër se “...operatori nuk disponon në pronësi ose me qira Impiant të prodhimit të bitumit....”, për të cilin Komisioni ka marrë Vendimin nr.515, datë 31.7.2015. Nga krahasimi dhe auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori fitues në lotin 1, për këtë fakt konstatohet se:

-Operatori Ekonomik”V.H.” anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë “V.H.&V.E.”, ka paraqitur kontratë qiraje nr.869 rep dhe nr.523 kol, datë 28.5.2015, si dëshmi për “**Impiant për prodhimin e asfaltit rubber sipas standardit ASTM 6114**”, e cila është marrë në konsideratë nga KVO. Kontrata e qirasë është lidhur me qiradhënës shoqërinë “R. S.P.A.ALBANIA-Degë e shoqërisë së huaj në Shqipëri”, pikërisht për mjetin “impiant i prodhimit të asfaltit*rub metodo wet astm 6114* makineri perzjerje bitumi e përdorur” document i cili është paraqitur dhe në lotin 3 nga ky operator.

Gjithashtu dhe dëshmia për disponimin e këtij mjeti, të paraqitur nga R. S.P.A. Albania për lotin 3 dhe kontrata e qirasë lidhur me R. Albania, paraqitur nga Operatori ”V.H.” për lotin 1, nuk mund të merren në konsideratë nga KVO, pasi jemi në kushtet e nenit 65 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Ndërhyrje në ofertë”. Për më tepër në DT shtojca 10, pika 2.3/ç në mënyrë eksplicite thuhet se “*Administratori i shoqërisë ofertuese duhet të paraqesë deklaratë që makineritë e mësipërme nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por vetëm për këtë objekt si dhe nuk janë deklaruar në procedurë tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi*”. Në respect të kësaj kërke të AK si për lotin 1 ashtu dhe për lotin 3, nuk ka deklaram nga administratorët e shoqërive respektive ”V.H.” dhe R.spA Albania që konkurrojnë me të njëjtin mjet (shih të dhënat në dokumentet përkatëse). Për pasojë, nga KVO nuk janë respektuar dispozitat e nenit 65 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Ndërhyrje në ofertë” si dhe DT, shtojca 10, pika 2.3/ç. Përbërja e KVO është e njëjtë në dy lotet e zhvilluara në të njëjtën ditë. Në kushte të tilla të dy këta BOE duhet të ishin skualifikuar automatikisht për mos plotësim të këtij kriteri.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Theksojmë se konstatimi i sipërm, është trajtuar dhe në Raportin Përfundimtar të auditimit të ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, në zbatim të programit të auditimit nr.787/1, datë 10.9.2015.

1.2.4. Të tjera dokumente që mungojnë:

-leje nga QKL për “fabrikë betoni” në kundërshtim me pikën 2.3/ç shtojca 10,

-faturë tatimore, akt zhdoganimi dhe kontratë shitblerje për mjet për vendosje parmakësh metalik dhe mjet për vijëzim, të cilat janë marrë me qira sipas kontratës nr.343 rep. nr.546 kol, datë 26.5.2015 lidhur me shoqërinë “B X”.

Në përfundim, duke ju referuar të gjithë konstatimeve sa më sipër, në kushtet kur ankuesi “N.P Victoria Invest International&Victoria Invest” si dhe BOE “R.spa Albania” & “E”, nuk plotësojnë kushtet për kualifikim, duhet të ishin skualifikuar dhe procedura duhet të ishte anuluar sipas kërkesave të nenit 24, pika 1/ç të LPP-së.

Konkluzion: Për sa sipër konstatuar, Vendimi nr. 516, date 31.7.2016 i KPP-së nuk është në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik neni 19/1, pika 3, VKM nr.184, date 17.3.2010 nenin 27 dhe neni 28 si dhe DT të miratuar nga AK (ARrSH)-Kriteret e vecanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3, germa ç, pasi Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim sipas objektit të ankimit, pretendimin e BOE ankimues për shfuqizimin e vendimit të Autoritetit Kontraktor në lidhje me kualifikimin pa të drejtë të BOE “R.spa Albania” & “E” nga KVO, oferta e të cilit pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit rezulton se, nuk përmbush kriteret e vendosura në DT “Kapaciteti teknik“, duke lënë në fuqi kualifikimin pa të drejtë BOE “R.spa Albania” & “E” nga Autoriteti Kontraktor, me vlerë oferte më të madhe se oferta e ankimuesit me diferencë prej 101,181,925 lekë. Ndodhur në këto kushte, Komisioni në vendimmarrjen e tij si pasojë e mosshqyrtimit të ankimit në tërësinë e objektit të tij, nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë operatorët ekonomikë pjesmarrës në prokurim dhe pse çështja ka karakter publik dhe ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimit të autoritetit Kontraktor (ARrSH), duke sjellë dëm në buxhet. Për sa sipër mban përgjegjësi Komisioni i përbërë nga **G. K-Kryetar, S. K, L. G. dhe H. B.** (J. H. ka dhënë mendim kundër).

1.2.7. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së : Në lidhje me konstatimin e sipërm të KLSH-së, anëtarët e Komisionit G. K-ish Kryetar dhe L. G., kanë bërë observacion nr. Prot 1799/1, datë 22.11.2017 (prot. i KPP-së) me komente dhe shpjegime si me poshte i cili pasi u mor në shqyrtim **nuk merret në konsideratë** me arsyetimin:

Pretendimi i subjektit: “... KPP për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve të AK, në cdo rast i referohet parashikimeve të Ligjit nr.9643/2006si dhe dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga OE. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së OE ankimues, Komisioni ka gjykuar se vendimi i KVO-së për skualifikimin e këtij subjekti ka qënë në përputhje me LPP.... e për rrjedhojë duhet të lihet në fuqi”.

Qëndrimi i audituesve KLSH-së: Meqenëse KPP në kuptim të nenit 19/1, pika 1 të LPP është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj, ka detyrimin ligjor të shqyrtojë ankesat në tërësinë e objektit. KPP në rastin konkret gjykon se vendimi i KVO-së për skualifikimin e ankuesit është i drejtë por nuk merr në shqyrtim faktin tjetër që përbën dhe objektin e ankimit, shqyrtimin e kualifikimit të BOE “R.spa Albania” & “E” nga Autoriteti Kontraktor”. Sipas gjykimit të KPP-së është i drejtë veprimi i saj kur gjykon se vendimi i KVO-së për skualifikimin e ankuesit është i drejtë, por nuk e quan të drejtë dhe “ligjore” marrjen në shqyrtim të ankimit përse i përket vendimit të KVO për kualifikimin e BOE “R.spa Albania” & “E” nga Autoriteti Kontraktor”. Për pasojë, pretendimi i subjektit **nuk merret në konsideratë**. Pretendimet e tjera lidhur me këto konstatime të KLSH nuk merren në konsideratë, pasi nuk ka asnjë argument të ri



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

përtej atyre të parashtruara në vendimin e marrë nga KPP si dhe janë dhënë sqarime në qëndrimin e KLSH për rastet e njëjta. Pretendimet **nuk merren** në konsideratë

1.3. Vendimi i KPP nr. 302 datë 6.5.2016 lidhur me procedurën e tenderit me objekt “B3-Blerje barna gjaku dhe organet formuese të gjakut për nevoja spitalore” loti 12 me fond limit 55,127,233 lekë, i zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) në vitin 2016.

1.3.1. Nga të dhënat konstatohet se AK ka kualifikuar dy OE, nga të cilët OE “B. A.” sh.p.k., me ofertë me vlerë 59,898,804 lekë vend të parë dhe OE “M” sh.p.k., me ofertë 66,141,662 lekë.

Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga 5 anëtarë, prej të cilëve një është mjek dhe një farmacist e ka argumentuar kualifikimin/shpalljen fitues të OE “B.A.” sh.p.k., si më poshtë:

KVO konstaton dhe vlereson se ... të dy ofertuesit ofertuesit ka paraqitur te gjithë dokumentacionin e kerkuar ne kriteret e pergjithshme per kualifikim dhe kriteret e vecanta per kualifikim...

Për OE “B.A.” sh.p.k. veç sa më sipër, ka bërë sqarimin se ... Bari i ofruar nga kjo shoqeri rezulton i regjistruar per qarkullim ne territorin e Shqiperise.

Meqenese bari i ofruar prej ketij operatori eshte nje molekule komplekse: Faktori VIII + Faktor Von Willebrand human, KVO kerkoi informacion ne Agjensine Kombetare te Barnave dhe Pajisjeve Mjekesore me shkresen nr. 858/4 Prot. Date 18.03.2016, lidhur me dosjen e regjistrimit te barnave te regjistruar nga ky operator (Immunate) dhe barit te ofruar nga operatori tjeter ne kete gare per kete lot (Octanate). KVO pas pergjigjes nga AKBPM me shkresen nr.858/6 Prot., date 21.03.2016 doli me qendrimin se bari i kerkuar Faktori VIII duke qene nje bar i nxjerre nga plazma, pra nje bar human permбан ne cdo lloj rasti Faktorin Von Eillebrand si stabilizues natyror i ketij bari, ndonese perqendrimi i faktorit Von Eillebrand eshte i ndryshem ne barna te ndryshme. Në rastin konkret perqendrimi i Faktorit Von Eillebrand në barin e ofruar nga Operatori Biometric Albania (**Immunate**) eshte 375 IU në 500 IU Faktor VIII dhe 190 IU ne 250 IU Faktor VIII. Ndersa perqendrimi i Faktorit Von Eillebrand në barin e ofruar nga Operatori Megapharm (**Octanate**) eshte <= 300 IU në 500 IU Faktor VIII dhe <= 150 IU ne 250 IU Faktor VIII. Nga studimet e ndryshme bashkelidhur ketij procesverbali, vihet re se diferenca ndermjet ketyre barnave qe ndikon dhe ne kode farmaceutike te ndryshme (ATC) eshte pasi bari **Immunate(Biometric Albania)** sherben dhe per kurimin ne fillesen e semundjes Von Eillebrand ndersa bari Octanate (M) nuk shërben për kurimin e kesaj semundje.

KVO pa të nevojshëm dhe hulumtimin per efektin terapeutik, menyren e prodhimit dhe perlllogaritjen e dozimit te ketyre barnave ne pacientet hemofilik (me Hemofili A), qe kane ofertuar ne kete lot. Nga raportet e Federatës Botërore të Hemofilisë, Octanate dhe Immunate jane dy nder disa barna te tjere qe trajtojne semundjen e Hemofilise A.

Sa me siper te gjitha keto raporte i bashkelidhen ketij procesi vleresimi.

Persa me siper, KVO, me unanimitet e vlereson te plote oferten e kesaj shoqerie dhe e kualifikon ate per lotin qe ka paraqitur oferte.

1.3.2. Për këtë përfundim të KVO, OE “M” sh.p.k. ka bërë ankesë pranë AK (Ministria e Shëndetësisë) me objekt “skualifikimin e OE *Biometric Albania*” për lotin 12 ... Faktori VIII... me arsyen se bari i ofruar prej tij është tërësisht tjetër nga ai i kërkuan në DST).

1.3.3. MSH, e cila në rastin konkret shfaqet në cilësinë e një autoriteti kontraktor në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe njëherazi **organi më i specializuar** në rang vendi për të ofruar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

një ekspertizë mbi përbërësit/efektet e produkteve farmaceutike, i ka kthyer përgjigje, përmbledhur si më poshtë:

Në përgjigje të ankesës suaj, me objekt skualifikimin e ofertës së B. A. për lotin 12. Faktori VIII të kësaj procedure prokurimi, me arsyen **se bari i ofruar prej tij është tërësisht tjetër nga ai i kërkuar në DST, ju sqarojmë si më poshtë:**

Nga hulumtimet e bëra nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në faqet zyrtare të Octapharma® të rifreskuara muajt e parë të vitit 2016, arrijmë të vërtetojmë se Octanate 50 UI/ml (me paketimet 5ml dhe 10 ml) përmban përafërsisht ≤ 30 IU/ml faktorin von Ëillebrand.

Po në faqen zyrtare të Octapharma thuhet shprehimisht se:

Octanate është një koncentrat i Faktori VIII human/ von Ëillebrand Factor (VËF) me një pastërti të lartë qëpërdoret për profilaksi dhe trajtimin e gjakderdhjes në pacientët me hemofili A. Octanate i nënshtrohet dy hapave të pavarura për çaktivizimin e viruseve (trajtim tretës / pastrues dhe ngrohjes terminale të thatë për 30 minuta në 100°C). Në dispozicion në shishe të: 250 IU, 500 IU, 1.000 IU.

OCTANATE® rrjedh nga plazma humane, me pastërti të lartë, ngrije-tharje, për administrim intravenoz. Faktori VIII i Koagulimit FVIII i pranishëm në OCTANE® është i detyruar të ketë stabilizuesin e saj natyror, faktorin von Ëillebrand (VËF), në një raport VËF / FVIII prej rreth 0.4 prandaj nuk ka nevojë për shtesë stabilizuesi gjatë procesit të prodhimit.

Pra faktori von Willebrand (VËF) është një stabilizues natyror për faktorin VIII dhe nuk ka efekt terapeutik.

Pra supozimet tuaja që Octanate përmban Faktorin VIII human të koagulimit pa Faktorin von Ëillebrand bie poshtë.

✓ Ne rastet e të dy barnave të tenderuar indikimi terapeutik është i njëjtë.

Ne trajtimin dhe profilaksinë e gjakrrjedhjes (hemorragjisë) në pacientet me hemofili A.

✓ Ne të dy rastet doza e kërkuar e Faktorit VIII llogaritet duke përdorur formulën e mëposhtme:

Required units = body weight (kg) x desired factor VIII rise (%) x 0.5

UI (faktor VIII) = pesha e trupit (kg) x rritja e dëshiruar e faktorit VIII (%) x 0.5.

Sa më lart, referuar vendimit të Komisionit të ngarkuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit, **Autoriteti Kontraktor ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik M. Sh.p.k.** për lotin 12. Faktori VIII të procedurës së prokurimit “B3 - Blerje barna gjaku dhe organet formuese të gjakut për nevoja spitalore” ... (zyrtari për shqyrtimin e ankesës në M SH është mjek i specializuar).

1.3.4. Operatori Ekonomik “M” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në KPP me objekt **“skualifikimin e OE Biometric Albania” për lotin 12 ... Faktori VIII...** me arsyen se bari i ofruar prej tij është tërësisht tjetër nga ai i kërkuar në DST, duke vënë në dijeni dhe Autoritetin Kontraktor me shkresën nr. 858/21 prot, datë 06.04.2016.

1.3.5. KPP me vendim (të ndërmjetëm/pezullimi) nr. 788/1, datë 8.4.2016 ka vendosur:

- Të kalojë për shqyrtim ankesën,
- Pezullimin e procedurës,
- AK të dërgojë menjëherë informacion të hollësishëm...

1.3.6. AK me shkresë nr. 788/2, datë 15.4.2016 i ka dërguar informacion të hollësishëm KPP lidhur me zhvillimin e procedurës së tenderit (77 faqe sipas inventarit të dosjes) ...



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

1.3.7. KPP i përbërë nga G. K. kryetar, S. K. zv/kryetar, L. G. dhe H. B. anëtarë, me vendim nr. 302/2016 “**ka pranuar ankesën**” e OE “M” sh.p.k, sipas së cilës, medikamenti i sjellë/ofruar në tender nga OE “B” sh.p.k., **nuk është i njëjtë, por është i ndryshëm nga ai i kërkuar/përcaktuar në DST nga AK.**

Në vijim jepet e plotë pjesa arsyetuese e vendimit të KPP nr. 30/2016:

... Emri, formë/ dozë farmaceutike e barit: IMMUNATE 500 I.E. FV III/375 I.E. ËVF- Pluhur tretës për tretësirë për ineksjon (500 IU+375 IU);

Përbërësit aktiv:

Faktori VIII i koagulimit human 500 IU

Faktor Von Ëllebrand human 375 IU

Lëndët ndihmëse:

Pluhuri: Albuminë humane, Glicinë, Klorur natriumi, Citrat natriumi, Klorhidrat lizine; Klorur kalciumi; Treëzi: Uji i sterilizuar për injeksion;

Mbajtësi i autorizimit për tregëtim: BAXTER AG Industriestrasse 67 A-1221 Vienna, Austri

ii. Rinovim i autorizimit për tregëtim nr. 1 protokolli datë 07.01.2016 lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Paisjeve Mjekësore. Referuar autorizimit të mësipërm konstatohet se autorizimi përmban të dhënat e mëposhtme:

Emri, formë/ dozë farmaceutike e barit: IMMUNATE 250 I.E. FV III/190 I.E. VËF- Pluhur tretës për tretësirë për ineksjon (250 IU+190 IU);

Përbërësit aktiv:

Faktori VIII i koagulimit human 250 IU

Faktor Von Ëllebrand human 190 IU

Lëndët ndihmëse:

Pluhuri: Albuminë humane, Glicinë, Klorur natriumi, Citrat natriumi, Klorhidrat lizine; Klorur kalciumi; Trerëzi: Uji i sterilizuar për injeksion;

Mbajtësi i autorizimit për tregëtim: BAXTER AG Industriestrasse 67 A-1221 Vienna, Austri

iii. Autorizim Prodhuesi lëshuar nga shoqëria Bexatla GMBH, në cilësinë e distributorit të autorizuar të produkteve të Baxter AG Vjenë, për shoqërinë “Biometric Albania” Sh.p.k. [...]” III.1.2.. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese [...]”

Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave” pika 1 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara

Në nenin 27 “Kontrata e Mallrave” pika 3 të VKM 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se :

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Në nenin 23 pika 1,2 dhe 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”[...]

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, dokumenteve të procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se synimi i final i autoritetit kontraktor për procedurën e prokurimit objekt ankimi (loti 12) është furnizimi me barna mjekësore sipas kërkesës dhe nevojës së parashikuar nga ky i fundit në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Referuar shtojcës 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” i procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka parashikuar nevojën për furnizime me barna të grupit “gjaku dhe organet formuese të gjakut” me princip aktiv FAKTORI VIII, me formë dozë 250 UI-500 UI.

Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “B. A.” sh.p.k. ka dorëzuar : Rinovim i autorizimit për tregëtim nr. 2 protokolli datë 07.01.2016 lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Paisjeve Mjekësore për Emri, formë/ dozë farmaceutike e barit: IMMUNATE 500 I.E. FV III/375 I.E. ËVF- Pluhur tretës për tretësirë për ineksjon (500 IU+375 IU, i cili ka si përbërës aktiv: Faktori VIII i koagulimit human 500 IU dhe Faktor Von Ëillebrand human 375 IU. Gjithashtu, K.P.P. konstaton se është dorëzuar edhe Rinovim i autorizimit për tregëtim nr. 1 protokolli datë 07.01.2016 lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Paisjeve Mjekësore. Referuar autorizimit të mësipërm konstatohet se autorizimi përmban të dhënat e mëposhtme për Emri, formë/ dozë farmaceutike e barit: IMMUNATE 250 I.E. FV III/190 I.E. ËVF- Pluhur tretës për tretësirë për ineksjon (250 IU+190 IU), barn e cila ka si përbërës aktiv Faktori VIII i koagulimit human 250 IU dhe Faktor Von Ëillebrand human 190 IU. Referuar nenit 3 “Përkufizime”, pika 5 të Ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, parashikohet se : “Bar” është çdo lëndë ose kombinim lëndësh”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe autorizimeve të mësipërme konstatohet se operatori ekonomik “Biometric Albania” sh.p.k. zotëron autorizim prodhuesi të distributorit të autorizuar Baxter AG Vjenë, i cili është mbajtës i autorizimit për tregëtim në kuptim të ligjit nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” për produktet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

IMMUNATE 500 I.E. FV III/375 I.E. VËF me princip akti :Faktori VIII i koagulimit human 500 IU dhe Faktor Von Ëillebrand human 375 IU si edhe për produktin IMMUNATE 250 I.E. FV III/190 I.E. VËF me princip aktiv Faktori VIII i koagulimit human 250 IU dhe Faktor Von Ëillebrand human 190 IU; Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barna e mësipërm të propozuar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” sh.p.k. është një kombinim lëndësh në kuptim të ligjit 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” i cili përbëhet nga Faktori VIII i koagulimit human dhe Faktor Von Ëillebrand human.

III.1.4. Gjithashtu, për një shqyrtim të drejtë të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të krahasojë edhe kodet përkatëse të produkteve të mësipërme referuar Sistemit të Klasifikimit të Qendrës së Bashkëpunimit për Metodologjinë e Statistikave të Barnave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (këtu e në vijim ËHO Collaborating Centre for Drug Statistics Methodology). Referuar faqes zyrtare të ËHO Collaborating Centre for Drug Statistics Methodology, sqarohet se : “ Në sistemin e klasifikimit anatomike terapeutik Kimike (ATC), substancat aktive janë të ndarë në grupe të ndryshme sipas organit apo sistemi në të cilën ata veprojnë dhe terapeutik të tyre, farmakologjike dhe vetitë kimike. Droga janë klasifikuar në grupe në pesë nivele të ndryshme. Droga janë të ndarë në katërmëdhjetë grupe kryesore (niveli 1), me farmakologjike / nëngrupet terapeutik (niveli 2). Të 3 dhe 4 nivelet janë kimike / farmakologjike / terapeutik nëngrupe dhe niveli 5 është substanca kimike. I 2, 3 dhe nivelet e 4 janë përdorur shpesh për të identifikuar nëngrupe farmakologjike kur kjo konsiderohet si më e përshtatshme se nëngrupe terapeutike ose kimike.” Nga hulumtimi i kryer, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se për produktin me përbërës aktive Coagulation Factor VIII, produkti i mësipërm figuron i regjistruar me kod B02BD02; ndërsa produkti me përbërës aktiv von Ëillebrand factor and coagulation factor VIII in combination është i regjistruar me kod B02BD06. Sa më sipër, referuar klasifikimit të produkteve, Komisioni i prokurimit publik konstaton se prima facia kemi të bëjmë me dy produkte të ndryshme të cilat përbërësve aktivë të tyre, barna Factor VIII, përmban vetëm përbërësin aktiv Faktori VIII, ndërkohë produkti i ofruar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” sh.p.k. shfaqet në cilësinë e një kombini barnash me përbërës aktiv Faktori VIII dhe Faktori Von Ëillebrand. Referuar kërkesës së autoritetit kontraktor pashikuar edhe në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, kërkesa e këtij të fundit është furnizimi me barna të cilat kanë si përbërës aktiv vetëm Faktori VIII.

III.1.5. Referuar argumenteve të parashtruara pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor si edhe kthim përgjigje për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “M” sh.p.k., me anë të shkresës nr 858/12 prot date 31.03.2016, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka argumentuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “[...]Nga hulumtimet e bëra nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në fazën zyrtare të Octapharma të rifreskuar muajt e fundit të viti 2015, arritëm të vërtetojmë se Octanate 50UI/ml me paketimet 5 ml dhe 10 ml përmbajnë afërsisht ≤ 30 IU/ml faktorin Von Ëillebrand. Po në faqen zyrtare të Octapharma thuhet shprehimisht se Octanate është një koncentrat i Faktorit VIII human/ VON Ëillebrand Factor (ËVF) me një pastërti të lartë që përdoret për profilasi dhe trajtimin e gjakderdhjes në pacientët me hemofili A. Octane i nënshtrohet dy hapave të pavarura për çaktivizimin e viruseve (trajtimi tretës/pastrues dhe ngrohjes termale të thatë për 30 minuta në 100 °C., ashtu sikurse dhe Immunate. Në dispozicion në shishe të 250 IU, 500 IU, 1000 IU. [...]”. Në rastin konkret konstatohet se autoriteti kontraktor nuk ka trajtuar thelbin e ankesës së operatorit ekonomik “M” sh.p.k. për mos përpuethshmërinë e produktit të operatorit tjetër ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “B. A.” sh.p.k., por ka marrë në trajtim analizimin e të dhënave të produktit të ofruar nga ankimesi në këtë procedurë prokurimi, referuar konstatimeve të përshkrimeve teknike të produktit të ofertuar nga ankimesi në faqen zyrtare të prodhuesit. Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

vendimarrja e K.P.P. i nënshtrohet parimeve të përgjithshme të së drejtës dhe një prej tyre është edhe parimi se organi administrativ vendos në bazë të provave dhe fakteve të administruara në proces (Judicis est judicare secundum allegata et probate). Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ konstatohet se referuar shkresës nr. 1287/1 protokollin datë 04.03.2016 lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Paisjeve Mjekësore (AKBPM), rezulton se për produktin me emërtim tregëtar OCTANATE me dozë 50 IU, me përbërës aktiv: Human Coagulation Factor VIII X 250 IU dhe për barin me emërtim tregëtar OCTANATE me dozë 50 IU, me përbërës aktiv: Human Coagulation Factor VIII X 500 IU. Në nenin 17 pika 1 të Ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, parashikohet se parashikohet se Agjencia është institucion i specializuar për analizën, regjistrimin, kontrollin e barnave dhe pajisjeve mjekësore, si dhe inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike dhe farmakovigjilencë”. Sa më sipër, K.P.P. konstaton se organi i specializuar dhe i parashikuar nga ligji për regjistrimin e barnave në regjistrin kombëtar të barnave është AKBPM-ja e cila konfirmon se produktet e ofertuar nga operatori ekonomik ankimes “M” sh.p.k. kanë si përbërës aktiv vetëm Faktori VIII Human dhe në asnjë rast nuk shfaqet si një bar me kombinim lëndësh (refruar përbërësit aktiv).

III.1.6. Referuar nenit 23 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik të ndryshuar” dhe nenit 27 pika 1 të Vendimit Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, K.P.P. gjykon specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar nevojave të autoritetit kontraktor ky i fundit ka parashikuar nevojën e furnizimit me produkte mjekësore për lotin 12 të cilat kanë si përbërës aktiv vetëm Faktori VIII dhe në asnjë rast produkte të tjera mjekësore. Në lidhje me pretendimin e autoritetit kontraktor referuar kthim përgjigje për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “M” sh.p.k., me anë të shkresës nr.858/11 prot datë 31.03.2016 se “Sa më lart këto dy barna (Octane i ofruar nga M dhe Imunate i ofruar nga Biometric Albania) kanë të njëjtën përmbajtje kimike (Faktor VIII + Faktor Von Villebrand), pavarësisht emërimit të këtij bari (Octane) si edhe studimet e kryera mbi Faktorin VIII human. Edhe ndikimi terapeutik në hemofilinë e tipit A është i njëjtë e provuar kjo nga studimi i bërë i Federatës Botërore e Shëndetësisë mbi trajtimin e Hemofilisë A.” K.P.P. konstaton se referuar akteve administrative të lëshuara nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Paisjeve Mjekësore (AKBPM), produktet e ofertuara nuk kanë të njëjtën përmbajtje kimike (princip aktiv), pasi produkti i ofertuar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” sh.p.k. krahas Faktori VIII human përmban si përbërës aktiv edhe faktorin Von Villebrand, i cili, referuar specifikimeve teknike të kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk parashikohet si përbërës aktiv i produktit të kërkuar. **Sa më sipër, K.P.P. gjykon se produkt i ofertuar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” sh.p.k. nuk plotëson specifikimet teknike në drejtim të përbërësit kimik (përbërësit aktiv) të kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

III.1.7. Akoma më tej, K.P.P. gjykon se në rast se pretendimet e autoritetit kontraktor se Faktori Von Villebrand është një stabilizues natyror dhe nuk shfaq efekt terapeutik, K.P.P. gjykon se në cilësinë e organit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor mund të kishte parashikuar furnizimin me produkte me përbërës aktiv faktori VIII dhe faktori Von Villebrand. Gjithashtu theksojmë faktin se në dokumentet standarte të tenderit parashikohet mundësia e autoritetit kontraktor nëse për procedurën e prokurimit do të pranohen oferta alternative, duke i'u dhënë mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që të ofertojnë në respekt të parimit të transparencës, barazisë etj, por referuar kërkesës së pasqyruar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ka parashikuar strictu sensu detyrimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

operatorëve ekonomikë për furnizimin me produkte të cilët përmbajnë si princip aktiv Faktori VIII. K.P.P. gjykon se ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve ndaj operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Sa më sipër, gjykimi i produkteve të ofruar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës referuar efektit të tyre terapeutik, ku referuar principit aktiv të produktit prima facia konstatohet se është i ndryshëm me produktin e kërkuar nga ana autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se do të ndodheshim në rastin klasik të shkeljes së parimit të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve ndaj operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash ka vendosur:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik ” M” sh.p.k për procedurën e prokurimit me objekt “Faktori VIII 250UI-500 UI” loti 12 me fond limit 55,127,233 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 10.03.2016 nga autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë.
2. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Biometric Albania” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operatorë ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ” M” sh.p.k. (tarifa është 275,637 lekë).

1.3.8. Autoriteti kontraktor (MSH) me shkresë nr. 858/27, datë 16.5.2016 ka informuar KPP se vendimi nr. 302/2016 është zbatuar. Njësia e prokurimit hapi rivlerësimin e procedurës dhe KVO bërë **skualifikimin** e OE “Biometric Albania” sh.p.k.

Konkluzion:

Në tërësi, në arsyetimet e veta KPP, në tejkallim të mundësive/kapaciteteve profesionale (pasi në përbërje nuk ka specialistë të fushës), ka hedhur poshtë mendimin e specialistëve të fushës, për më tepër MSH, e cila në rastin konkret shfaqet në cilësinë e një autoriteti kontraktor në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe njëherazi **organi më i specializuar** në rang vendi për të ofruar një ekspertizë mbi përbërësit/efektet e produkteve farmaceutike.

KPP është përpjekur të argumentojë/kombinojë padrejtësisht, pa lidhje, jashtë kontekstit, nene të ndryshme të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ligjin nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin 8 farmaceutik” për produktet IMMUNATE 500 I.E. FV III/375 I.E. VËF me princip akti :Faktori VIII i koagulimit human 500 IU dhe Faktor Von Ëillebrand human 375 IU si edhe për produktin IMMUNATE 250 I.E. FV III/190 I.E. VËF me princip aktiv Faktori VIII i koagulimit human 250 IU dhe Faktor Von Ëillebrand human 190 IU, **duke u thelluar në veçanti efektet terapeutike të tyre**, ndryshimet midis tyre.

Rrjedhojë direkte e zbatimit të këtij vendimi të KPP nga AK (MSH) është skualifikimi i padrejtë i OE “Biometric Albania” sh.p.k. me ofertë 59,898,804 lekë i klasifikuar në vend të parë nga AK dhe kualifikimi në vend të parë (për më tej shpallja fitues) i OE “M” sh.p.k, me ofertë 66,141,662 lekë, ose 6,242,858 lekë më tepër se sa oferta e OE “Biometric Albania” sh.p.k.

Kësaj vlere i shtohet dhe vlere prej 275,637 lekë që përfaqëson tarifën e pagesës në momentin e bërjes së ankesës nga OE “M” sh.p.k, por që i është kthyer, pasi KPP i ka dhënë të drejtë, duke e çuar vlerën në **6,518,496 lekë gjithsej**, e cila nën këtë arsyetim përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi KPP të përbërë nga G. K. kryetar, S. K. zv/kryetar, L. G. dhe H. B. anëtarë.

1.3.9. Në vendimin e KPP vlen të evidentohet “Mendimi Kundër” i anëtares se KPP, J. H. dhe vendimi i Gjykatës së Administrative të Shkallës së parë Tiranë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Në tërësi në arsyetimin e tyre, ato mbështesin vlerësimet/përfundimet e KVO dhe Komisionit/zyrtarit të shqyrtimit të ankesës të M SH.

1.3.10. OE “B.A.” sh.p.k. ka paditur KPP në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me argumentin se e ka skualifikuar padrejtësisht, megjithëse AK, Ministria e Shëndetësisë (MSH) e kishte kualifikuar dhe shpallur fitues si OE me ofertën me vlerë më të ulët... dhe padrejtësisht ka shpallur fitues OE “M” sh.p.k. me ofertë më të lartë...

Gjykata në vendimin e saj nr. 80-2016-5941, datë 9.12.2016 lidhur me ankesën e OE “B. A.” sh.p.k., përmbledhur është shprehur se ... *vendimi i KPP nr. 302, datë 6.5.2016 lidhur me skualifikimin e OE “B.A.” sh.p.k. është “i paligjshëm”*. Megjithëse Gjykata e ka konsideruar të paligjshëm vendimin e KPP për skualifikimin OE “B.A.” sh.p.k, nuk e ka vendosur njëkohësisht dhe “anulimin e kontratës” së lidhur midis MSH dhe OE “M” sh.p.k., pasi mbështetur në *nenin 64/4 të ligjit nr. 6943, datë 20.11.2006 ... shqyrtimi i ankesës është bërë, pasi është lidhur kontrata midis palëve*.

(Më hollësisht sa më sipër është trajtuar në akt konstatimin nr. 2, datë 30.10.2017 mbajtur me KPP të përbërë nga G. K. kryetar, S. K. zv/kryetar, L. G. dhe H. B.anëtarë)

1.3.11. Z. H. B. me shkresë nr.1641/6, datë 16.11.2017 përmbledhur, ka bërë komente/shpjegime si më poshtë:

Nuk mund të quhet një AK (MSH) i specializuar në kushtet kur ligji njih si organin më të lartë në fushën e prokurimeve KPP, I cili është dhe organ kompetent në shqyrtimin e ankesa të paraqitura dhe ka në përbërje të tij staf të kualifikuar.

Në kushtet kur ankesa shqyrtohet nga KPP, nuk mund të mos shqyrtohet ankesa nga ky komision me arsyetimin se AK ka specialist të fushës ...

Argumentet e dhëna nga audituesit duke u nisur thjesht nga fakti se AK është organ më i specializuar në vend, nuk janë të argumentuara duke ju referuar thelbit të ankesës. Në lidhje me thelbin e vendimit, sqaroj se I qëndroj arsyetimit dhe argumentimit të dhënë në të (në vendim).

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH ^{-së:} *Komentet/shpjegimet e dhëna nga anëtari i KPP për vendimin nr. 692/2015, nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht nga audituesit në Akt konstatim dhe projektraport, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e anëtarit të KPP, nuk qëndrojnë.*

Vlen të theksohet se marrja e specialistëve dhe ekspertëve të jashtëm është parashikuar në:

- Nenin 64/1 germa “ç” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

- Nenin 58 dhe 61/2 të VKM nr 914, datë 29.12.2014 I ndryshuar.

- nenin 17 të “Rregullore e brendshme” e KPP hartuar në zbatim të VKM 184, adtë 17.3.2010 etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Në kushtet kur ankesa shqyrtohet nga KPP, nuk mund të mos shqyrtohet ankesa nga ky komision me arsyetimin se AK ka specialist të fushës ...

Argumentet e dhëna nga audituesit duke u nisur thjesht nga fakti se AK është organ më I specializuar në vend, nuk janë të argumentuara duke ju referuar thelbit të ankesës. Në lidhje me thelbin e vendimit, sqaroj se I qëndroj arsyetimit dhe argumentimit të dhënë në të (në vendim).

1.3.12. Z. G. K. dhe L. G. me shkresë nr.1743, datë 22.11.2017 përmbledhur, kanë bërë komente/shpjegime si më poshtë:

- E kundërshtojmë konkluzionin e audituesve me arsyetimin ligjor si më poshtë:

KPP për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve të AK, në çdo rast i referohet parashikimeve të LPP 9643/2006, VKM nr. 914/2014 VKM nr. 184/2010, DST si dhe dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga OE. Asnjë interpertim tjetër, I cili mund të dalë jashtë parashikimeve të përcaktuara në DST, nuk mund të merret në konsideratë...

Në vijim të “Observacionit” janë dhënë sqarime kryesisht teknike që kanë të bëjnë me specifikimet teknike të medikamentit të kërkuar, krahasimin e cilësive/efekteve etj, të medikamenteve të ofruara nga dy OE pjesëmarrës në tender, të cilat janë trajtuar hollësisht në projektraport, me fundore të njëjtë me vendimin e KPP nr. 302/2016, sipas të cilit medikamenti i sjellë/ofruar në tender nga OE “Biometrik” sh.p.k., **nuk është i njëjtë, por është i ndryshëm nga ai i kërkuar/përcaktuar në DST nga AK.**

- Sqarojmë se ... vlerat e përcaktuara në akt konstatim nga audituesit, janë të ndryshme nga vlerat faktike...

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së: Komentet/shpjegimet e dhëna nga anëtari i KPP për vendimin nr. 302/2016, nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht nga audituesit në Akt konstatim dhe projektraport, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e z. G. K. kryetar dhe L.G. anëtar i KPP, nuk qëndrojnë.

Vlen të theksohet se marrja e specialistëve dhe ekspertëve të jashtëm është parashikuar në:

- Nenin 64/1 germa “ç” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

- Nenin 58 dhe 61/2 të VKM nr 914, datë 29.12.2014 I ndryshuar.

- nenin 17 të “Rregullore e brendshme” e KPP hartuar në zbatim të VKM 184, adtë 17.3.2010 etj.

Lidhur me paragrafin e dytë të “Observacionit”, në të cilin është sqaruar se vlerat e përcaktuara në akt konstatim nga audituesit, janë të ndryshme nga vlerat faktike ... grupi i auditimit, pas verifikimit të tyre, vlerëson se ato janë të sakta (trajtuar më hollësisht në akt konstatimin nr. 2, datë 30.10.2017 dhe pikën 1.3.8. të projektraportit).

1.4. Vendimi i KPP nr. 84 datë 19.2.2016 lidhur me procedurën e tenderit me objekt “blerje furgon i blinduar i përdorur (copë 5)” loti II, me fond limit 15.500.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 29.12.2015, nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare sh.a.

Objekti i vendimit:

- “Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “AGmbh” sh.p.k.

Ankimues: “S & Co Company” sh.p.k.

- “Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “AGmbh” sh.p.k., “R & R Group” sh.p.k. dhe “S & Co Company” sh.p.k. nga procedura e mësipërme e prokurimit.

Ankimues: “Sh” sh.p.k

1.4.1. Parregullsi e konstatuar:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

KPP pas shqyrtimit në themel të ankesës, ka kualifikuar OE “S & Co Company” sh.p.k , i cili në vijim është shpallur fitues i procedurës së tenderit, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.2, 2.3.5, 2.3.8. të pikës 2 të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” (KVK) të shtojcës 8, të miratuar me DST.

Në përgjithësi arsyetimi/vendimi i KPP, bie ndesh me:

- nenin 19/1 “Komisioni I Prokurimit Publik” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin public” I ndyshuar në të cilin është përcaktuar se ...

Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj...

- Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime mbi ankesat e paraqitura para tij, duke mbajtur parasysh, **përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 2**, të këtij ligji edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.

- Nenin 27/2 të VKM nr. 184, datë 17.10.2010 në të cilin është përcaktuar se ... *Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve, apo veprimeve të tjera të AK gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre...*

- nenin 28 pika 1/b, të VKM nr. 184, datë 17.10.2010, në të cilin është përcaktuar se ... *Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar ... Ndalimin e AK të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor... dhe mbështetur në pikën 2/d ... Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë AK për rifillimin e procedurës së prokurimit.*

Komisioni në dhënien e vendimit, nuk ka marrë në shqyrtim në tërësinë e tij objektin e ankimit për subjektet që lidhen me objektin e ankimimit dhe vendimin e KVO.

Për më tepër, pavarësisht sa më sipër, për BOE “S & Co Company” sh.p.k. ka pasur ankesë lidhur me plotësinë/rregullshmërinë e dokumentacionit, nga OE “Sh” sh.p.k.

Argumentim:

1.4.1.1. Në datën 29.12.2015, autoriteti kontraktor (AK) ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur oferta (fond limit), operatorët ekonomikë si më poshtë:

- “A Group” sh.p.k. 12.890.000 lekë, kualifikuar.
- “S & Co Company” sh.p.k. 14.499.000 lekë, kualifikuar
- “R & R Group” sh.p.k. 14.600.000 lekë, kualifikuar
- “Sh” sh.p.k. 15.200.000 lekë, kualifikuar
- “A E Group” sh.p.k. 15.400.000 lekë, skualifikuar

Sipas informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor KPP, ... KVO-ja gjatë vlerësimit të procedurës së prokurimit, konstatoi se Katalogu i paraqitur prej Operatorit Ekonomik “A Group” sh.p.k, nuk është i plotë pasi nuk përmban shpjegime apo ilustrime plotësuese, por përmban vetëm foto të automjeteve.

Megjithatë duke u mbështetur edhe në dorëzimin e specifikimeve teknike të nënshkruara dhe të vulosura prej Operatorit Ekonomik, Certifikatat dhe deklaratat të cilat japin shpjegime apo



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

*ilustrime të katalogut, KVO-ja e ka konsideruar si nje devijim të vogel, kjo bazuar në Nenin 53, pika 4 **Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.***

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik të ofertës së paraqitur në tender rezulton që i përmbush plotësisht kriteret për kualifikim.

*Për sa më sipër, oferta ekonomike me vlerë 12.890.000 (dymbëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë) **vlerësohet e rregullt nga KVO-ja.***

Autoriteti Kontraktor kavleresuar duke mbrojtur parimet e ligjit si:

Mbrojtjen e interesit publik duke kërkuar besueshmeri në zbatimin e plotë të kësaj kontrate.

Eficensen e fondit ekonomik ku është kualifikuar duke përmbushur te gjitha kriteret ligjore, ekonomike, dhe teknike.

Nxitjen e pjesëmarrjes se operatoreve ekonomik ne procedurat e prokurimit publik. Nxitjen e konkurences ndermjet operatoreve ekonomike.

Mosdiskreminimin e operatoreve ekonomik duke siguruar nje trajtim te barabarte te gjithe operatoreve ekonomik.

1.4.1.2. Për këtë përfundim të AK, operatori ekonomik “S & Co Company” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “AGmbh” sh.p.k. me argumentimin se nuk plotëson kriterët e përcaktuara në pikën:

- 2.3.5. të KVK, pasi nuk ka dorëzuar çertifikatë sigurie për gabinën, xhamat si dhe komplet mjetin të miratuar nga një laborator/qendër balistike...

- 2.3.8. të KVK, pasi nuk ka dorëzuar katalog dhe dokumenti që ai ka dorëzuar nuk ka lidhje me katalogun. Përmbajtja e këtij skedari nuk ka asnjë përafërsi me katalogun pasi nuk përmban asnjë të dhënë teknike, literaturë, apo ndonjë të dhënë tjetër përpos pamjeve fotografike.

1.4.1.3. Për përfundimin e AK (KVO) është ankuar në KPP (më parë në AK) dhe OE “Sh” sh.p.k. duke kërkuar skualifikimin e OE “AGmbh” sh.p.k, “S & Co Company” sh.p.k. dhe “R & R Group” sh.p.k. me argumntet se nuk kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.1., 2.3.2., 2.3.4., 2.3.5. dhe 2.3.8. 2.3.1.. etj, të “Kapacitetit Teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të vendosur/kërkuar nga AK.

1.4.1.4. KPP lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “S & Co Company” sh.p.k. dhe pretendimin e operatorit ekonomik “Sh” sh.p.k. se “OE A” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.5. dhe 2.3.8. ka vërejtur se nga verifikimi i dokumentacionit të OE “A” sh.p.k. rezulton se nuk është paraqitur ndonjë dokument apo çertifikatë sigurie e miratuar nga qendra e balistikës, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në kriteret për kualifikim në dokumentat e tenderit.

Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorëve ekonomikë “S & Co Company” sh.p.k. dhe “Sh” sh.p.k. për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “AGmbh” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar një prej pretendimeve të tyre dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori ekonomik, do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur interesat e ankimuesve, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

1.4.1.5. KPP lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Sh” sh.p.k. se OE “Si & Co Company” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e pikës:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

- 2.3.2. të Kapacitetit Teknik të KVK të DST, është shprehur se ... ky kriter është plotësuar me argumentin se ... nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “S & Co Company” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të sipërcituar është paraqitur dokumentacioni ISO 9001:2008 për Dizenjimin, prodhimin dhe montimin e makinave të blinduara në emër të The Armored Group.

- 2.3.5. të “Kapacitetit Teknik” të KVK të DST, është shprehur se ... ky kriter është plotësuar me argumentin se ... Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Si & Co Company” sh.p.k., rezulton se është paraqitur dokumentacion i lëshuar nga H.P. Ëhite Laboratory, INC, të tilla si tabela me të dhëna, përshkrimi i panelit të testit, test raport për xhama, armatura etj.

OE “S & Co Company” sh.p.k. ka paraqitur edhe dokumenti Deklaratë për çertifikatën e sigurisë për kabinën dhe xhamat e blinduara dhe komplet mjetin e blinduar, ku deklarohet se “Furgonat e blinduar kanë certifikatat e sigurisë dhe testet për komplet mjetin të lëshuara nga qendra e balistikës...

Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur se gjykon se operatori ekonomik “S & Co Company” sh.p.k. ka paraqitur ofertë në përputhje me kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, në dokumentat e tenderit, pasi ka paraqitur dokumentacion në lidhje me testimin e mjetit nga një qendër/laborator balistik.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se gëzojnë të gjitha kapacitetet në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit dhe referuar nenit 55, pika 2 të LPP nga autoriteti kontraktor nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Si & Co Company” sh.p.k. konsiderohet i vlefshëm.

2.3.8. (Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog për çdo mjet për të cilin ofron) të Kapacitetit Teknik të KVK të DST, është shprehur se ... ky kriter është plotësuar me argumentin se ... nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “S & Co Company” sh.p.k. rezulton se është paraqitur dokumentacioni (sipas emërimit të dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “S & Co Company” sh.p.k.), Katalog blindi, në brendi të të cilit evidentohet foto si edhe të dhënat dhe specifikime teknike të mjetit, elementë këto të cilët gjenden në një katalog.

Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “S & Co Company” sh.p.k. rezulton se është paraqitur Shtojca 6 Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, në të cilën operatori ekonomik ka deklaruar “Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta, të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë;

Në rastin konkret, nga autoriteti kontraktor është kërkuar katalog për mallin e ofruar dhe në rregullat e prokurimit publik përcaktohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë fotografi apo katalogë, duke lënë të nënkuptohet se rast pas rasti foto apo katalogu kryejnë të njëjtin funksion aq më tepër në rastin konkret kur kemi të bëjmë me një mall të përdorur dhe jo të ri (kërkohej furgon i përdorur i blinduar), duke bërë të pamundur që një produkt i tillë i përdorur të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

shoqërohet me katalogun përkatës, ndërkohë që nga operatori ekonomik dokumenti i paraqitur është emërtuar katalog i cili përfshin edhe të dhëna teknike të mallit.

1.4.1.6. Në pëfundim të shqyrtimit të ankesave KPP me vendim nr. 84/2016, datë 19.2.2016 ka vendosur:

1.4.1.6.1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “S & Co Company” sh.p.k.

1.4.1.6.2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sh” sh.p.k. në lidhje me pretendimet për kualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomikë “AGmbh” sh.p.k. dhe “R & R Group” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

1.4.1.6.3. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sh” sh.p.k. në lidhje me pretendimet për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “S & Co Company” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

1.4.1.6.4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “AGmbh” sh.p.k. dhe “R & R Group” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.

1.4.1.6.6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “S & Co Company” sh.p.k.

AK, Posta Shqiptar me shkresë nr. 625/1, datë 25.2.2016 njofton se ka zbatuar vendimin e KPP nr. 84/2016, për procedurën e prokurimit ... për “Bleje furgon i blinduar (5 copë) me fond limit 15,500,000 lekë zhvilluar datë 29.12.2015 nga AK, Posta Shqiptare.

1.4.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes konstatohet se KPP ka marrë vendim 95/1, datë 28.1.2016 (vendim i ndërmjetëm) në të cilin ndër të tjera KPP i ka kërkuar ... *AK të dërgojë menjëherë pranë KPP informacion të hollësishëm mbi lotin e II të proceduërs së mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentet përkatëse mbi pretendimet e OE “S & Co company” sh.p.k. një CD me të gjithë materialet e paraqitura nga shoqëritë pjesëmarëse, si dhe të jepet një informacion i hollësishëm i vërtetuar me dokumentacionin, për trajtimin e ankesës.*

1.4.1.8. U verifikua plotësia/saktësia e dokumentacionit të paraqitur nga OE “S & Co Company” sh.p.k. dhe u konstatua se OE nuk plotëson kriteret e përcaktuar në pikat e KVK si më poshtë:

Pikën 2.3.2. të KVK sipas të cilës ... *Operatori ekonomik duhet të paraqesi per **furgonat e blinduar** certifikaten sipas ISO 9001-2000 për produktin e ofruar.*

Në dokumentacionin e paraqitur nga OE “S & Co Company” sh.p.k, nuk gjendet certifikatë ISO 9001- 2000.

Pikën 2.3.5. të KVK sipas të cilës ... *Operatori ekonomik **per furgonat e blinduar** duhet te kete certifikate sigurie per gabinen xhamat dhe komplet mjetin te miratuara nga qendra e balistikes.* OE “S & CO Company” sh.p.k. për realizimin e këtij kriteri ka paraqitur testet e bëra H.P ËHTË LABORATORY, INC dërguar dy klientëve për dy porositë e bërë prej tyre ... *për mostrat e armaturës të marra më 18 janar 2005 nëpërmjet Unite Parcel Servic.* Në shkresë, nuk cilësohet se kujt (mjeti ?) i referohet testi i armaturës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Ajo që tërheq vëmendjen është sqarimi në fund të faqes sipas të cilit ... *Bazuar në të dhënat e prezantuara në tabelën 1, mostrat që iu nënshtruan testit kënaqën kërkesat e rezistencës balistike të NIJ-STD-0108,01, Niveli III. Ky përfundim u bazua në të dhënat e marra nga testet vetëm për mostrat që iu nënshtruan testit dhe **nuk duhet të interpretohen si një vërtetim nga H.P. ËHTË LABORATORY, INC**, për cilësinë në vazhdim, ose performancë, të ndonjë artikulli të njëjtë, ose model i ngjashëm.*

Testet e paraqitur për armaturën, nuk tregojnë se kujt i përket (mjet ?) dhe çfarë lidhje ka me OE “S & CO Company” sh.p.k. ndërkohë që OE “S & CO Company” sh.p.k. nuk është shprehur se çfarë automjeti (marke) të blinduar do të furnizojë.

Nga sa më sipër konstatohet se dokumenti “*certifikatë e balistikës dhe testimi*” i paraqitur nga OE “S & CO Company” sh.p.k, **nuk plotëson kriterin e kërkuar** (sipas pikës 2.3.5. të KVK), për rrjedhojë KPP duhet ta skualifikonte.

Pikën 2.3.8. të KVK sipas të cilës ... *Operatori ekonomik duhet të paraqes **katalog** për çdo mjet për të cilin ofron (kërkohen 5 mjete) .*

OE “S & CO Company” sh.p.k. si katalog për realizimin e këtij kriteri ka paraqitur tre fletë njera që tregon një automjet ëolksëagen me disa të dhëna dhe dy fletët e tjera dy xhama të goditur me plumb, pa ndonjë sqarim.

Nga sa më sipër konstatohet se dokumenti “*Katalogët për çdo mjet*” të paraqitur nga OE “S & CO Company” sh.p.k, **nuk plotësojnë kriterin e kërkuar** (sipas pikës 2.3.8. të KVK), për rrjedhojë KPP duhet ta skualifikonte.

(Vlen si kujtesë fakti që OE “AGmbh” sh.p.k. është skualifikuar për shkak të ankesës në KPP, bërë ndaj tij nga OE “S & CO Company” sh.p.k. me argumentin se OE “AGmbh” sh.p.k.nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikën:

- 2.3.5. të KVK, pasi nuk ka dorëzuar *certifikatë sigurie për gabinën, xhamat si dhe komplet mjetin të miratuara nga një laborator/qendër balistike...* (trajtuar në pikën 1.4.1.4. të këtij akt konstatimi).

- 2.3.8. të KVK, pasi nuk ka dorëzuar *katalog dhe dokumenti që ai ka dorëzuar nuk ka lidhje me katalogun. Përmbajtja e këtij skedari nuk ka asnjë përafërsi me katalogun pasi nuk përmban asnjë të dhënë teknike, literaturë, apo ndonjë të dhënë tjetër përpos pamjeve fotografike).*

KPP, pas shqyrtimit të ankesës është mjaftuar me vërtetimin e njerës prej dy pikave të saj, vetëm për kriterin sipas pikës 2.3.5. të KVK (trajtuar në pikën OE 1.4.1.4. të këtij akt konstatimi), e cila ka shërbyer për skualifikimin e OE “AGmbh” sh.p.k.

Nga krahasimi i përmbajtjes midis pikës 2.1.2. me pikën 1.4.1.8. të këtij akt konstatimi, në kushtet kur KPP, nuk i ka skualifikuar të dy OE, do të ishte i pranueshëm vendimi i AK (KVO) për përdorimin e nenit 53 të LPP, kualifikimin e të dy OE ekonomike dhe shpalljen fitues të OE “AGmbh” sh.p.k, i cili ka ofruar çmimin më të ulët.

Nën arsyetimet e mësipërme:

-Vlera prej 1,609,000 lekë (12.890.000 lekë - 14.499.000 lekë), e cila përfaqëson diferencën midis ofertës të OE “AGmbh” sh.p.k. dhe OE “S & CO Company” përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi KPP e përbërë nga Kryetar G. K., Zv/kryetar S. K, dhe J. H, L. G., H. B. anëtarë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

- Vlera prej 77,500 lekë, e cila përfaqëson tarifën e pagesës kusht për shqyrtimin e ankesës nga KPP, duhet t'i mbahet OE “S& CO Company” sh.p.k.

(Sa më sipër është trajtuar në akt konstatimin nr. 2, datë 30.10.2017 mbajtur me Kryetar G. K, Zv/kryetar S. K, dhe J. H, L. G, H. B. anëtarë).

1.4.2. Z. H. B. me shkresë nr.1641/6, datë 16.11.2017 përmbledhur, ka bërë komente/shpjegime si më poshtë:

Në lidhje me thelbin e vendimit, sqaroj se I qëndroj arsyetimit dhe argumentimit të dhënë në të (në vendim). Ky vendim është dhënë duke u bazuar në shqyrtimin dhe verifikimin e gjithë dokumentacionit të paraqitur nga OE. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se “S & CO Company” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin në përputhje me KVK. OE “AGmbh” sh.p.k. është skualifikuar pasi ka disa arsye për tu skualifikuar.

Përsa i përket konstatimit të audituesve për vendimin e KPPnr. 531, datë 13.7.2016 sqaroj se grupi i auditimit nuk mund të bëjë krahasime të një çështje me një tjetër pasi janë raste të ndryshme dhe nëse në pamje rezultojnë si të njëjtë, në rast se analizohen në brendësi dhe në themel janë totalisht të ndryshme... Nga ana tjetër në lidhje me konstatimin se KPP, nuk ka marrë në shqyrtim dokumentacionin e OE ankimes sqarojmë se KPP shqyrton ankesën e paraqitur dhe të lidhur ngushtësisht me objektin e ankesës dhe vetëm pretendimeve të paraqitura prej tij, pasi në të kundërt ai do të dilte nga objekti ankesës...

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH ^{-së}: Komentet/shpjegimet e dhëna nga anëtari i KPP për vendimin nr. 84 datë 19.2.2016, nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht nga audituesit në Akt konstatim dhe projektraport, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e anëtarit të KPP, nuk qëndrojnë.

1.4.3. Z. G. K. dhe L. G. me shkresë nr.1743, datë 22.11.2017 përmbledhur, kanë bërë komente/shpjegime si më poshtë:

- E kundërshtojmë konkluzionin e audituesve me arsyetimin ligjor si më poshtë:

KPP për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve të AK, në çdo rast i referohet parashikimeve të LPP 9643/2006, VKM nr. 914/2014 VKM nr. 184/2010, DST si dhe dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga OE. Asnjë interpretim tjetër, I cili mund të dalë jashtë parashikimeve të përcaktuara në DST, nuk mund të merret në konsideratë...

Në vijim të “Observacionit” janë dhënë sqarime se dokumentacioni I kërkuar në KVK nga AK është paraqitur nga OE dhe AK, nuk është shprehur për mangësi/parregullsi.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH ^{-së}: Komentet/shpjegimet e dhëna nga anëtari i KPP për vendimin nr. 84 datë 19.2.2016, nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht nga audituesit në Akt konstatim dhe projektraport, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e anëtarit të KPP, nuk qëndrojnë.

Komentet/shpjegimet e dhëna nga anëtari i KPP për vendimin nr. 84/2016, nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht nga audituesit në Akt konstatim dhe projektraport, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e z. Gentian Këri kryetar dhe Leonard Gremshi anëtar i KPP, nuk qëndrojnë.

1.5. Vendimi i KPP nr. 112, datë 3.3.2016 lidhur me procedurën e tenderit me objekt “Sistemi i mureve në territorin e godinës së HEC dhe asfaltimi i shesheve deri tek rruga për në digë. Sistemi i rrugës nga rrymëshpejtuesi deri tek hyrja e Galerisë së Digës, sheshi dhe rrethimi mbrojtës tek shkarkuesit e Transformatorëve të fuqisë në HEC Fierzë” me fond limit 25,000,000 lekë, procedurë e zhvilluar në datën 15.01.2016 nga autoriteti kontraktor Korporata ElektroEnergjitike Shqiptare Sh.a.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Ankimues: “K. Konstruktion” sh.p.k

Objekti ankimit: Shfuqizimi i vendimit KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “K.Construktion” sh.p.k. dhe kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “PE-VLA-KU” sh.p.k., “BE-IS” sh.p.k. dhe “Aurora Konstruktion” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Sistemi i mureve në territorin e godinës së HEC ... Fierzë*”.

1.5.1. Parregullsi e konstatuar:

KPP pas shqyrtimit të dosjes, me vendim nr. 112, datë 3.3.2016 ka vendosur “*Të mos pranojë*” ankesën e OE “K. Konstruktion” sh.p.k. për skualifikimin e tij dhe dhe kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “P” sh.p.k., “B” sh.p.k. dhe “A Konstruktion” sh.p.k. në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.5. të pikës 2 të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” (KVK) të shtojcës 10, të miratuar me DST.

Në përgjithësi arsyetimi/vendimi i KPP, bie ndesh me:

- nenin 19/1 “Komisioni I Prokurimit Publik” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin public” I ndyshuar në të cilin është përcaktuar se ... *Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj...*

Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime mbi ankesat e paraqitura para tij, duke mbajtur parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 2, të këtij ligji edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.

- Nenin 27/2 të VKM nr. 184, datë 17.10.2010 në të cilin është përcaktuar se ... *Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve, apo veprimeve të tjera të AK gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre...*

- nenin 28 pika 1/b, të VKM nr. 184, datë 17.10.2010, në të cilin është përcaktuar se ... *Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar ... Ndalimin e AK të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor... dhe mbështetur në pikën 2/d ... Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë AK për rifillimin e procedurës së prokurimit.*

KPP në dhënien e vendimit, nuk ka marrë në shqyrtim në tërësinë e tij objektin e ankimit dhe konkretisht pjesën e dytë që lidhet me shfuqizimin e vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e OE “P” sh.p.k. etj, oferta ekonomike e të cilit është 22,200,760 lekë, 3,547,129 lekë (18,653,631-22,200,760 lekë), më të lartë se sa oferta e ankimesit OE “K.Construktion” sh.p.k., i cili ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë më të ulët se gjithë pjesëmarrësit e tjerë në tender.

Argumentim:

1.5.1.1. Në datën 15.1.2016, autoriteti kontraktor (AK) ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në datën 02.02.2016 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “K.Construktion” sh.p.k. 18,653,631 lekë skualifikuar;
2. “P” sh.p.k. 22,200,760 lekë kualifikuar;
3. “B” sh.p.k. 22,216,984 lekë kualifikuar;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

4. “A.Construksion” sh.p.k. 23,981,675 lekë kualifikuar;

1.5.1.2. Operatori ekonomik “K.Construksio” sh.p.k. është njoftuar me anë të Sistemit të Prokurimeve Elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me arsyetimin se :

- Gjeneratori i paraqitur në ofertë nuk plotëson kriterin e dokumenteve të tenderit, në faturën e paraqitur nuk është parashikuar fuqija, në dokumentet e tenderit **kërkohet në mënyrë taksative 15 KË.**

- Për betonieret e kërkuara dhe paraqitur nga ofertuesi nuk është përcaktuar kapaciteti. Në dokumentat e tenderit është kërkuar në mënyrë taksative se operatori ofertues duhet të ketë tre betoniere me kapacitet 0.3-05m3.

- Në listëpagesa ka deklaruar një inxhinier ndërtimi nga dy të kërkuar në dokumentat e tenderit...

1.5.1.3. Në datën 02.02.2016 operatori ekonomik ankimues “K.Construksio” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij si edhe kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë. Sipas informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor KPP-së, ... AK ka pranuar pjesërisht ankesën, vetëm për plotësimin e kriterit për dy inxhinierë ndërtimi, kurse argumentet për dy shkaqet e tjera të skualifikimit, i ka refuzuar me të njëjtin arsyetim (pika 2.1.2.).

1.5.1.4. Në datën 16.02.2016 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me object shkaqet e skualifikimit nga KVO.

KPP me vendim 217/1, datë 28.1.2016 (vendim pezullimi) i ka kërkuar AK ... të dërgojë menjëherë pranë KPP informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e OE “K.Construksio” sh.p.k. **një CD me të gjithë materialet e paraqitura nga shoqëritë pjesëmarrëse**, si dhe të jepet një informacion i hollësishëm i vërtetuar me dokumentacionin, për dorëzimin pranë autoritetit kontraktor të ankesës dhe për trajtimin e ankesës.

I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar ... të jetë i shoqëruar me një procesverbal, në të cilin të pasqyrohet emërtimi i dokumenteve dhe numri i faqeve.

1.5.1.5. KPP në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “K.Construksio” sh.p.k. me vendim nr. 112, datë 3.3.2016 përmbledhur, është shprehur/ka vendosur se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues **nuk qëndron** për elementin 2.3.5.8. të “Moto gjenerator me kapacitet 15kva Copë 1 në pronësi ose me qera ose hua përdorje” të kërkuar në KVK. Për rrjedhojë skualifikimi i OE “K.Construksio” sh.p.k. për mos plotësim të kriterëve të përcaktuara në KVK është i saktë.

Komisioni i Prokurimit Publik ka gjykuar se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues “K.Construksio” sh.p.k. nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e s’kualifikuar, **shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike** të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrative.

Në nenin 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Një ankimes do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtuara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo s'kualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet e palës ankimuese nuk merren në shqyrtim.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit ... AK lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës.

1.5.1.6. KPP me këtë arsyetim/vendim, në përgjithësi bie ndesh me:

- nenin 19/1 “Komisioni I Prokurimit Publik” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” I ndyshuar në të cilin është përcaktuar se ... *Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.*

Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime mbi ankesat e paraqitura para tij, duke mbajtur parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 2, të këtij ligji edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.

- Nenin 27/2 të VKM nr. 184, datë 17.10.2010 në të cilin është përcaktuar se ... *Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektivit të ankesës dhe vendimeve, apo veprimeve të tjera të AK gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre...*

- nenin 28 pika 1/b, të VKM nr. 184, datë 17.10.2010, në të cilin është përcaktuar se ... *Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar ... Ndalimin e AK të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor... dhe mbështetur në pikën 2/d ... Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë AK për rifillimin e procedurës së prokurimit.*

Mbështetur në sa më sipër, KPP ka për detyrë minimalisht të shqyrtojë në themel “Ankimimin”, të paktën për OE ankimues dhe OE që rezulton fitues i procedurës së prokurimit (për të cilin për më tepër, është bërë dhe ankesë).

Mos shqyrtimi i ankesës në themel, ka krijuar premisa për vendimarrje jo të sakta nga KPP, të cilat kanë çenuar përzgjedhjen e OE fitues të kontratave publike në përputhje me parimet e përgjithshme të përzgjedhjes, shpeshherë të shoqëruara me dëm ekonomik.

KPP megjithëse në vendim është shprehur se ... *baza ligjore mbi të cilën shqyrtohet ankesa është ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues ... Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”... Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues... rezulton se sa më sipër, nuk është konsideruar në vendimmarrje.*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

KPP në rastin konkret, “në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrative, padrejtësisht nuk ka marrë në shqyrtim ankesën e OE “K.Construksio” sh.p.k. për kualifikim të gabuar nga KVO të OE “P” sh.p.k, i cili është klasifikuar i pari dhe në vijim është shpallur fitues i procedurës së tenderit.

1.5.1.7. U verifikua plotësia/saktësia e dokumentacionit të paraqitur nga OE “P” sh.p.k. që është shpallur fitues dhe u konstatua se nuk plotëson disa nga elementët e kërkuar në pikën 2.3.5. të KVK, shtojca 10, të miratuara me DST më poshtë:

- Pikën 2.3.5.2. të KVK sipas të cilës ... *OE për realizimin e punimeve duhet të paraqesi ... “kamionçinë 3 deri 5 ton” një copë.*

Në dokumentacionin e paraqitur nga OE “P” sh.p.k. për kamionçinë është paraqitur një kamion me peshë (ngarkesë) 11, 5 ton (sipas dokumentacionit shoqërues leje qarkullimi, sigurim mjeti etj.), i cili **nuk plotëson** kërkesat e përcaktuara nga AK, për rrjedhojë . KPP duhet të evidentonte dhe skualifikonte OE “P” sh.p.k.

- Pikën 2.3.5.3. të KVK sipas të cilës ... *OE për realizimin e punimeve duhet të paraqesi “fadrom” një copë ... Ky mjet shënohet në regjistrat publik, për këtë arsye ... duhet të paraqitet me dokumentin që verteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore, leje transporti), të cilat **nuk gjenden** në dokumentacionin e paraqitur në sistem (dosje KPP), në kundërshtim me sa është përcaktuar në KVK, për rrjedhojë kriteri është i pa plotësuar. KPP duhet të evidentonte sa më sipër dhe të skualifikonte OE “PE-VLA-KU” sh.p.k. (Në këtë rast vlen të evidentohet gjykimi/vendimi i KPP nr. 692/2015 datë 16.11.2015, në të cilin OE “Jody company” sh.p.k. është skualifikuar vetëm me argumentin se ... *mjeti ekskavator me gomë, nuk është i pajisur me certifikatën e kontrollit teknik* ... megjithëse oferta e tij ishte më e ulët se sa e OE të kualifikuar nga KPP, i cili në vijim është shpallur fitues i procedurës së prokurimit. Ky rast është trajtuar hollësisht në akt konstatimin nr. 1 mbajtur me KPP).*

- Pikën 2.3.5.4. të KVK sipas të cilës ... *OE për realizimin e punimeve duhet të paraqesi “Elektro betoniera ose moto betoniera me kapacitet të betonieres 0.3 -0.5 m³” një copë.*

Për plotësimin e këtij kriteri OE “PE-VLA-KU” sh.p.k. ka paraqitur një kontratë qiraje të noterizuar nr. 77 rep, nr. 36 kol datë 13.1.2016, sipas të cilës, .. *qiradhënësi shoqëria “Vllazëria” sh.p.k. i jep me qira qiramarërsit OE “PE – VLA-KU” sh.p.k. ... mjetet ... asfalto shtruese...elektrobetonierë.*

Në kontratë dhe në faturë tatimore shitje, nuk është përcaktuar kapaciteti i betonierës/betonierave (faturë tatimore shitje nr. 37, datë 23.8.2008, sipas të cilës shoqëria “Fred A” sh.p.k. i ka shitur shoqërisë “Vllazëria” sh.p.k. ndër të tjera ... *10 betoniere...* Në faturë, **nuk është përcaktuar kapaciteti** tyre, për rrjedhojë kriteri i kërkuar nga AK është i pa plotësuar. KPP duhet të evidentonte sa më sipër dhe të skualifikonte OE “P” sh.p.k.

Kujtesë:

Për të njëjtën parregullsi (mos përcaktimin e kapacitetit) OE “K.Construksion” sh.p.k. është skualifikuar.

- Pikën 2.3.5.8. të KVK sipas të cilës ... *OE për realizimin e punimeve duhet të paraqesi “Moto gjenerator me kapacitet 15 kva” një copë.*

Për plotësimin e këtij kriteri OE “P” sh.p.k. ka paraqitur:

1.5.1.7. a. një document me emërtim “Faturë” nr. 61/09 datë 31.10.09 sipas të cilës shitësi “F L” nga Gjakova, Kosovë, i ka shitur blerësit “P” sh.p.k. me adresë Prishtinë një gjenerator Atlas



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

ngjyra e kuqe viti 1991 – 1988 Kë, nr. ARE 940449 me vlerë 5,300 euro. Dokumenti “faturë”, nuk është i rregullt, pasi ka vetëm një vulë “F. L” me firmë të mbyllur, por nuk ka emrat e shitësit dhe blerësit të nënshkruar.

Sipas “Historiku i regjistrimit” të QKR, subjekti “P” sh.p.k. ka ushtruar aktivitetet vetëm në Shqipëri.

Dokumenti faturë shoqërohet nga:

1.5.1.7. a.1. Një document zhdoganimi, në të cilin ndër të tjera, me vështiersi të pjesa e përshkrimit të blerjes, lexohet ... *gjenerator I përdour në gjendje jo të rregullt*... Në dokumentin e zhdoganimit, nuk ka ndonjë të dhënë për fuqinë e gjeneratorit.

1.5.1.7. a.2. Një “Faturë” datë 15.5.2009 në gjuhën gjermane në të cilën është emri “F. L” Kosovë. Në pjesën e përshkrimit lexohet artikulli “Agregat atlas copko”. Në “faturë”, nuk ka ndonjë të dhënë për kapacitetin.

Në dokumentacionin sipas gurmës a.1 dhe a.2 nuk jepet kapaciteti/fuqia e “agregatit atlas copko” dhe nëse është gjenerator.

Në këto kushte, dokumenti sipas gurmës a, nuk është i kërkuari nga AK jo vetëm pse shifra 1988 KË (nëse kjo shifër i referohet kapacitetit të mjetit), është deklarative, e pa mbështetur/shoqëruar me dokumentacionin teknik të mjetit, por edhe sepse kapaciteti e tij, nuk është i njëjtë me atë të kërkuar nga AK.

Nga sa më sipër rezulton se OE “P” sh.p.k. nuk ka paraqitur pajisjen e kërkuar, për rrjedhojë kriteri i kërkuar nga AK është i pa plotësuar. KPP duhet të evidentonte sa më sipër dhe të skualifikonte OE “P” sh.p.k.

Kujtesë:

Për të njëjtën parregullsi OE “K.Construksio” sh.p.k. është skualifikuar.

KPP, duke ruajtur të njëjtin standard, mbështetur në mangësitë/parregullsitë në dokumentacionin ligjor kualifikues të përshkruar në pikën 1.5.1.2, 1.5.1.3. dhe 1.5.1.7. duhet të skualifikonte të dy OE “K.Construksion” sh.p.k. dhe “P” sh.p.k.

Nga krahasimi i përmbajtjes midis pikës 1.5.1.2 dhe 1.5.1.3. dhe pikës 5.1.7. të këtij akt konstatimi, në kushtet kur KPP, nuk i ka skualifikuar të dy OE, do të ishte më pranueshëm vendimi i KPP, që të kualifikonte OE “K.Construksio” sh.p.k. i cili ka ofruar çmimin më të ulët nga OE pjesëmarrës në tender.

Nën arsyetimet e mësipërme:

- Vlera prej 3,547,129 lekë (18,653,631-22,200,760 lekë), e cila përfaqëson diferencën midis fondit limit të ofertës të OE “K.Construksio” sh.p.k. dhe “P” sh.p.k. përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi KPP e përbërë nga Kryetar G K, Zv/kryetar S K, dhe J H, L G, H B anëtarë.

- Vlera prej 125,000 lekë, e cila përfaqëson tarifën e paguar si kusht për shqyrtimin e ankesës nga KPP, t’i kthehet OE “K.Construksion” sh.p.k.

(Sa më sipër është trajtuar në Akt konstatimin nr.4, datë 2.1.2017 mbajtur me Kryetar G K, Zv/kryetar S K, dhe J H, L G, H B, dhe J. H, anëtarë).

1.5.1.8. Z. G. K. dhe L. G. me shkresë nr. 1642/5, datë 9.11.2017, përmbledhur, kanë bërë komente/shpjegime si më poshtë:

Konstatimi i audituesve në pikën 1.1. e në vijim të akt - konstatimit (pika 1.5.1. në Projektraport) është I gabuar kur shprehen se KPP pas shqyrtimit të dosjes, me vendim nr. 112, datë 3.3.2016 ka vendosur “të mos pranojë” ankesën e OE “K. Construksion” sh.p.k. për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

skualifikimin e tij dhe kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “P” sh.p.k., “B” sh.p.k. dhe “A Konstruksion” sh.p.k. ...

KPP në vendimin e tij, asnjë rast në nuk ka kualifikuar OE të tjerë, ndryshe nga sa pretendojnë audituesit e KLSH

Lidhur me pretendimin e OE ankimues “Kevin kontruksion” sh.p.k. a... ai mbetet i skualifikuar ... pasi neni 63 pika 1 e ligjit kërkon që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por dhe të jetë i dëmtuar realisht apo të rezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë AK... KPP, nuk mund të transformohet në KVO... Audituesit shtetërorë marrin tagrin e vendimmarrje së KPP ... Interpretimi I zgjeruar I bërë nga audituesit e KLSH ... do të nënkuptonte që KPP duhet të shqyrtonte absolutisht çdo ofertë të çdo tenderi për të cilin bëhet ankesë dhe nëse bëhet ankesë për çdo tender të RSH, do të duhej që një staf prej 10 vetësh të ribënte çdo procedurë në RSH. Kjo jo vetëm që është në tejkalim të kompetencave të KPP apo dh evet të KLSH, por edhe fizikisht është praktikisht e pamundur. Për këtë arsye ligjvënësi dhe parimet e së drejtës përcaktojnë që organet gjyqësore dhe “quasi gjykatë” (sikurse është KPP) të mos anashkalojnë parimin e interes të ligjshëm dhe mos tejkalimit të kompetencave...

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:

Me sqarimet e dhëna hollësisht në Akt konstatim dhe projektraport, komentet/shpjegimet e KPP, nuk qëndrojnë.

Pavarësisht këtij fakti, grupi i auditimit ka veçuar dhe ka dhënë sqarime për disa nga komentet e të audituarve, lidhur me:

- kualifikimin e OE nga KPP etj...

Grupi i auditimit sqaron se në asnjë rast nuk është shprehur për kualifikim të OE nga KPP.

- vazhdimin e gjendjes “i skualifikuar” të OE “K kontruksion” sh.p.k. etj... të KPP.

Grupi i auditimit saron se këtij argumentimi i jep përgjigje/zgjidhje neni 27 dhe 28 i VKM nr. 184, datë 17.10.2010, neni 19/1 i ligjit 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar etj, trajtuar gjerësisht në akt konstatim dhe projektraport.

- opinionin se audituesit marrin tagrin e vendimmarrje së KPP etj.

Grupi i auditimit sqaron se audituesit, në asnjë rast nuk e kanë marrë, apo nënkuptuar këtë rol. Ata vetëm kanë arsyetuar mbështetur mbi bazën ligjore mbi të cilën mbështetet/vepron dhe KPP.

- Interpretimi i zgjeruar I bërë nga audituesit e KLSH ... do të nënkuptonte që KPP duhet të shqyrtonte absolutisht çdo ofertë etj...

Grupi i auditimit sqaron se KPP në çdo rast, duhet të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e tij.

Me sqarimet si më sipër, komentet/shpjegimet e KPP, nuk qëndrojnë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

1.5.1.9. Z. H B me shkresë nr.1641/6, datë 16.11.2017 përmbledhur, ka bërë komente/shpjegime si më poshtë:

Sqaroj se KPP në lidhje me rastet kur një OE I skualifikuar paraqet ankesë pranë KPP ku ngre pretendime në lidhje me skualifikimin e tij dhe më pas pretendon skualifikimin e gabuar të OE të tjerë, të kualifikuar, ka mbajtur një qëndrim konstant se në rast se ankuesi mbetet I skualifikuar atëherë pretendim e tij në lidhje me OE të tjerë, nuk merren në shqyrtim pasi ai nuk legjitimohet. Audituesit nuk duhet të ushtronin kontroll në lidhje me themelin e vendimeve të KPP, dhe mendoj se konstatimet e tyre, nuk janë në frymën e legjislacionit public.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së :

Komentet/shpjegimet e dhëna nga anëtari i KPP për vendimin nr. 112 datë 3.3.2016, nuk prekin argumentet e paraqitur hollësisht nga audituesit në Akt konstatim dhe projektraport, për rrjedhojë, komentet/shpjegimet e anëtarit të KPP, nuk qëndrojnë.

1.6. Vendimi nr. 43/2016, datë 22.01.2016 me të dhënat si më poshtë:

Ankues	Objekti	F. limit pa TVSH	VI. Ofertes ankues	Dif. OE fitues dhe ankuesit	Pranuar/Jo
A SH	Mirembajtje bazuar ne performance segmenetet rrugore Tirane-Ndroq-Romanat, Plepa Ura e Farkes etj 58,3 km (AK-Drejt.Rajonale Qendr. Tirane)	47,357,107	31,753,392	3,802,163	Jo

Vendimi nr.43/2016, datë 22.01.2016 i KPP-së nuk është marrë në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe konkretisht me nenin 65 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, pasi KPP në arsyetimin e vendimit të saj, **nuk është shprehur** dhe njëkohësisht **nuk ka marrë në shqyrtim** sipas nenit 17, 20, pika 2 dhe neni 27 të VKM nr.184, datë 17.3.2010 , si pjesë e dokumentacionit të kërkuar me vendimin e ndërmjetëm nr.11/1, datë 11.01.2016 dhe të dërguar nga AK, “Deklaratën” e lëshuar nga operatori E. datë 30.12.2015, e cila është pjesë përbërëse njëkohësisht edhe e Formularit të ankimit në KPP protokolluar nr.19, datë 07.01.2016, të operatorit A.Sh..

Argumentat për këtë konstatim:

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes në Formularin e ankimit të operatorit ankues A.Sh. drejtuar KPP-së, në Seksionin IV, pika 4 “Lista e shtojcave” është plotësuar si dokumentacion bashkangjitur ankimit ndër të tjera edhe dokumenti “deklaratë”.

Referuar këtij dokumentit “deklaratë”, operatori E deklaroi se: “heqim dorë nga makineria lloji Frezë Bitelli si dhe kontrata e qirasë e lidhur për këtë makineri me pronarin e saj Kirchberger Albania, pasi makineria është në dispozicion të subjektit A.Sh..... sipas kontratë noteriale nr.1374 rep. nr.464 kol. Datë 20.4.2015 (.....kontratë me të cilën jemi njohur pas datës së dorëzimit të ofertave).....”.

Sipas kronologjisë së fakteve dhe dokumentacionit, Deklarata e operatorit Elira është bërë para datës së ankimit në KPP, deklarata e cila rrëzon argumentin e KPP-së për skualifikimin e operatorit ankimes në kushtet e nenit 65 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Ndërhyrja në Ofertë”, sipas vendimit të KVO-së por të miratuar në heshtje nga KPP, pasi operatori E. ka deklaruar heqjen dorë nga oferta dhe cdo gjë që ka lidhje me të.

KPP në Vendimin nr.43/2016, datë 22.01.2016 ka vendosur: “**mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “A.Sh.” sh.p.k dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor-Drejtoria Rajonale Qendrore për vazhdimin e procedurës së prokurimit**” me arsyetimin se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

“.....Operatori ekonomik A.Sh. sh.p.k në përmbushje të kapacitetit Skarifikuere (freze asfalti) sipas shtojcës 7 kriteret e vecanta të kualifikimit/kapaciteti teknik të dst ka paraqitur mjetin Frezë Bitelli me nr. Shasie 890157 vërtetuar me deklaratën doganore datë 25.05.2004 sipas kontratës noteriale Nr.1374 Rep Nr.464 Kol datë 20.04.2015të marrë me qera nga subjekti “K. Albania” sh.p.k, mjet të cilin e ka paraqitur në të njëjtën kontratë subjekti “E” sh.p.k.Bazuar në nenin 65 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Ndërhyrja në Ofertë” sipas të cilit: “Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë në cfardolloy kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë tek e tek ose me një ofertues tjetër do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave në të cilat është përfshirë ofertuesi”. Për këtë arsye OE A.Sh. sh.p.k skualifikohet.....Gjithashtu në procedurën objekt ankimi, njëri nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës Elira sh.p.k në përmbushje të kriterit për kapacitetet teknike sa më sipër, ka paraqitur mjetin Frezë Bitelli me nr. 1655 rep. Nr. 252/1 kol. datë 23.10.2015 të marrë me qera nga subjekti “K. Albania” sh.p.k i njëjti mjet që ka paraqitur subjekti A.Sh. sh.p.k sa më sipër. Të ndodhur në kushtet sa më sipër, autoriteti kontraktor ka vendosur skualifikimin e dy operatorëve ekonomikë nga procedura e prokurimit me argumentin se jemi përballë shkeljes së nenit 65 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Ndërhyrje në ofertë”Pra në rastin konkret nuk jemi përpara situatës së rregulluar nga ligji për “Ndërhyrjen në ofertë” sikundër ka konkluduar autoriteti kontraktor, por me një situatë të cilin operatorët ekonomikë në mirëbesim kanë kontraktuar në bazë të parashikimeve ligjore në fuqi për të plotësuar kapacitetet e nevojshme teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit me palë të treta. Megjithatë, përpos interpretimeve sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor i gjendur përballë të njëjtës kontratë qeraje që kalon të drejtën e disponueshmërisë së të njëjtit mjet dy operatorëve të ndryshëm ekonomikë, me të drejtë ka vendosur skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit. Autoriteti kontraktor gjendet përballë një dyshimi real i cili nuk e lejon të krijojë tërësisht bindjen dhe besueshmërinë kundrejt operatorëve ekonomikë duke mos njohur realisht se cili nga operatorët ekonomikë i përket vërtet disponueshmëria faktike përtej asaj ligjore e mjetit. Akoma më tej Komisioni gjykon se zgjidhja e një konflikti hipotetikusht të mundshëm, midis operatorëve ekonomikë në lidhje me të drejtën e disponueshmërisë së mjetit, mund të jetë objekt zgjidhjeje nga organe të tjera kompetente të ngarkuara nga ligji, por kursesi nga autoriteti kontraktor në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Ky i fundit nuk e ka tagrin dhe mundësinë për tu shprehur përtej anës formale mbi vlefshmërinë e kontratave respektive të qerasë të cilat janë lidhur rregullisht përpara noterit publik. Në vijim të këtij arsyetimi Komisioni gjykon se asnjë prej operatorëve ekonomik nuk ka bindur tërësisht autoritetin kontraktor lidhur me plotësimin e kapaciteteve teknike.....Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik akimues “Alb-Shpresa” sh.p.k nuk qëndron”.

Konkluzion: Vendimi nr.43/2016, datë 22.01.2016 i KPP-së nuk është marrë në përputhje me legjisllacionin për prokurimin publik, duke mos u shprehur dhe marrë për shqyrtim dokumentin “deklaratë” bashkangjitur ankesës, bazuar në nenin 20, pika 2, të VKM nr. 184, datë 17.3.2010 e cila ka sjellë si pasojë pranimin e skualifikimit të operatorit ankimes nga AK në kushtet e nenit 65 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, duke sjellë dëm për buxhetin e shtetit në vlerën **4,039,099** lekë, vlerë që përbëhet nga diferenca e vlerës së ofertës së operatorit ankimes A.Sh. dhe vlerës së ofertës së shpallur fituese, plus tarifën për shpenzime procedurale bazuar në pikën 5, VKM nr.261, datë 17.3.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”. Oferta e operatorit A.Sh. është me vlerën më të ulët 31,753,392 lekë me një diferencë prej 3,802,163 lekë nga oferta klasifikuar në vend të pare dhe vlera e tarifës për shpenzime procedurale është 236,936 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Për sa sipër mban përgjegjësi Komisioni i përbërë nga **G. K-Kryetar, S K dhe L G.** (Relatore j L.G, G.K dhe S.K.)

Në lidhje me konstatimin e sipërm të KLSH-së, anëtarët e Komisionit G K-ish Kryetar dhe L. G, kanë bërë observacion nr. Prot 1592/6, datë 30.10.2017 (prot. i KPP-së) me komente dhe shpjegime si me poshte:

1.6.1”... audituesit shprehen që arsyetimi i KPP-së është bazuar në nenin 65....në momentin kur në akt konstatim rezulton që: Vendimi nr. 43/2016, datë 22.01.2016 i KPP-së nuk është marrë në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe konkretisht me nenin 65 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014,....”.

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Interpretimi i bërë nga anëtarët e Komisionit mbi konstatimin e KLSH-së anashkalon kuptimin substancial të konstatimit, pasi në asnjë rast në Akt konstatimin nr.1 të mbajtur nga audituesit shtetërorë nuk është shprehur “që arsyetimi i KPP-së është bërë bazuar në nenin 65”, përkundrazi KLSH arsyeton se “KPP në arsyetimin e vendimit të saj, nuk është shprehur dhe njëkohësisht nuk ka marrë në shqyrtim si pjesë e dokumentacionit “Deklaratën” e lëshuar nga operatori Elira datë 30.12.2015” e cila ka qënë jo vetëm bashkangjitur ankesës por ka qënë listuar si dokument dhe në trup të ankesës. Bazuar në nenin 17 dhe nenin 20, pika 2 të VKM nr.184, datë 17.3.2010 sipas të cilit “Anëtarët e Komisionit kanë të drejtë të njihen paraprakisht me ankesën dhe **materialet që i janë bashkëlidhur** asaj,Komisioni nuk ka marrë fare në shqyrtim këtë deklarata duke mos u shprehur për të.Gjithashtu dhe në mbështetje të nenit 27 të VKM nr.184, datë 17.3.2010, Komisioni ka detyrimin “të shqyrtojë ankesën brënda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë.Përgjashtimisht kur ka lidhje misdis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor ...vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”.

Mos marrja në shqyrtim nga **Komisioni** i dokumentit “Deklaratë”, bën të pavlefshëm në kuptim të nenit 65 të VKM nr. 914/2014 skualifikimin e ankuesit nga KVO dhe që është njëkohësisht shkak i mos pranimit të ankesës, kur gjykon se: “... në rastin konkret nuk jemi përpara situatës së rregulluar nga ligji për “Ndërhyrjen në ofertë” sikundër ka konkluduar autoriteti kontraktor por me një situatë të cilin operatorët ekonomikë në mirbesim kanë kontraktuar në bazë të parashikimeve ligjore në fuqi për të plotësuar kapacitetet e nevojshme teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit me palë të treta.....Megjithatë, përpos interpretimeve sa më sipër, **Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor i qjendur përballë të njëjtës kontratë qeraje që kalon të drejtën e disponueshmërisë së të njëtit mjet dy operatorëve të ndryshëm ekonomikë, me të drejtë ka vendosur skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit**”.

Siç shihet nga ky interpretim, Komisioni nga njëra anë pranon se nuk jemi përpara situatës së rregulluar nga ligji për “Ndërhyrjen në ofertë”, por nga ana tjetër pranon se KVO me të drejtë ka vendosur skualifikimin e operatorëve nga procedura e prokurimit duke pranuar në heshtje skualifikimin e operatorëve në kushtet e nenit 65 të VKM nr. 914/2014, pasi këtë interpretim ka bërë KVO. Argumenti i KVO-së dhe pse në interpretim të nenit 65 është bërë në kushtet kur nuk është paraqitur asnjë deklaratë në momentin e klasifikimit të ofertave pasi të dy operatorët nuk mund të dinin për dokumentet që kishin hedhur në sistem. Ndërsa vendimi i Komisionit është marrë në kushtet kur ekziston një deklaratë nga OE Elira të cilën e paraqet si document ankimesi dhe nuk merret fare në shqyrtim,duke pranuar në heshtje vendimin e KVO për skualifikimin e operatorëve në kushtet e nenit 65 të VKM nr. 914/2014. Për sa sipër, argumenti **nuk merret** në konsideratë.

1.6.2.”...Konstatimi i gabuar i audituesve me paraqitjen e një shkrese (dokumentacion) shtesë “Deklaratë”..... Komisioni i Prokurimit Publik gjykon dhe vlerëson referuar themelit të çështjes, dokumentacionin e paraqitur në SPE(..) nga operatorët ekonomikë deri në momentin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

hapjes së ofertave,..... duke gjykuar mbi vlerësimin e KVO për dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë para hapjes së ofertave. Për rrjedhojë çdo lloj dokumenti i paraqitur nga operatorët ekonomikë **pas hapjes** së ofertave që ka si synim të kthejë një ofertë të pavlefshme në një ofertë të vlefshme, **nuk mund** të kërkohet në interpretim të dispozitave të sipërcituar më lart.....”.

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Për sa sipër, subjekti argumenton në interpretim të gabuar të ligjit dhe dispozitave të tij si psh neni 53 “shqyrtimi i ofertave” etj..Operatori ankimues dhe operatori E. të cilët në këtë procedurë prokurimi janë paraqitur kontraktues (qiramarrës) të të njëjtit mjet dhe me të njëjtin kontraktor “K. Albania”, nuk mund të njiheshin para hapjes së ofertave me dokumentet e paraqitura nga secili, në mënyrë që të ndodhemi në kushtet e nenit 53 të ligjit, siç përdor Komisioni argumentin për mos shqyrtimin e “Deklaratës” së operatorit E.Operatorët janë njohur për shkaqet e skualifikimit pas hapjes së ofertave dhe klasifikimit të tyre në sistem, prandaj dhe “deklarata” e cila është bërë pas hapjes së ofertave ka vlerën e provës që duhet të merret në shqyrtim dhe nuk mund të gjykohet situata në kushtet e nenit 53 të LPP. Pikërisht në këtë fazë, operatori E. ka bërë deklaratën sipas të cilës deklararon se: “heqim dorë nga makineria lloji Frezë Bitelli si dhe kontrata e qirasë..., pasi makineria është në dispozicion të subjektit A.Sh.....sipas kontratë noteriale nr.1374 rep. nr.464 kol. Datë 20.4.2015 (.....kontratë me të cilën jemi njohur pas datës së dorëzimit të ofertave).....”. Deklarata është paraqitur si provë nga operatori ankimues bashkangjitur ankimit në KPP, dokumentacioni i cili është protokolluar nga KPP-ja dhe është paraqitur për shqyrtim në dosje. Komisioni bazuar në nenin 27, pika 2 “Kufijtë e shqyrtimit të ankesës të VKM nr. datë 17.3.2010 me ndryshime, sipas të cilit “Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, proceduralisht duhet të kishte marrë në shqyrtim këtë dokument për të cilin dhe duhet të ishte shprehur në vendimin e tij e merr ose jo në konsideratë. Për më tepër, Komisioni merr vendime bazuar në nenin 19/1 të LPP duke respektuar parimet e trasnparencës, barazisë, paanshmërisë në shqyrtimin e ankesave, ligjshmërinë, kontradiktoritetin dhe karakterin publik. Në rastin konkret çështja duke patur karakter publik, pasi bëhet fjalë për para publike dhe për më tepër LPP vendos si kriter vlerësimi, cmimin më të ulët, si dhe duke u ndodhur para faktit të gjykimit të një operatori me vlerë oferte më të ulët, Komisioni duhet të ishte më diskret në marrjen e vendimit. KLSH në konstatimin e saj ka qënë e qartë kur citon se “Komisioni **nuk është shprehur** dhe njëkohësisht **nuk ka marrë në shqyrtim** “Deklaratën” datë 30.12.2015”. Në observacionin e subjektit jepen argumente pse kjo “deklaratë” nuk mund të merret në shqyrtim ndërkohë që në asnjë pjesë arsyetuese të vendimit të Komisionit nuk është shprehur ekzistenca e këtij dokumenti dhe për më tepër shkaqet e mos pranimit të saj. Për sa sipër subjekti (anëtarët e Komisionit) duhet të shpjegojë fillimisht pse nuk është shprehur në vendim për ekzistencën e deklaratës dhe jo për pranimin apo jo të saj (shqyrtimin). Për sa sipër, argumenti **nuk merret** në konsideratë.

1.6.3”...duhet të theksoj që “Deklarata” e paraqitur nuk është shkresë e prodhuar nga ankimuesi A.Sh. por e një OE tjetër Elira...”

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Deklarata është bashkangjitur si pjesë e ankimit të operatorit A.Sh. dhe si e tillë duhet të analizohej në tërësi e ankimit të OE A.Sh.. Argumenti **nuk merret** në konsideratë.

1.6.4”...Përtej vendimit 43/2016 të KPP-së për faktin se nuk i përket themelit të çështjes, në analizë të shkresës “Deklaratë” vlerëson se kjo shkresë nuk respekton parashikimet ...Kodit Civil....”Deklarata” është e njëanshme....”.

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Në kuptim të parimeve të Kodit Civil neni 79 e vijues, “Deklarata” është veprim juridik **edhe i njëanshëm** e cila mund të bëhet me cdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit në mënyrë të thjeshtë apo me akt noterial.Kur veprimi juridik



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

bëhet në formë shkresore duhet të nënshkruhet nga personi që e kryen atë. Në rastin konkret Deklarata e OE E. është bërë në përgjegjësinë personale të deklaruesit me vullnet të plotë dhe të pavesuar duke marrë përsipër dhe pasojat nga zgjidhja e njëanshme e kontratës nëse do të konstatohen (objekt zgjidhje nga gjykata). LPP njeh heqjen dorë të OE-ve nga oferta apo lidhja e kontratës dhe pse mund të jenë shpallur fitues. Për pasojë, përtej këtij vendimi një deklaratë e bërë në përgjegjësinë personale merret në konsideratë kur është bërë në përputhje të ligjit. Në kushte të tilla pretendimi i subjektit **nuk merret** në konsideratë.

1.6.5. Në lidhje me konstatimin e KLSH për Akt Konstatimin nr. 1, ka bërë observacion dhe anëtare e Komisionit, J H datë 01.11.2017 me komente dhe shpjegime si me poshte:

1.1 “Nën cilësinë e anëtares së Komisionit....Jam shprehur mbi bazën e akteve të administruara në dosjen objekt shqyrtimi.....Në momentin e trajtimit të kësaj dosje nuk ka pasur asnjë akt tjetër “Deklaratë” përveç atyre të relatuar në mbledhje Komisioni të shprehura dhe në arsyetimin e vendimit...Bazuar në nenin 5 të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Kryetari drejton dhe organizon veprimtarinë e Komisionit....Gjithashtu në nenin 20 përcaktohet se:”.....Anëtarët e Komisionit kanë të drejtë të njihen paraprakisht me ankesën dhe materialet që i janë bashkëlidhur asaj sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 6/1...Cdo akt shkresë/ankesë kalon tek kryetari i Komisionit i cili sipas lidhjes së çështjeve ia dërgon për depozitim anëtarit relator (çdo anëtar firmos në përputhje me ligjin për marrjen në dorëzim të një akti).....Në rastin konkretnuk kam qënë relatore dhe njëkohësisht nuk kam patur dijeni për ekzistencën e kësaj deklarate. Administrimi i gjithë dokumentacionit realizohet nën drejtimin e Kryetarit I cili përgjigjet drejtpërdrejt për qarkullimin e shkresave....mes anëtarëve të Komisionit...Në rastin konkret, nëse deklarata do të ishte administruar në dosje në kohën e shqyrtimit të saj, si anëtare do të kisha shprehur qëndrimin/arsyetimin tjetër (mendim kundër apo paralel) duke e vlerësuar dhe këtë document i cili duhej të ishte relatuar me qëllim arritjen e një vendimmarjeje sa më të drejtë dhe objektivë....”.

Qendrimi i audituesve KLSH-së: Sa sipër duke mos qënë në dijeni të deklaratës që në zbatim të nenit 20 të VKM nr.184, datë 17.3.2010 duhet të ishte bërë e njohur paraprakisht së bashku me materialet bashkangjitur ankesës nga Kryetari I Komisionit, si dhe në pamundësinë për tu shprehur në lidhje me të, observacioni **merret në konsideratë** duke u pasqyruar në Projektraport.(përgjegjësia).

1.7. Vendimi nr. 531/2016, datë 13.07.2016 me të dhënat si më poshtë:

Ankues	Objekti	F. limit pa TVSH	VL. Ofertes ankues	Dif. OE fitues dhe ankuesit	Pranuar/Jo
A Co	Blr. Prokate celiku marak 40 cr dhe 3cr 13(AK-Albpetrol)	18,375,000	17,945,000	2,291,000	po

nuk është në përputhje me:

- legjislacionin e prokurimit publik, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 19/1, pika 3, neni 46, pika1, neni 53, pika 3,
- Dokumentet e Tenderit (DT) të miratuar nga AK (Albpetrol)-Kriteret e vecanta të kualifikimit “Kapaciteti teknik”, pika 2.3, germa a,
- VKM nr.184, date 17.3.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimeve Publike dhe për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.659, datë 3.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, me mjete elektronike” me ndryshime, neni 27, pika 2.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

-VKM nr.261, datë 17.3.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, pika 5.

Argumentat:

KPP në vendimin nr. 531, datë 13.7.2016 ka vendosur:

“1.Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “A Co” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-28995-03-17-2016 me objekt:“*Blerje Prokate celiku të markave 40 Cr dhe 3 Cr13*”, me fond limit 18.375.000 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 13.04.2016, nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “M” sh.p.k dhe “S” sh.p.k dhe të operatorit ekonomik “2RC” sh.p.k duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A Co” sh.p.k. “.

Për sa sipër, KPP në skualifikimin e operatorëve ekonomikë “M” sh.p.k dhe “S” sh.p.k dhe të operatorit ekonomik “2RC” sh.p.k argumenton se:

“III.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “A Co” sh.p.k për kundërshtimin e kualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “M” sh.p.k dhe “S” sh.p.k Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

-Në Shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nga Autoriteti Kontraktor “Kapaciteti teknik” rezulton se është përcaktuar:

“Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 7 300 000 (shtatë milion e treqind mijë) leke (40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), të realizuara gjatë tre viteve të fundit financiare të aktivitetit të operatorit:

Këto furnizime të së njëjtës natyrë do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë :

Kur furnizimi i së njëjtës natyrë është realizuar me ente publike, me vërtetime të lëshuara nga enti publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

OSE

Kur furnizimi i së njëjtës natyrë.....realizuar me subjekte private, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes,”.

Sa më sipër cituar, Komisioni gjykon se referuar kontratës së bashkëpunimit Nr. 1128 Rep. lidhur me datë 07.04.2016 ndërmjet shoqërisë “M” sh.p.k dhe “S” sh.p.k, palët e mësipërme kanë rënë dakort sipas punimeve të kryera, të bëjnë dhe ndarjen e fitimit, në raportet shoqëria “M” sh.p.k 28 % të fitimit dhe shoqëria “S” sh.p.k 72 % të fitimit. Dokumentacioni në tërësi i paraqitur nga operatori ekonomik “S” sh.p.k si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë “M” sh.p.k dhe “S” sh.p.k **nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për furnizimet e mëparshme të ngjashme**, kontrata e vetme e paraqitur e lidhur me një autoritet publik është e një natyre krejt tjetër përkatësisht për punë publike dhe jo kontratë furnizimi që autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë në rastin konkret”.

Argumenti i sipërm i Komisionit, nuk është në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 46, pika1/b, neni 53, pika 3,4 dhe neni 19/1, pika 3, pasi:

Së pari: Referuar kontratës nr.145/3, datë 12.10.2012 paraqitur nga OE Senka anëtar i BOE “M& S” (me vlerën më të ulët të ofertës 15,654,000 lekë pa TVSH), me objekt: “SP Ujësjetllësi Vorë-Picar-Dedëj dhe STP Qendror ujësjetllësi rajonal Bashkia Vorë” dhe konkretisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

situacionit përfundimtar që është pjesë e kontratës së cituar, rezulton se zëri “Fv tub celiku Ø 355.6x7.1mm” në vlerën 29,11,892,629 lekë, përmbush kriterin e vendosur nga AK për furnizime të ngjashme në vlerën jo më të vogël se 7,300,000 lekë (“tub celiku” është material në gjendje të përpunuar dhe “prokate celiku” që kërkon AK është material në gjendje të papërpunuar).

Komisioni kur merr në shqyrtim kontratën nr.145/3, datë 12.10.2012 zërin “Fv tub celiku Ø 355.6x7.1mm” në vlerën **29,11,892,629** lekë, nuk e trajton si “furnizim të ngjashëm” dhe për pasojë gjykon në mënyrë sipërfaqësore, formale dhe nuk shqyrton çështjen në thellim.

Kontrata e paraqitur nga operatori Senka e cila është e llojit “punë publike” siç dhe argumenton Komisioni, përfshin edhe “furnizimin”, duke e bërë këtë kontratë edhe të llojit “furnizim” sipas legjislacionit të prokurimit publik neni 3. Për pasojë kontrata për pjesën e “furnizimit” duhet të merret në konsideratë, pasi është e natyrës së ngjashme me objektin që ka kërkuar AK dhe në vlerën e kërkuar. Sic mund të shihet, kriteri për furnizime të mëparshme të ngjashme përmbushet vetëm nga ky OE pjesë e BOE dhe jo siç argumenton KPP se: “kontrata e vetme e paraqitur e lidhur me një autoritet publik është e një **natyre krejt tjetër përkatësisht për punë publike dhe jo kontratë furnizimi** që autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë në rastin konkret. Për përmbushjen e kriterit për furnizimet e mëparshme, nuk mund të pretendohet për eksperiencën të njëjta, pasi kjo bie në kundërshtim me vetë ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe konkretisht me nenin 1 të tij, gjë e cila çon në diskriminimin e operatorëve ekonomikë dhe mos trajtim të barabartë të tyre në një procedurë prokurimi.

Në këto kushte, argumenti KPP-së në lidhje me kriterin për furnizime të ngjashme bie ndesh me nenin 46, pika 1/b, nenin 53, pika 3,4 dhe nenin 19/1, pika 3, pasi Komisioni nuk ka mbajtur parasysh, përveç parimimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 2 të këtij ligji edhe parimin e paanshmërisë në shqyrtimin e ankesave, ligjshmërinë, kontradiktoritetin dhe karakterin publik, duke sjellë si pasojë skualifikimin e BOE “M & S”.

KPP në lidhje me argumentin e sipërcituar mban qëndrime të ndryshme për raste të së njëjtës natyre dhe konkretisht:

Në arsyetimin e **Vendimit nr.84/2016**, datë 19.2.2016 lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Sh” sh.p.k. se: “**OE “S & Co Company” shpk nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik të KVK të DST-ve, kontrata e paraqitur për të përmbushur këtë kriter nuk është kontratë e ngjashme[...]**”, Komisioni, vëren se:

“Në dokumentat e tenderit Shtojca 10,... autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin e mallit dhe konkretisht furgon i blinduar i përdorur (5 copë). Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “S & Co Company” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të sipërcituar është paraqitur ...: Kontrata e lidhur ndërmjet shoqërisë “S & Co Company” sh.p.k. dhe shoqërisë “A” ...me objekt “Kontratë shitblerje për mjet ekskavator”. Rrjedhimisht, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në plotësimin e kriterit për furnizimet e mëparshme nuk mund të pretendohet për eksperiencën të njëjta, pasi kjo bie në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Pretendimi i eksperiencave të njëjta apo zërave të njëjtë të shërbimeve/punëve dhe mallrave, bie në kundërshtim edhe me vetë frymën dhe qëllimin e ligjit të përcaktuara në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të këtyre operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik “S & Co Company” sh.p.k. e ka përmbushur kriterin e kualifikimit duke vërtetuar kështu se disponon kapacitetet në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë”.

Sic shihet nga ky arsyetim, Komisioni **klasifikon si furnizime të ngjashme** “ekskavatorin” me një **“mjet të blinduar”** duke pranuar se nuk mund të pretendohet për eksperiencën të “njëjta” dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

nuk klasifikon si furnizime të ngjashme “prokate celiku (lëndë e parë lingota hekuri)” me “**tuba celiku** (hekur përpunuar)”, sikurse bën në arsyetimin e vendimit të sipërm nr.531/2016. Komisioni mban qëndrime të ndryshme për çështje të njëjta por jo “të ngjashme” duke favorizuar në çdo rast, ofertën me vlerë më të lartë, të cilat janë shoqëruar me dëm ekonomik. Komisioni ka detyrimin ligjor të shprehet në lidhje me mangësitë apo shkeljet e konstatuara nga KVO duke korigjuar apo detyruar AK-të të korigjojnë vendimet/veprimet në vlerësimin e ofertave, pasi cënohet thelbi i LPP-së, bazuar në nenin 28 të VKM nr.184, datë 17.3.2010, duke marrë në konsideratë dhe faktin se është oferta me vlerën më të ulët.

Së dyti: Komisioni nga ana tjetër, me anë të këtij vendimi ka kërkuar shqyrtimin e çështjes në themel që në fazën kur ka bërë vlerësimin paraprak të çështjes (pjesa I), por në fakt nuk e ka shqyrtuar atë në themel, pasi nuk ka marrë në shqyrtim provat dhe rrethanat e kualifikimit të operatorit ankimues A Co, duke mos i vendosur në pozitë të barabartë të gjithë palët (aktorët). Për pasojë, Komisioni nuk ka përdorur në gjykimin e tij parimin e “armëve të barabarta”, por ka vlerësuar vetëm dokumentacionin e BOE subject i ankimit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 27, pika 2 të VKM nr.184, datë 17.3.2010 me ndryshime, si dhe me nenin 19/1, pika 3 të LPP-së, duke mos shqyrtuar në themel dokumentacionin e paraqitur nga të gjithë operatorët pjesëmarrës.

Nëse Komisioni do gjykonte në themel dhe dokumentacionin e EO “A Co” në lidhje me plotësimin e kriterit të (DT) pika 2.3, germa a) sipas të cilit “.....**Kur furnizimi i së njëjtës natyrë është realizuar me ente publike, me vërtetime të lëshuara nga enti publik...**”, do të konstatonte se:

-Kontrata për furnizime të ngjashme nr.3540/5, datë 14.7.2015 me vlerë 22,488,000 lekë pa TVSH e operatorit A Co, nuk përmbush kriterin e sipërm, pasi nuk shoqërohet me vërtetimin e vlerësimit lëshuar nga AK. Gjithashtu ky operator nuk plotëson dhe kriterin tjetër 2.1”Kapaciteti ligjor”, pika b, sipas të cilit kërkohet “...*Pjesët specifike të katalogut ku jepen karakteristikat e mallit që prokurohet... të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen*”, pasi katalogu i paraqitur nuk është i përkthyer.

Në vendimin e KPP-së është bërë “shënimi” nga anëtare e Komisionit J H e cila citon se:” *Nga verifikimi i dokumentacionit lidhur me kriterin kontrata të ngjashme të operatorit A Co rezulton se ka realizuarkontrata të ngjashme*”, ndërkohë që Komisioni në tërësinë e tij vendimmarrëse nuk e ka marrë në shqyrtim këtë fakt për operatorin ankimues Alen Co, për të cilin nuk është shprehur fare në vendimin e tij.

Nga ana tjetër edhe kontratat nr.2286/12, datë 5.9.2013, nr. 3722/1, datë 13.10.2014 si dhe kontrata nr.3267/1, datë 25.8.2014 të paraqitura ng ky operator, megjithëse janë kontratat të mirëfillta furnizimi, objekt i tyre nuk janë **mallra të ngjashme** apo të së njëjtës natyrë të kërkuara nga AK, por janë **mjete riparimi** të tilla si: rondele, kuadër plastic, vida dado etj. që në asnjë rast nuk janë prokate celiku (qoftë në formë të papërpunuar apo të përpunuar p.sh. tub celiku etj.) Nga kjo pikëpamje, këto kontrata nuk mund të merren në konsideratë pasi nuk mund të trajtohen si furnizime të ngjashme. Në kushte të tilla operatori “Alen Co” duhet të ishte skualifikuar.

Së treti: Arsyetim i njëjtë bëhet dhe për rastin e skualifikimit të operatorit ekonomik “2RC” sh.p.k nga Komisioni, i cili argumenton me të njëjtën logjikë si për skualifikimin e BOE “M & S”, për mospërmbushje të kriterit kontrata të ngjashme, ndërkohë që dhe ky operator në kontratën e punës nr. 3048/9, datë 25.6.2014 dhe situacionin e datës 12.4.2016 ka kryer furnizime të ngjashme “metale celiku” në vlerën 9,149,520 lekë. Për rrjedhojë, skualifikimi i këtij operatori nga Komisioni bie ndesh me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 me ndryshime, neni 46, pika 1/b, nenin 53, pika 3,4.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Konkluzion: Për sa sipër konstatuar, Vendimi nr. 531/2016, datë 13.07.2016 i KPP-së nuk është në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe konkretisht me nenin 19/1, pika 3, nenin 46, pika 1, neni 53, pika 3, DT të miratuar nga AK (Albpetrol)-Kriteret e vecanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3, germa a, VKM nr.184, datë 17.3.2010 me ndryshime, neni 27, pika 2, pasi ka skualifikuar pa të drejtë operatorët ekonomikë “M & S” dhe “2RC” dhe nuk ka shqyrtuar në themel çështjen dhe për pjesën e dokumentacionit të operatorit ankimues A Co, duke sjellë si pasojë për buxhetin e shtetit dëm në vlerën **2,382,850** lekë (17,945,000-15,654,000+91,850), vlerë e cila përbëhet nga diferenca mes vlerës së ofertës së operatorit ankimues Alen Co (pas vendimit të KPP) dhe vlerës së ofertës së ofertës më të ulët të klasifikuar nga KVO (para vendimit të KPP), plus tarifën për shpenzime procedurale kthyer me vendimin nr. 531, datë 13.7.2016 pas pranimit të ankesës bazuar në pikën 5, VKM nr.261, datë 17.3.2010. Për sa sipër mban përgjegjësi Komisioni i përbërë nga **G K-Kryetar, S K, J. H, L G dhe H.B.**

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH ^{-së} : Në lidhje me konstatimin e sipërm të KLSH-së, anëtarët e Komisionit G K-ish Kryetar dhe L G, kanë bërë observacion nr. Prot 798/1, datë 22.11.2017 (prot. i KPP-së) me komente dhe shpjegime si me poshte i cili pasi u mor në shqyrtim **nuk merret në konsideratë** me arsyetimin:

Pretendimi i subjektit: “... audituesit kanë arritur në konkluzionin se kjo kontratë e plotëson kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Referuar kontratës nr.145/3, datë 12.10.2012 kjo kontratë është ndërmjet BOE Senka shpk dhe DPG Company shpk (pra S nuk shfaqet e vetme në këtë kontratë....nga ku nuk rezulton se këtë punë e kanë kryer si bashkim operatorësh.....”.

Qëndrimi i audituesve KLSH-së:Lidhur me këtë pretendim të subjektit dhe pse në Akt konstatimin e mbajtur është shprehur qartë pse ky OE plotëson kriterin e AK po ritheksojme përsëri se: situacionit përfundimtar që është pjesë e kontratës së cituar nga 2 anëtarëte Komisionit në këtë observacion , është paraqitur pikërisht nga OE Senka nga ku rezulton se zëri “Fv tub celiku Ø 355.6x7.1mm” në vlerën 29,11,892,629 lekë, përmbush kriterin e vendosur nga AK për furnizime të ngjashme pasi zëri “tub celiku” është material në gjendje të përpunuar dhe materiali “prokate celiku” që kërkon AK është material në gjendje të papërpunuar.Siç shihet si në kontratën e paraqitur si document për plotësimin e kriterit të AK (kontrata nr.145/3, datë 12.10.2012) ku OE S ka kryer këtë punim ashtu dhe ne rastin e BEO me OE Metalografi ku S ka 72% të kryerjes së punimve ai e plotëson këtë kriter.KPP nuk merr në konsideratë faktin që për të njëjtin problem ka mbajtur qëndrime të ndryshme në dhënien e vendimeve nga ana e saj (shih vendimin nr.84, datë 19.2.2016).Ndodhur në këto kushte pretendimi I subjektit **nuk merret në konsideratë**.Për pretendimet e tjera meqënëse në arsyetimin e tyre 2 anëtarët e KPP nuk sjellin ndonjë argument të ri, pretendimi nuk qëndron me arsyetimin e dhënë në akt konstatimin e mbajtur nga audituesit shtetërorë.

Lidhur me vendimin e KPP nr. 692/2015 datë 16.11.2015 të trajtuar në projektraport, OE “J konstruksion” sh.p.k. është ankuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila e ka rëzuar padinë e tij. Ky vendim, megjithëse nuk ka trajtuar plotësisht elementët e ankesës, është marrë në konsideratë nga grupi i auditimit dhe është reflektuar në Raportin Përfundimtar. Gjatë auditimit u shqyrtuan vendimet e KPP nr. 53, date 04.02.2016, nr. 531, datë 13.07.2016, nr. 116, datë 04.03.2016, nr. 74, date 21.2.2017, nr. 44, datë 3.2.2017, nr. 22/2015, nr. 10/2015, nr. 27/2015, nr. 435/2015, nr. 465/2015, nr. 362/2015, nr. 515/2015, nr. 516/2015, nr. 662/2015, nr. 663/2015, nr. 741/2015, nr. 22/2016, nr. 43/2016, nr. 116/2016, nr. 84/2016, nr. 290/2017, nr. 467/2017, nr. 583/2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

2. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit

Programimi dhe Realizimi i Buxhetit të Komisionit të Prokurimit Publik ka për qëllim mbulimin e shpenzimeve për realizimin e funksioneve në lidhje me shqyrtimin e ankesave në fushën e prokurimeve publike, koncensioneve, ankandeve publike dhe lejeve minerare në

Për realizimin e këtij auditimi ka shërbyer si bazë vlerësimi:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Vendimi nr. 184, datë 17.03.2010 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik dhe për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 659, datë 03.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik me mjete elektronike” e ndryshuar me VKM-në Nr. 122, datë 22.02.2012;

Ligji Nr. 160/2014, “Për Buxhetin e vitit 2015”,

Ligji Nr. 147/2015, “Për Buxhetin e vitit 2016”,

Ligji Nr. 130/2016, “Për Buxhetin e vitit 2017”.

territorin e Republikës së Shqipërisë.

Për vitin 2015, procesi i planifikimit e zbatimit të buxhetit dhe situata buxhetore me treguesit e realizimit të tij në institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik, paraqitet si vijon:

Shpenzimet e përgjithshme (duke përfshirë të gjithë zërat e buxhetit 600, 601, 602, 231), janë realizuar në masën 25,880.3 mijë lekë nga 26,770 mijë lekë që ishte buxheti i rishikuar për vitin 2015, e shprehur si realizim në përqindje në masën 96.7% të planit vjetor.

Titulli	Emërtimi	Buxheti i rishikuar viti 2015 në mijë lekë	Realizimi për vitin 2015	
			në mijë lekë	në %
87	Komisioni i Prokurimit Publik	25,880.3	25,880.3	96.7%
01130	Shërbimi i Prokurimit Publik			

Shpenzimet korente në fund të vitit 2015, kanë arritur në shumën 25,764.2 mijë lekë ose rreth 100% e buxhetit të rishikuar për vitin 2015, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 5.8 mijë lekë.

600 - Zëri “Paga”, rezulton se 18,701.9 mijë lekë është shfrytëzuar nga 18,706.0 mijë lekë nga buxheti i rishikuar i 2015. Përdorimi i fondit të pagës është realizuar në masën 100%.

601 - Artikulli 601 “Kontribute për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore”, rezulton me një realizim prej 2,963.2 mijë lekë, nga 2,964.0 mijë lekë që është buxheti i rishikuar i vitit 2015, pra realizuar pothuajse 100%.

602 - Artikulli 602, përkatësisht “Shpenzime për mallra e shërbime”, gjatë vitit 2015, rezulton me një realizim vjetor prej 4,099.1 mijë lekë nga 4,100.0 lekë që është buxheti i rishikuar i vitit 2015 për institucionin tonë, ose afërsisht me 100% të planit vjetor.

Shpenzimet kapitale deri në fund të vitit 2015, janë realizuar në masën 116.2 mijë ose rreth 11.6% e planit vjetor, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 883.8 mijë lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Një përmbledhje mbi mjaftueshmërinë e përdorimit të fondeve për vitin 2015, nga Komisioni i Prokurimit Publik, për të gjithë zërat e buxhetit, paraqitet në tabelën më poshtë:

Artikulli	Emërtimi	Buxheti i rishikuar viti 2015 në mijë lekë	Realizimi për vitin 2015	
			në mijë lekë	në %
600	Paga	18,706.0	18,701.9	100%
601	Sigurime shoq.& shëndetësore	2,964.0	2,963.2	100%
602	Mallra e shërbime të tjera	4,100.0	4,099.1	100%
600 - 606	TOTAL Shpenzime korente	25,770.0	25,764.2	100 %
231	Shpenzime kapitale	1,000.0	116.2	11.6%
231	TOTAL Shpenzime kapitale	1,000.0	116.2	11.6%
	TOTAL BUXHET	26,770.0	25,880.3	96.7%

Për vitin 2016 procesi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit me treguesit e realizimit të tij, paraqitet si vijon:

Shpenzimet e përgjithshme, kanë arritur në 25,579.2 mijë lekë nga 33,000.0 mijë lekë që ishte buxheti për vitin 2016, duke u realizuar në masën 77.5% të planit vjetor.

Titulli	Emërtimi	Buxheti i vitit 2016 në mijë lekë	Realizimi për vitin 2016	
			në mijë lekë	në %
87	Komisioni i Prokurimit Publik	33,000.0	25,579.2	77.5%
01130	Shërbimi i Prokurimit Publik			

Shpenzimet korrente në fund të vitit 2016, kanë arritur në shumën 25,000.6 mijë lekë ose rreth 78.1% e buxhetit për vitin 2016, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 6,999.4 mijë lekë.

600 - Zëri “Paga”, rezulton se 17,972.8 mijë lekë është shfrytëzuar, nga 21,800.0 mijë lekë të parashikuara. Pra, kemi një përdorim të fondit të pagës në masën 82.4%.

601 - Artikulli 601 “Kontribute për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore”, rezulton me një realizim prej 2,772.7 mijë lekë, nga 3,200.0 mijë lekë, pra pothuajse 86.6%.

602 - Artikulli 602, përkatësisht “Shpenzime për mallra e shërbime”, rezulton me një realizim vjetor prej 4,255.1 mijë lekë nga 7,000.0 lekë ose afërsisht me 60.8% të planit vjetor.

Shpenzimet kapitale deri në fund të vitit 2016, janë realizuar në masën 578.6 mijë ose rreth 57.9% e planit vjetor, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 421.4 mijë lekë.

Për 8 mujorin e vitit 2017, si periudhë objekt auditimi situata buxhetore e KPP paraqitet sipas treguesëve të mëposhtëm:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Shpenzimet e përgjithshme, në fund të 8-mujorit të vitit 2017, kanë arritur në vlerën 17,800.4 mijë lekë nga 34,400.0 mijë lekë, e shprehur si realizim në përqindje në masën 51.7% të planit vjetor.

Titulli	Emërtimi	Buxheti i vitit 2017 në mijë lekë	Realizimi për 8-mujorin e vitit 2017	
			në mijë lekë	në %
87	Komisioni i Prokurimit Publik	34,400.0	17,800.4	51.7%
01130	Shërbimi i Prokurimit Publik			

Shpenzimet korente kanë arritur në shumën 17,800.4 mijë lekë ose rreth 53.3% e buxhetit të planifikuar për vitin 2017.

Shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 0.0 mijë e planit vjetor, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 1,000.0 mijë lekë.

Artikulli	Emërtimi	Buxheti i vitit 2017 në 000 lekë	Realizimi për 8-mujorin e parë të vitit 2017	
			në 000 lekë	në %
600	Paga	21,800.0	13,499.3	61.9%
601	Sigurime shoq.& shëndetësore	4,600.0	2,088.7	45.4%
602	Mallra e shërbime të tjera	7,000.0	2,212.4	31.6%
600 - 606	TOTAL Shpenzime korente	33,400.0	17,800.4	53.3%
231	Shpenzime kapitale	1,000.0	0.0	0.0%
231	TOTAL Shpenzime kapitale	1,000.0	0.0	0.0%
	TOTAL BUXHET	34,400.0	17,800.4	51.7%

Nga auditimi i dokumentacionit për artikujt 600 dhe 601 për të gjithë periudhën objekt auditimi, konstatuam se:

Institucioni për periudhën objekt auditimi, nuk ka funksionuar në kapacitet të plotë sipas organikës. Për vitin 2015, nga 7 inspektor të parashikuar, KPP ka funksionuar me 6 të tillë. Për vitin 2016, KPP ka funksionuar me dy inspektorë më pak dhe dy specialistë më pak se numri i përcaktuar në strukturë.

Zbatimi i plotë i Urdhrit të KM Nr.60, datë 12.5.2017, për plotësimin e strukturës me 30 punonjës në total është ende i pa zbatuar për shkak të pezullimit të procesit të rekrutimit nga Departamenti i Administratës Publike.

E vlerësojme me rëndësi dhe imediat plotësimin e strukturës së Komisionit të Prokurimit Publik në zbatim të Urdhrit Nr. 60 të KM, datë 12.5.2017; në kuadër të rritjes së eficiencës dhe efektivitetit në përmbushjen e detyrave funksionale të KPP.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Bazuar në treguesit buxhetor të Komisionit të Prokurimit Publik për periudhën objekt auditimi, konstatohet se në përgjithësi zërat e buxhetit janë realizuar përafërsisht në masën e parashikuar duke mos konstatuar diferenca.

3. Mbi krijimin dhe administrimin e të ardhurave jashtë buxhetore

Të ardhurat jashtë buxhetore për Komisionit të Prokurimit Publik gjenerohen nëpërmjet pagesës për shqyrtimin e ankesave nga operatorët ekonomik. Ankesat pranë KPP bëhen kundrejt pagesës, parashikuar në nenin 63 pika 10 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

Rregullat dhe tarifat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Aktualisht janë në fuqi:

- Vendimi Nr. 261 datë 17.03.2010 i KM, “Për përcaktimin e tarifës dhe rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”;
- Vendimi nr.401, datë 13.05.2015, “Për Përcaktimin e Tarifës dhe të Rregullave për Pagimin e Saj në një Procedurë Prokurimi të Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, Pranë Komisionit të Prokurimit Publik;
- Vendimi nr.56, datë 19.01.2011 i Këshillit të Ministrave “Për Përcaktimin e Tarifës dhe të Rregullave për Pagimin e Saj në një Procedure Ankimi ndaj Procedurave të Ankandit Publik apo Vendimeve për Përrjashtim nga to, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”,
- Vendimi Nr. Nr. 301, datë 20.4.2016 i KM “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 320, Datë 21.4.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Procedurave e të Kriterëve të Konkurrimit dhe të Afateve të Shqyrtimit të Kërkesave për Marrjen e Lejeve Minerare në Zonat Konkurruese,”.

Për vitin 2015, janë siguruar **136,734,434** lekë si të ardhura jashtë-buxhetore.

	Totali i të ardhurave viti 2015	
	Në lekë	Në %
Të pranuar dhe të kthyer ankimuesve	64,818,118	47.40%
Të papranuar dhe kaluar në buxhet të shtetit	70,349,972	51.45%
Të pranuar gjatë 2015, por që do të kthehen në 2016	1,566,344	1.15%
TOTAL të ardhura të arketuara gjatë 2015	136,734,434	100%

Bazuar në pikën 5 të Vendimin Nr. 261 datë 17.03.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik shuma prej **64,818,118** lekë ju është kthyer operatorëve ekonomikë ankimues, të cilëve u është pranuar ankesa në bazë të vendimeve të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik deri në datën 31 Dhjetor 2015, ndërsa shuma prej **70,349,972** lekë, që rezulton nga vendimet jo në favor të ankimuesve, ka kaluar në buxhet të shtetit. Këtyre dy shumave të mësipërme u shtohet edhe një shumë prej **1,566,344** lekë, të cilat janë para të arkëtuara nga KPP gjatë vitit 2015, vendime të marra nga KPP po gjatë vitit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

2015, por në pamundësi për t'u kthyer brenda vitit ato do t'u kthehen operatorëve ankimues gjatë vitit 2016.

	Çështje me pagesë		Shuma e pagesës	
	Numri	%	Shuma lekë	%
Procedurë prokurimi publik	1,111	98.8%	109,896,469	80.4%
Procedurë koncesioni	3	0.3%	25,372,251	18.6%
Procedurë ankandi	10	0.9%	1,465,714	1.1%
Procedurë leje minerare	-	0.0%	0	0.0%
TOTAL	1,124	100%	136,734,434	100%

Referuar akteve nënligjore të mësipërme pagesa e tarifës i kthehet ankimuesit, kur, në fund të procesit të ankimit, ankesa e tij pranohet. Kur ankesa nuk pranohet, të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e ankimimit kalojnë në masën 100 % në Buxhetin e Shtetit.

Për vitin 2016, janë siguruar **136,749,583** lekë si të ardhura jashtë-buxhetore.

	Totali i të ardhurave viti 2016	
	Në lekë	Në %
Të pranuar dhe të kthyer ankimuesve	46,121,816	33.73%
Të papranuar dhe kaluar në buxhet të shtetit	81,703,907	59.75%
Të pranuar gjatë 2016, por që do të kthehen në 2017	8,923,860	6.52%
TOTAL të ardhura të arkëtuara gjatë 2016	136,749,583	100%

Në total gjatë vitit 2016 shuma prej **46,121,816** lekë iu është kthyer OE ankimues, të cilëve u është pranuar ankesa në bazë të vendimeve të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik deri në datën 31 Dhjetor 2016, ndërsa shuma prej **81,703,907** lekë, që rezulton nga vendimet jo në favor të ankimuesve, ka kaluar në Buxhet të Shtetit. Këtyre dy shumave të mësipërme u shtohet edhe një shumë prej **8,923,860** lekë, të cilat janë para të arkëtuara nga KPP gjatë vitit 2016, vendime të marra nga KPP po gjatë vitit 2016, por në pamundësi për t'u kthyer brenda vitit, ato do t'u kthehen operatorëve ankimues gjatë vitit 2017.

	Çështje me pagesë		Shuma e pagesës	
	Numri	%	Shuma lekë	%
Procedurë prokurimi publik	1,387	99.57%	133,292,602	97.47%
Procedurë koncesioni	1	0.07%	3,362,500	2.46%
Procedurë ankandi	5	0.36%	94,481	0.07%
Procedurë leje minerare	-	0.0%	0	0.00%
TOTAL	1,393	100%	136,749,583	100%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Për 8 mujorin e vitit 2017 (si periudhë objekt auditimi), i është kthyer operatorëve ekonomik të cilëve i është pranuar ankesa, shuma prej **26,201,347 lekë** dhe ka kaluar në buxhet të shtetit shuma **51,343,148 lekë**.

Një përmbledhje numerike e të gjithë periudhës paraqitet në tabelën më poshtë:

	Kthyer (lekë)	Buxhet (lekë)
Viti 2015	66,371,585	70,349,972
Viti 2016	53,872,614	81,759,806
Viti 2017 (8 mujori)	26,201,347	51,343,148
TOTALI	146,445,546	203,452,926

4. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit

Në zbatim të Programit të Auditimit u auditua organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e balanceve për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2016.

Referenca ligjore për auditimin e kësaj:

- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”,
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 62 “Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit”,
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e llogarive vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive të menaxhim zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”,
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006”.

Analiza e Pasqyrës Financiare 2015

Disa tregues të reduktuar të Pasqyrave Financiare, paraqiten si vijon:

(në lekë)

Nr	Aktivi	2015	2014
1	Aktive të Qëndrueshme	8,425,837.00	10,957,040.00
2	Aktive Qarkulluese	10,852,654.00	7,180,620
	Totali i Aktivit	19,278,491.00	18,137,660.00

Sipas të dhënave të konsoliduara në Aktivin e Bilancit kontabël, rezulton se më 31.12.2015, Aktivët e Qëndrueshme zënë 44% të total Aktivit, ndërsa Aktivët Qarkulluese zënë 56%.

Aktivët e Qëndrueshme përfaqësojnë aktivet në Komisionin e Prokurimit Publik. Ato janë paraqitur në Bilanc sipas vlerave të regjistruara në kontabilitet të përbëra nga dy grupe: Aktive të Qëndrueshme të Patrupëzuara dhe Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara si vijon:

(në lekë)

A	Aktive të Qëndrueshme	2015	2014
---	-----------------------	------	------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

202	Aktive të Qëndrueshme të Patrupëzuara	-	-
Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara			
210	Toka, Troje, Terrene	-	-
212	Ndërtime dhe konstruksione	-	
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	-	-
214	Inst. Teknike, mak.& pajisje	861,000.00	861,000.00
218	Inventar ekonomik	21,892,529.00	21,776,369.00
215	Mjete transporti	-	-
219	Amortizimi total	-14,327,692.00	-11,680,329.00
232	Investime në proces	-	-
Total AQT		8,425,837.00	10,957,040.00

(në lekë)

Llog	Aktive Qarkulluese	2015	2014
31	Inventari	1,812,111.00	1,765,356.00
4342	Të tjera operacione me shtetin (debitor)	1,992,841.00	1,950,523.00
520	Disponibilitete	7,047,702.00	3,464,741.00
532	Vlera të tjera	-	-
	Total	10,852,654.00	7,180,620.00

Nga auditimi u konstatua se, kemi rritje në total Aktivët Qarkulluese me rreth 3,672,034 lekë për vitin 2015, krahasuar me vitin 2014, kryesisht prej detyrimeve të shtetit për paga dhe sigurime shoqërore në fund të muajit.

Nga auditimi i formatit të Pasivit të Bilancit Kontabël për vitin 2015, u konstatua se, pasivi përbëhet në masën 53% nga Fondet e Veta në vlerën 10,2 milion lekë dhe 47% nga Detyrimet Afatshkurtër në vlerën 9 milion lekë.

(në lekë)

Pasive	2015	2014
Fondet e Veta	10,237,948.00	12,722,396.00
Detyrime Afatshkurtër	9,040,543.00	5,415,264.00
Totali i Pasivit	19,278,491.00	18,137,660.00



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Në mënyrë më të detajuar në vijim Detyrimet Afatshkurtër për dy vite të njëpasnjëshëm ushtrimorë, të cilat rezultojnë me një rritje prej 3,625,279 lekë .

(në lekë)

Llog	Detyrime Afatshkurtër	2015	2014
401-408	Furnitorë e Llog të lidhura me to	137,614.00	77,454.00
42	Personeli e llog të lidhura me to	1,304,879.00	1,177,605.00
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	135,935.00	173,338.00
4341	Të tjera operacione me shtetin kreditor	-	-
435	Sigurime shoqërore	359,753.00	453,535.00
436	Sigurime shëndetësore	54,660.00	68,591.00
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	-	-
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	-	-
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	7,047,702.00	3,464,741.00
467	Kreditorë të ndryshëm	-	-
	Total Detyrime Afatshkurtër	9,040,543.00	5,415,264.00

Nga auditimi i Pasqyrës së “Të Ardhura-Shpenzime” u konstatua se:

Shpenzimet korrente për Komisionin e Prokurimit Publik janë 25,806,496 lekë, duke reflektuar kështu një ulje me 10%, krahasuar me një vit më parë. Kjo ulje vjen kryesisht nga ulja në shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe ulja në shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera. Ulja e pagave lidhet me shtimin e vendeve vakante për KPP-në në tërësi gjatë vitit 2015.

(në lekë)

Shpenzime korrente	2015	2014
Paga	18,751,902.00	19,745,844.00
Sigurime	2,895,352.00	3,006,878.00
Mallra dhe Shërbime	4,159,242.00	5,752,100.00
Transferime korrente të brendshme	-	-
Tranferime për buxhetet familjarë dhe individë	-	-
Ndryshimi i gjendjeve të inventarit	-46,755.00	14,170.00
D. Operac/ Korigj rezultati	70,307,807.00	39,793,950.00
Total	96,067,548.00	68,284,602.00

Sa i takon pasqyrës së “Të Ardhura-Shpenzime”, nga auditimi u konstatua se 100% e të ardhurave të Komisionit të Prokurimit Publik përbëhet nga të ardhura nga Buxheti i Shtetit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

(në lekë)

Të Ardhura	2015	2014
Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	-	-
Shërbime adm. e ardhura sekondare	70,261,052.00	39,776,769.00
Të tjera të ardhura jo tatimore	-	-
Grant korent i brendshëm	25,806,496.00	28,504,969.00
Korrigjime nga vitet e kaluara	-	2,864.00
Total	96,067,548.00	68,284,602.00

Analiza e Pasqyrës Financiare 2016

Disa tregues të reduktuar të Pasqyrave Financiare, paraqiten si vijon:

(në lekë)

Nr	Aktivi	2016	2015
1	Aktive të Qëndrueshme	7,078,615.00	8,425,837.00
2	Aktive Qarkulluese	21,728,515.00	10,852,654.00
	Totali I Aktivit	28,807,130.00	19,278,491.00

Sipas të dhënave të konsoliduara në Aktivin e Bilancit kontabël, rezulton se më 31.12.2016, Aktivët e Qëndrueshme zënë 33% të total Aktivit, ndërsa Aktivët Qarkulluese zënë 67%. Aktivët e Qëndrueshme përfaqësojnë aktivet në Komisionin e Prokurimit Publik. Ato janë paraqitur në Bilanc sipas vlerave të regjistruara në kontabilitet të përbëra nga dy grupe: Aktive të Qëndrueshme të Patrupëzuara dhe Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara si vijon:

(në lekë)

A	Aktive të Qëndrueshme	2016	2015
202	Aktive të Qëndrueshme të Patrupëzuara	-	-
	Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara		
210	Toka, Troje, Terrene	-	-
212	Ndërtime dhe konstruksione	-	-
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	-	-
214	Inst. Teknike, mak.& pajisje	861,000	861,000
218	Inventar ekonomik	22,773,889	21,892,529
215	Mjete transporti	-	-



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

219	Amortizimi total	-16,556,274	-14,327,692
232	Investime në proces	-	-
Total AQT		7,078,615.00	8,425,837.00

(në lekë)

Llog	Aktive Qarkulluese	2016	2015
31	Inventari	2,043,636.00	1,812,111.00
4342	Të tjera operacione me shtetin (debitor)	1,803,087.00	1,992,841.00
520	Disponibilitete	17,881,792.00	7,047,702.00
532	Vlera të tjera	-	-
	Total	21,728,515.00	10,852,654.00

Nga auditimi u konstatua se, kemi rritje në total Aktivët Qarkulluese me rreth 10,875,861 lekë për vitin 2016, krahasuar me vitin 2015, kryesisht prej detyrimeve të shtetit për paga dhe sigurime shoqërore në fund të muajit.

Nga auditimi i formatit të Pasivit të Bilancit Kontabël për vitin 2016, u konstatua se, pasivi përbëhet në masën 32% nga Fondet e Veta në vlerën 9.1 milion lekë dhe 68% nga Detyrimet Afatshkurtër në vlerën 19.7 milion lekë.

(në lekë)

Pasive	2016	2015
Fondet e Veta	9,122,251.00	10,237,948.00
Detyrime Afatshkurtër	19,684,879.00	9,040,543.00
Totali i Pasivit	28,807,130.00	19,278,491.00

Në mënyrë më të detajuar në vijim Detyrimet Afatshkurtër për dy vite të njëpasnjëshëm ushtrimorë, të cilat rezultojnë me një rritje prej 10,644,336 lekë .

(në lekë)

Llog	Detyrime Afatshkurtër	2016	2015
401-408	Furnitorë e Llog të lidhura me to	138,088.00	137,614.00
42	Personeli e llog të lidhura me to	1,143,483.00	1,304,879.00
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	131,130.00	135,935.00
4341	Të tjera operacione me shtetin kreditor	3333	-
435	Sigurime shoqërore	311,851.00	359,753.00
436	Sigurime shëndetësore	49,169.00	54,660.00
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	26,033	-
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	-	-
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	17,881,792.00	7,047,702.00
467	Kreditorë të ndryshëm	-	-



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Total Detyrime Afatshkurtër	19,684,879.00	9,040,543.00
------------------------------------	----------------------	---------------------

Nga auditimi i Pasqyrës së Të Ardhura-Shpenzime u konstatua se:

Shpenzimet korrente për Komisionin e Prokurimit Publik janë 24,804,188 lekë, duke reflektuar kështu një ulje me 3.9%, krahasuar me një vit më parë. Kjo ulje vjen kryesisht nga ulja në shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore (-5%), e vijon më pas me rritje shpenzimet për mallra dhe shërbime me (-1%). Pakësimi i pagave lidhet me vakancat e krijuara në institucion gjatë vitit 2016.

(në lekë)

Shpenzime korrente	2016	2015
Paga	17,808,029.00	18,751,902.00
Sigurime	2,740,611.00	2,895,352.00
Mallra dhe Shërbime	4,255,548.00	4,159,242.00
Transferime korrente të brendshme	-	-
Transferime për buxhetet familjarë dhe individë	-	-
Ndryshimi i gjendjeve të inventarit	-231,525.00	-46,755.00
D. Operac/ Korigj rezultati	82,027,688.00	70,307,807.00
Total	106,600,351.00	96,067,548.00

Sa i takon pasqyrës së “Të Ardhura-Shpenzime”, nga auditimi u konstatua se 100% e të ardhurave të Komisionit të Prokurimit përbëhet nga të ardhura nga Buxheti i Shtetit.

(në lekë)

Të Ardhura	2016	2015
Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	-	-
Shërbime adm. e ardhura sekondare	81,792,830.00	70,261,052.00
Të tjera të ardhura jo tatimore	-	-
Grant korent i brendshëm	24,807,521.00	25,806,496.00
Korrigjime nga vitet e kaluara	-	-
Total	106,600,351.00	96,067,548.00

Nga verifikimi i dokumentave justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike e financiare, u konstatua se janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Të gjitha sistemit dhe mbylljet e llogarive vjetore të regjistruara, janë kryer konform udhëzimeve në fuqi. Veprimet kontabile janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Gjatë auditimit të pasqyrës së pozicionit financiar dhe pasqyrës së performancës u konstatua që ato janë llogaritur drejt ku totali i aktivitetit rakordon me totalin e pasivit në pasqyrat financiare përkatëse të vitit 2015 dhe 2016. Nga kontrolli i saktësisë aritmetike të zëravë, nëngrupeve dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

grupeve të llogarive të pasqyrave financiare u konstatua që ato janë të llogaritura saktë dhe nuk ka gabime.

5. Auditimi mbi prokurimin e fondeve publike.

Nga auditimi i prokurimeve publike për vitin 2015, konstatohet se KPP ka realizuar procedura prokurimi “blerje me vlerë të vogël”. Me shkresën nr.114, datë 29.01.2015 ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik, regjistrin e parashikimeve konform afateve ligjore në fuqi dhe me shkresën nr.27, datë 11.01.2016 ka dërguar regjistrin e realizimeve.

Për vitin **2015** janë parashikuar në zërin “investime” 833.333 lekë pa TVSH dhe zërin “shpenzime operative” 4,109,167 lekë pa TVSH. Nga këto, janë realizuar “investime” 96,800 leke me TVSH dhe “shpenzime operative” 2,137,720 lekë me TVSH.

Për vitin **2016**, me shkresën nr.13/1, datë 24.02.2016 është dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik, regjistri i parashikimeve dhe me shkresën nr.72, datë 17.01.2017 regjistri i realizimeve.

Për vitin 2016, janë parashikuar në zërin “investime” 833.333 lekë pa TVSH dhe zërin “shpenzime operative” 4,792,500 lekë pa TVSH. Nga këto, janë realizuar “investime” 482,160 leke me TVSH dhe “shpenzime operative” 1,751,880 lekë me TVSH.

Për vitin **2017**, me shkresën nr.34/1, datë 10.01.2017 është dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik, regjistri i parashikimeve si dhe shtesat me shkresën nr.72/1, datë 9.5.2017 ndërsa me shkresën nr.1463, datë 13.9.2017 regjistri i realizimeve. Për vitin 2017, janë parashikuar (8 mujori) në zërin “investime” 833.333 lekë pa TVSH dhe zërin “shpenzime operative” 3,866,667 lekë pa TVSH. Nga këto, janë realizuar “shpenzime operative” 887,283 lekë me TVSH.

6. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, u krye auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në KPP.

Për të garantuar një menaxhim financiar dhe kontrolli në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe parimet e menaxhimit financiar, me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi, në KPP janë krijuar sisteme kontrolli të brendshme, të cilat janë gjithmonë në përmirësim duke synuar drejt përmbushjes optimale të objektivave. Në vijimësi, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e mjedisit të kontrollit nëpërmjet kontrolleve të drejtpërdrejta dhe raportimet mujore dhe tremujore nga menaxheri i çdo strukture.

KPP, nuk ka të parashikuar në strukturën e vet funksionale si njësi të veçantë auditim të brendshëm.

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Gjetje nga auditimi: KPP në marrjen e vendimit nr. 515, date 31.7.2016, nuk e ka shqyrtuar objektin e ankesës të bërë nga BOE “N. P V” sh.p.k. & “V. I.” sh.p.k. në themel, dhe konkretisht ankimin për “Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e BOE “V.H.” sh.p.k. & “V.E.” sh.p.k., në procedurën e tenderit me objekt “Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga “Elbasan – Banjë” loti i parë, i cili në vijim të procedurës, rezulton të jetë fitues.

Në këtë procedurë tenderi kanë marrë pjesë 4 OE, nga të cilët tre OE të renditur të parët për nga vlera e ofertës ekonomike, janë skualifikuar me të drejtë nga AK (KVO), për shkak të parregullsive/mangësive në dokumentacionin ligjor, kualifikues.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Për këtë vlerësim, BOE “N. P V I” sh.p.k. & “V. I” sh.p.k. është ankuar në KPP.

KPP, ka shqyrtuar ankesën e BOE “N. P V” sh.p.k. & “V. I” sh.p.k. pjesërisht, vetëm për shkaqet e skualifikimit të saj, duke lenë në fuqi vendimin e AK (KVO). Në vijim KPP, nuk ka marrë në shqyrtim pjesën e dytë të ankesës, që ka lidhje me kualifikimin e padrejtë të BOE “V.H.” sh.p.k. & “V.E.” sh.p.k. për shkak se ... *dokumentacioni i tyre ligjor kualifikues, është i shoqëruar me parregullsi/mangësi ...*

Argumentimi i përdorur nga KPP për këtë gjykim është se ... *në kushtet kur edhe pas gjykimit në KPP, operatorët ekonomikë mbeten të skualifikuar, ata në kuptim të ligjit, interesit të tyre të ligjshëm, të drejtëpërdrejtë e real, nuk ka sesi të dëmtohen nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.*

Me këtë arsyetim KPP, nuk e ka marrë në shqyrtim ankesën e që ka bërë BOE “N. P V” sh.p.k. & “V. I.” sh.p.k. për BOE “V.H.” sh.p.k. & “V.E.” sh.p.k, i cili në vijim të procedurës së prokurimit ka rezultuar fitues.

Në përgjithësi arsyetimi/vendimi i KPP, është marrë në kundërshtim me:

- nenin 19/1 “Komisioni i Prokurimit Publik” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin public” I ndyshuar në të cilin është përcaktuar se ...

Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj...

- Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime mbi ankesat e paraqitura para tij, duke mbajtur parasysh, **përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 2, të këtij ligji edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.**

- Nenin 27/2 të VKM nr. 184, datë 17.10.2010 në të cilin është përcaktuar se ... *Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve, apo veprimeve të tjera të AK gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre...*

- nenin 28 pika 1/b, të VKM nr. 184, datë 17.10.2010, në të cilin është përcaktuar se ... *Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar ... Ndalimin e AK të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor... dhe mbështetur në pikën 2/d ... Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë AK për rifillimin e procedurës së prokurimit.*

- Disa nga KVK të përcaktuara në DTS e miratuara nga AK.

Grupi i auditimit verifikoi dokumentacionin ligjor kualifikues të BOE “V.H.” sh.p.k. & “V.E.” sh.p.k., i cili është **i renditur i fundit për nga vlera e ofertës ekonomike** (me vlerë 99,6 për qind të fondit limit) dhe rezultoi se edhe ky subjekt, nuk i plotëson KVK e DST të miratuara nga AK, për rrjedhojë duhet të ishte skualifikuar (Vlen të theksohet se në dosje, në përpjekje nga BOE “V.H.” sh.p.k. & “V.E.” sh.p.k. për të plotëuar kriterin për “punë të ngjashme” të kryera më parë, gjenden një numër i mjaftueshëm dokumentesh që vërtetojnë se OE “V.H.” sh.p.k. kanë manipuluar, abuzuar me dokumentacionin, për të plotësuar këtë kriter padrejtësisht, të cilat KPP duhet t’i kishte evidentuar).

Pasojë e drejtëpërdrejtë e këtij përfundimi do të ishte që të katër operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender, për parregullsi/mangësi të ngjashme, të skualifikoheshin dhe në këtë situatë, ... *KPP duhet të anulonte procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzonte AK për rifillimin e procedurës së prokurimit.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Në kushtet që KPP, nuk e ka shqyrtuar ankesën në themel, me pasojë kualifikimin BOE “V.H.” sh.p.k. & “V.E.” sh.p.k, do të ishte më e pranueshme/arsyeshme që KPP të vendoste për kualifikimin e BOE ankimues “N. P Victoria Invest International” sh.p.k. & “Victoria Invest” sh.p.k. dhe OE e tjerë, me mangësi/parregullsi të ngjashme, që kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlerë më të ulët, e në vijim të procedurës, të përcaktohej OE fitues.

Nën këtë arsyetim, vlera prej 129,749,199 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës ekonomike të paraqitur nga BOE “V.H.” sh.p.k. & “V.E.” sh.p.k, i renditur i fundit dhe ofertës ekonomike të OE “AlbStar” sh.p.k. që është më e ulta, përbën dëm ekonomik të pa arkëtueshëm për buxhetin e shtetit (diferenca në vlerë midis ofertës të BOE ankimues “N. P Victoria Invest International” sh.p.k. & “Victoria Invest” sh.p.k. i renditur i parafundit sipas vlerës së ofruar dhe BOE “V.H.” sh.p.k. & “V.E.” sh.p.k. është 76,981,343 lekë),.

2. Gjetje nga auditimi: Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin nr. 516, date 31.7.2016 nuk ka shqyrtuar çështjen në themel, në tërësinë e objektit të ankesës dhe konkretisht pjesën për “Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “R.spa Albania& E” në tenderin me objekt *“Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga “Elbasan – Banjë”* loti i tretë, i cili në vijim të procedurës, rezulton të jetë fitues.

Në këtë procedurë tenderi kanë marrë pjesë 6 OE, nga të cilët tre nuk kanë paraqitur ofertë në SPE, kurse 2 janë skualifikuar me të drejtë nga AK (KVO), për shkak të parregullsive/mangësive të konstatuara në dokumentacionin ligjor, kualifikues.

Për këtë përfundim/skualifikim, BOE “N.P Victoria Invest International & Victoria Invest është ankimuar pranë KPP-së, i cili e ka shqyrtuar ankesën pjesërisht, vetëm për shkaqet e skualifikimit të BOE, duke lenë në fuqi vendimin e AK (KVO).

Në vijim KPP, nuk ka marrë në shqyrtim pjesën e dytë të ankesës, dhe konkretisht për “Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “R.spa Albania& E”, i cili ka vlerë oferte më të lartë se ankimuesi me arsyetimin se *“... në kushtet kur edhe pas gjykimit në KPP, operatorët ekonomikë mbeten të skualifikuar, ata në kuptim të ligjit, interesit të tyre të ligjshëm, të drejtpërdrejtë e real, nuk ka sesi të dëmtohen nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi”*.

Komisioni në këto kushte ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 19/1, pika 3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” me ndryshime (LPP) dhe nenit 27, 28 të VKM nr.184, datë 17.3.2010.

Nga auditimi i dokumentacionit të këtij bashkimi operatorësh rezulton se operatori R.spa Albania, pjesë e këtij bashkimi operatorësh, nuk plotëson kriterin për *punë të ngjashme*, nuk disponon në pronësi ose me qira *Impiant të prodhimit të bitumit Rubber* etj, duke mos përmbushur kërkesat e Dokumenteve të Tenderit, Kriteret e vecanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3, germa ç.

Në kushte të tilla KPP duhet të kishte skualifikuar të gjithë OE pjesëmarrës, të anulonte procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzonte AK për rifillimin e procedurës së prokurimit. Mos shqyrtimi nga KPP i vendimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, i cili ka kualifikuar padrejtësisht BOE “R” spa Albania, lënia në fuqi e vendimit të saj ka shkaktuar dëm ekonomik të pa arkëtueshëm për buxhetin e shtetit në vlerën 101,181,925 lekë, e cila përfaqëson diferencën në vlerë mes ofertës të shpallur fituese (“R.spa Albania & Everest”) dhe ofertës së ankimuesit “N. P V & V. I.” (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 84-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

3. Gjetje nga auditimi: KKP me vendim nr. 302 datë 6.5.2016, që ka të bëjë me procedurën e tenderit me objekt *“B3- Blerje barna gjaku dhe organet formuese të gjakut për nevoja spitalore”* loti 12 me fond limit 66,152,679 lekë, i zhvilluar në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) në vitin 2016, ka vendosur:

- të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “M” sh.p.k.
- të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “B. A.” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operator ekonomikë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së këtij vendimi, konstatohet se AK (MSH) ka kualifikuar dy OE gjithsej, nga të cilët OE “B.A.” sh.p.k., me ofertë 59,898,804 lekë vend të parë dhe OE “M” sh.p.k, me ofertë 66,141,662 lekë.

MSH në procesverbalet përkatës ka argumentuar hollësisht shkaqet/arsyet e këtij vlerësimi.

Për këtë përfundim të AK, operatori ekonomik “M” sh.p.k, ka paraqitur ankesë në KPP. Objekti i ankesës është që ... *medikamenti i ofruar nga OE “B.A.” sh.p.k, nuk është ai i kërkuar nga AK.*

KPP në vendim, në tejkalim të mundësive/kapaciteteve profesionale (*pasi në përbërje nuk ka specialistë të fushës*), ka arsyetuar se medikamenti i sjellë/ofruar në tender nga OE “B” sh.p.k., nuk është i njëjtë, por është i ndryshëm nga ai i kërkuar/përcaktuar në DST nga AK.

Në argumentet e saj, KPP nuk ka vlerësuar faktin që:

- Autoriteti kontraktor (MSH), nuk shfaqet vetëm në cilësinë e një autoriteti kontraktor në kuptim të ligjit për prokurimin publik, por edhe njëherazi organi më i specializuar në rang vendi për të ofruar një ekspertizë mbi përberësit/efektet e produkteve farmaceutike.
- Në zbatim të nenit 23, pika 3 gërma “b” të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” ... *duhet minimalisht të kërkonte informacion/vlerësim nga ekspertë të fushës nëse produkti i ofruar nga operatori ekonomik “B.A.” sh.p.k. është i njëjtë me produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor etj...*

Rrjedhojë direkte e zbatimit të këtij vendimi të KPP nga AK (MSH) është skualifikimi i padrejtë i OE “B. A.” sh.p.k. me ofertë 59,898,804 lekë i klasifikuar në vend të parë nga AK dhe kualifikimi në vend të parë (e në vijim, shpallja fitues) i OE “M” sh.p.k, me ofertë 66,141,662 lekë, ose 6,242,858 lekë më tepër se sa oferta e OE “B. A.” sh.p.k. e cila nën këtë arsyetim përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi KPP të përbërë nga G. K. kryetar, S. K. zv/kryetar, L. G. dhe H. B. anëtarë

Kësaj vlere i shtohet dhe vlere prej 275,637 lekë që përfaqëson tarifën e pagesës në momentin e bërjes së ankesës nga OE “M” sh.p.k, por që i është kthyer, pasi KPP i ka dhënë të drejtë, duke e çuar vlerën e dëmit ekonomik në **6,518,496 lekë gjithsej.**

Lidhur me sa më sipër, vlen të evidentohet se OE “B.A.” sh.p.k. ka paditur KPP në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me argumentin se e ka skualifikuar padrejtësisht, megjithëse AK (MSH) e kishte kualifikuar dhe shpallur fitues si OE me ofertën me vlerë më të ulët... Gjykata në vendimin e saj nr. 80-2016-5941, datë 9.12.2016, lidhur me ankesën e OE “Biometric Albania” sh.p.k., përmbledhur është shprehur se ... *vendimi i KPP nr. 302, datë 6.5.2016 lidhur me skualifikimin e OE “B.A.” sh.p.k. është “i paligjshëm”.* Megjithëse Gjykata e ka konsideruar të paligjshëm vendimin e KPP për skualifikimin OE “B.A.” sh.p.k, nuk ka vendosur njëkohësisht dhe *“anulimin e kontratës”* së lidhur midis MSH dhe OE “Megapharna” sh.p.k., pasi mbështetur në nenin 64/4 të ligjit nr. 6943, datë 20.11.2006 ... *shqyrtimi i ankesës*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

është bërë, **pasi është lidhur** kontrata midis palëve (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 84-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **6,518,496 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, nga e cila:

- KPP të përbërë nga G. K. kryetar, S. K. zv/kryetar, L. G. dhe H. B. anëtarë, vlera 6,242,858 lekë, ose 1,560,714 lekë/secili, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës ekonomike të OE “B A” sh.p.k. prej 59,898,804 lekë i klasifikuar në vend të parë nga AK, por i skualifikuar nga KPP dhe ofertës të OE “M” sh.p.k. prej 66,141,662 lekë, e cila me vendim të KPP u klasifikua në vend të parë dhe në vijim është shpallur fitues i procedurës së tenderit.
- OE “M” sh.p.k. vlera 275,637 lekë, e cila përfaqëson tarifën e pagesës në momentin e bërjes së ankesës nga OE “M” sh.p.k. por që i është kthyer, pasi KPP padrejtësisht, i ka dhënë të drejtë.

4. Gjetje nga auditimi: KPP në marrjen e vendimit nr. 43, datë 22.01.2016, për tenderin me objekt “*Mirembajtje bazuar ne performance segmentet rrugore Tirane-Ndroq-Romanat etj...*”, nuk është shprehur dhe njëkohësisht nuk ka marrë në shqyrtim si pjesë e dokumentacionit të kërkuar me vendimin e ndërmjetëm nr.11/1, datë 11.01.2016, dokumentin “*Deklaratë*” datë 30.12.2015, të lëshuar nga OE “E” sh.p.k. e cila është pjesë përbërëse njëkohësisht edhe e *Formularit të ankimit të operatorit “A.Sh.” sh.p.k.,* protokolluar në KPP me nr.19, datë 07.01.2016.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 12 OE, nga të cilët 10 janë skualifikuar përfshirë dhe OE “A.Sh.” sh.p.k. i cili ka paraqitur ofertën me vlerë më të ulët prej 31,753,392 lekë.

AK e ka skualifikuar OE “A.Sh.” sh.p.k. me arsyetimin se ... *Operatori ekonomik A.Sh. sh.p.k në përmbushje të shtojcës 7 kriteret e veçanta të kualifikimit/kapaciteti teknik të DT ka paraqitur mjetin Frezë Bitelli sipas kontratës noteriale ... të marrë me qera nga subjekti “K. Albania” sh.p.k, mjet të cilin e ka paraqitur në të njëjtën kontratë subjekti “E” sh.p.k. Bazuar në nenin 65 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Ndërhyrja në Ofertë” OE A.Sh. sh.p.k skualifikohet*”.

Për këtë vlerësim, OE “A.Sh.” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në KPP.

Në formularin ankimit drejtuar KPP-së, OE ankimues “A.Sh.” sh.p.k ka bashkëngjitur dhe dokumentin “*deklaratë*”, sipas të cilit OE “E” sh.p.k. deklaron se ...“heqim dorë nga makineria lloji Frezë Bitelli ... si dhe kontrata e qirasë e lidhur për këtë makineri ... (kontratë me të cilën jemi njohur pas datës së dorëzimit të ofertave)...”.

KPP nuk e ka marrë në shqyrtim si provë këtë deklaratë, edhe pse ajo është paraqitur si pjesë e ankimit, duke lënë në fuqi vendimin e AK.

Ky arsyetim i KPP-së është i gabuar, pasi Operatori ankimues “A.Sh.” sh.p.k. dhe operatori “E” sh.p.k, të cilët në këtë procedurë prokurimi janë paraqitur kontraktues (qiramarrës) të të njëjtit mjet dhe me të njëjtin kontraktor “K. Albania”, nuk kanë qenë në dijeni dhe nuk mund të njiheshin para hapjes së ofertave me dokumentet e paraqitura nga secili, në mënyrë që të ndodhen në kushtet e nenit 53 të ligjit, gjë të cilën e ka pranuar dhe KPP, kur ka arsyetuar vendimin e saj.

Operatorët janë njohur për shkaqet e skualifikimit pas hapjes së ofertave dhe klasifikimit të tyre në sistem, prandaj dhe “deklarata” e cila është bërë pas hapjes së ofertave ka vlerën e provës dhe duhet të ishte marrë në shqyrtim. Pikërisht në këtë fazë, operatori “E” sh.p.k. ka bërë deklaratën e cila është paraqitur si provë nga operatori ankimues bashkëngjitur ankimit në KPP. KPP bazuar në nenin 27, pika 2”Kufijtë e shqyrtimit të ankesës” të VKM nr. 184, datë 17.3.2010 me ndryshime, proceduralisht duhet të kishte marrë në shqyrtim këtë dokument për të cilin dhe duhet të ishte shprehur në vendimin e tij, e merr ose jo në konsideratë. Mosmarrja në shqyrtim e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

këtij dokumenti, bën të pavlefshëm në kuptim të nenit 65 të VKM nr. 914/2014, skualifikimin e ankuesit OE “A.Sh.” sh.p.k. nga KPP.

Nën këtë arsyetim, vlera prej **3,802,163 lekë**, (e cila përfaqëson diferencën midis vlerës së ofertës së operatorit ankimues “A.Sh.” sh.p.k. 31,753,392 lekë dhe vlerës së ofertës të OE të shpallur fituese prej 35,555,555 lekë), përbën dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi, që ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KPP, kurse vlera prej 236,936 lekë e mbajtur “A.Sh.” sh.p.k., e cila përfaqëson tarifën e pagesës për shpenzime procedurale, duhet t’i kthehet këtij OE (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 84-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:

- OE “A.Sh.” sh.p.k., t’i kthehet vlera prej 236,936 lekë, e cila përfaqëson tarifën e pagesës për shpenzime procedurale të kryer prej tij, pasi nga arsyetimet e bëra më lart, rezulton se OE “A.Sh.” sh.p.k., ka pasur të drejtë në ankesën e bërë.

5. Gjetje nga auditimi: KPP në dhënien e vendimit **nr. 112, datë 3.3.2016** lidhur me procedurën e tenderit me objekt *“Sistemimi i mureve në territorin e godinës së HEC dhe asfaltimi i shesheve deri tek rruga për në digë ... në HEC Fierzë”* me fond limit 25,000,000 lekë, procedurë e zhvilluar në datën 15.01.2016 nga autoriteti kontraktor Korporata ElektroEnergjitike Shqiptare Sh.a., nuk ka marrë në shqyrtim në tërësinë e tij, objektin e ankimit të OE “K.Construksio” sh.p.k. dhe konkretisht pjesën e dytë që lidhet me shfuqizimin e vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e OE “PE-VLA-KU” sh.p.k. etj, oferta ekonomike e të cilit është 3,547,129 lekë, më të lartë se sa oferta e ankimesit OE “K.Construksio” sh.p.k.

Në tender ndër të tjerë, kanë marrë pjesë OE “K.Construksio” sh.p.k. i cili ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë më të ulët prej 18,653,631 lekë që është skualifikuar dhe OE “PE-VLA-KU” sh.p.k. me ofertë 22,200,760 lekë, i cili është kualifikuar dhe në vijim është shpallur fitues.

AK (KVO) ka skualifikuar OE “K.Construksio” sh.p.k. me arsyetimin se ... *nuk plotëson kriterin e dokumenteve të tenderit, në faturën e paraqitur nuk është parashikuar fuqia, në dokumentet e tenderit kërkohet në mënyrë taksative 15 KË ... dhe ... për mjetet betonierë të paraqitura, nuk ka deklaruar nëse kapaciteti i tyre është 03m³ deri 05 m³...*

Për këtë vlerësim të AK (KVO), OE “K.Construksio” sh.p.k. ka bërë ankesë në KPP me objekt me shfuqizimin e vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për skualifikimin e tij dhe për kualifikimin e OE “PE-VLA-KU” sh.p.k. etj.

KPP në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “K.Construksio” sh.p.k. me vendim nr. 112, datë 3.3.2016 përmbledhur, ka vendosur që ... *pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron për kriterin “Moto gjenerator me kapacitet 15kva ...” të kërkuar në KVK. Për rrjedhojë skualifikimi i OE “K.Construksio” sh.p.k. ... është i saktë. Në vijim KPP është shprehur se ... për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe ... dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e s’kualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshon në gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrative.*

Me këtë arsyetim KPP, nuk është shprehur për pjesën tjetër të ankesës, atë të kualifikimit të padrejtë të OE “PE-VLA-KU” sh.p.k., për shkak të parregullsive në dokumentacionin ligjor kualifikues.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Në përgjithësi, ky arsyetim/vendim KPP bie ndesh me:

- nenin 19/1 “Komisioni I Prokurimit Publik” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndyshuar.
- Nenin 27/2 të VKM nr. 184, datë 17.10.2010 në të cilin është përcaktuar se ... *Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve, apo veprimeve të tjera të AK gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre...*
- Disa nga kriteret e kërkuar me KVK, shtojca 10, të miratuara me DST nga AK.

Mbështetur në sa më sipër, KPP ka për detyrë minimalisht të shqyrtojë në themel “Ankimimin”, të paktën për OE ankimues dhe OE që rezulton fitues i procedurës së prokurimit.

Grupi i auditimit verifikoi plotësinë/saktësinë e dokumentacionit të paraqitur nga OE “P” sh.p.k. që është shpallur fitues dhe u konstatua se nuk plotëson disa nga kriteret e kërkuar me KVK, shtojca 10, të miratuara me DST më poshtë:

- Nuk ka paraqitur mjetin “kamionçinë 3 deri 5 ton”.
- Mjeti “fadrom” i paraqitur, nuk është i shoqëruar me *leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore, leje transporti*, në kundërshtim me sa është përcaktuar në KVK, për rrjedhojë kriteri është i pa plotësuar.
- Për betonieret e paraqitura, *nuk është deklaruar kapaciteti i tyre*, në kundërshtim me sa është kërkuar në KVK, për rrjedhojë kriteri është i pa plotësuar (për këtë shkak është skualifikuar OE “K.Construksio” sh.p.k.).
- Nuk ka paraqitur “Moto gjenerator me kapacitet 15 kva”. Dokumentacioni shoqëruar i paisjes së paraqitur, nuk vërteton se paisja është “Moto gjenerator me kapacitet 15 kva” (për këtë shkak është skualifikuar OE “K.Construksio” sh.p.k.).

(Për rastin e mjetit “fadrom”, vlen të evidentohet gjykimi/vendimi i KPP nr. 692/2015 datë 16.11.2015, në të cilin OE “Jody company” sh.p.k. është skualifikuar me argumentin se ... *mjeti ekskavator me gomë, nuk është i pajisur me çertifikatën e kontrollit teknik* ... megjithëse oferta e tij ishte më e ulët se sa e OE të kualifikuar nga KPP, i cili në vijim është shpallur fitues i procedurës së prokurimit).

Në vijim KPP, për të ruajtur të njëjtin standard, mbështetur në mangësitë/parregullsitë e dokumentacionin ligjor kualifikues, duhet të skualifikonte të dy OE “K.Construksio” sh.p.k. dhe “P” sh.p.k.

Në kushtet kur KPP, nuk i ka skualifikuar të dy OE, do të ishte më e pranueshme që KPP, të klasifikonte OE “K.Construksion” sh.p.k. i cili ka plotësuar më mirë kriteret dhe ka ofruar çmimin më të ulët.

Nën arsyetimet e mësipërme:

- Vlera prej **3,547,129 lekë** (18,653,631-22,200,760 lekë), e cila përfaqëson diferencën midis fondit limit të ofertës të OE “K.Construksio” sh.p.k. dhe “P” sh.p.k. përbën **dëm ekonomik** dhe ngarkon me përgjegjësi KPP e përbërë nga Kryetar G. K, Zv/kryetar S. K, dhe J. H, L. G, H. B anëtarë.
- Pagesa prej 125,000 lekë, e cila përfaqëson tarifën e paguar si kusht për shqyrtimin e ankesës nga KPP, kryer nga OE “K.Construksio” sh.p.k. është e gabuar (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 84-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

- Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **3,547,129 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, ndaj Komisionit të Prokurimit Publik të përbërë nga G. K. kryetar, S. K. zv/kryetar, L. G. dhe H. B. anëtarë, ose nga 886,782 lekë/secili, e cila është shkaktuar nga mosmarrja në shqyrtim në themel e ankesës së OE “K.Construksio” sh.p.k. nga KPP.
- OE “K.Construksio” sh.p.k. t’i kthehet vlera prej 125,000 lekë, e cila përfaqëson tarifën e pagesës për shpenzime procedurale të kryer prej tij, pasi nga arsyetimet e bëra më lart, rezulton se OE “K.Construksio” sh.p.k. ka pasur të drejt në ankesën e bërë.

6. Gjetje nga auditimi: KPP në marrjen e vendimit nr. 531, datë 13.07.2016 për tenderin me objekt “Blerje Prokate çeliku marka 40 cr dhe 3cr 13”, ka skualifikuar padrejtësisht bashkimin e operatorëve ekonomikë “M&S” sh.p.k. ... me arsyetimin se ... *Dokumentacioni në tërësi i paraqitur nga operatori ekonomik “Senka” sh.p.k si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë “M” sh.p.k dhe “S” sh.p.k nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për furnizimet e mëparshme të ngjashme.*

Ndaj këtij vlerësimi/kualifikimi të bërë nga AK (KVO) operatori “A. Co” sh.p.k., i cili ka vlerën më të lartë të ofertës, është ankuar në KPP.

Vendimi i KPP-së është bërë në kushtet e qëndrimit të dyfishtë të Komisionit krahasuar me marrjen e vendimit nr. 84 datë 19.2.2016.

Në arsyetimin e vendimit nr. 531, datë 13.07.2016, Komisioni, kontratën e paraqitur nga operatori “S” sh.p.k. për “punë të ngjashme”, në të cilën është përfshirë dhe zëri “Fv tub celiku Ø 355.6x7.1mm” në vlerën 29,11,892,629 lekë, nuk e merr në konsideratë edhe pse është një kontratë e llojit për “punë publike”, e cila përmban zërin “furnizim”.

Po t’i referohemi **Vendimit nr.84**, date 19.2.2016 ku objekti i ankimit është i njëjtë me atë të vendimit të mësipërm, sipas të cilit operatori ankimues “Sh” pretendon se ... **OE “S & Co Company” shpk nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik të KVK të DST-ve, kontrata e paraqitur për të përmbushur këtë kriter nuk është kontratë e ngjashme[...]**, Komisioni në arsyetimin e këtij vendimi (**nr.84**, date 19.2.2016) ka pranuar se: “Kontrata e lidhur ndërmjet shoqërisë “S & Co Company” sh.p.k. dhe shoqërisë “Albabras”me objekt “Kontratë shitblerje për mjet ekskavator” e **ka përmbushur kriterin e kualifikimit**”.

Komisioni në këtë rast (vendimi **nr.84**, date 19.2.2016), gjykon se për plotësimin e kriterit për furnizimet e mëparshme, nuk mund të pretendohet për eksperiencë të njëjta, pasi kjo bie në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe me vetë frymën dhe qëllimin e ligjit të përcaktuara në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të këtyre operatorëve ekonomik pjesmarrës në procedurat e prokurimit publik. Ky qëndrim i KPP-së nuk është mbajtur në interpretimin e vendimit 531, datë 13.07.2016.

Siç shihet nga këto praktika, Komisioni mban qëndrime të ndryshme për çështje të njëjta por jo “të ngjashme” duke favorizuar në çdo rast, ofertën me vlerë më të lartë.

Gjithashtu Komisioni nuk ka shqyrtuar çështjen në themel, pasi nuk ka marrë në shqyrtim provat dhe rrethanat e kualifikimit të operatorit ankimues “A. Co” sh.p.k. duke mos i vendosur në pozitë të barabartë të gjithë palët (aktorët), por ka vlerësuar vetëm dokumentacionin e BOE subject i ankimit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 27, pika 2 të VKM nr.184, datë 17.3.2010 me ndryshime. Nga auditimi i dokumentacionit të këtij operatori, rezulton se “Alen Co” në kundërshtim me (DT) pika 2.3, germa a, dhe 2.1, pika b, nuk përmbush kriterin për kontratë të ngjashme, pasi kontrata nuk shoqërohet me vërtetimin e vlerësimit lëshuar nga AK.si dhe katalogu nuk është i përkthyer.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Në kushte të tilla operatori “A. Co” duhet të ishte skualifikuar. Mbajtja e një qëndrimi jo të njëjtë në gjykimin e fakteve të së njëjtës natyrë, ka çuar në skualifikimin pa të drejtë të BOE “M & S” që ka paraqitur ofertën me vlerë më të ulët prej 15,654,000 lekë dhe kualifikimin ankimesit “A. Co” sh.p.k. me vlerë më të lartë 17,945,000 lekë.

Nën këtë arsyetim, diferenca mes këtyre ofertave në vlerën 2,291,000 lekë, plus tarifën për shpenzime procedurale në vlerën 91,850 lekë, e cila i është kthyer ankuesit padrejtësisht, ose vlera prej **2,382,850 lekë gjithsej**, përbën **dëm ekonomik** dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e Komisionit (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 84-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **2,382,850 lekë gjithsej**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyimit, nga e cila:

- KPP të përbërë nga G. K. kryetar, S. K. zv/kryetar, L. G. dhe H. B. anëtarë, 2,291,000 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës ekonomike të “M & S” sh.p.k. prej 15,654,000 lekë i skualifikuar nga KPP dhe ofertës të OE “A. Co” sh.p.k. prej 17,945,000 lekë, i cili për shkak të vendimit të KPP, u klasifikua në vend të parë dhe në vijim është shpallur fitues i procedurës së tenderit.

- OE “A. Co” sh.p.k. vlera 77,500 lekë, e cila përfaqëson tarifën e pagesës në momentin e bërjes së ankesës nga OE “A. Co” sh.p.k., por që i është kthyer, pasi KPP padrejtësisht, i ka dhënë të drejtë.

7. Gjetje nga auditimi: KKP me vendim nr. 84 datë 19.2.2016 lidhur me procedurën e tenderit me objekt “*blerje furgon i blinduar i përdorur (copë 5)*” loti II, me vlerë fond limit 18,600,000 lekë, zhvilluar në vitin 2015 nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare sh.a., nuk ka shqyrtuar në themel ankesën e BOE “S & Co Company” sh.p.k. dhe “Sh” sh.p.k. në lidhje me kualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomikë “AGmbh” sh.p.k. etj, nuk e ka shtrirë atë minimalisht, për OE “S & Co Company” sh.p.k. ankimes, i cili në përfundim të procedurës së tenderit rezulton fitues.,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes, konstatohet se AK ka kualifikuar tre nga katër OE pjesëmarrës në tender, dhe ka shpallur fitues OE “AGmbh” sh.p.k., i cili ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë më të ulët prej 15,468,000 lekë.

Për këtë vlerësim të AK (KVO), BOE “S & Co Company” sh.p.k. i renditur i dyti nga KVO me vlerë të ofertës ekonomike 14,499,000 lekë, është ankuar në KPP, duke pretenduar skualifikimin e OE “AGmbh” sh.p.k., për mosplotësim të kriterëve, pasi ... *nuk ka dorëzuar certifikatë sigurie për gabinën, xhamat si dhe komplet mjetin të miratuara nga një laborator/qendër balistike...* dhe ... *nuk ka dorëzuar katalog.*

KPP pas **shqyrtimit në themel të ankesës**, e ka pranuar atë, duke vendosur/urdhëruar AK, të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e OE “AGmbh” sh.p.k. ... të skualifikojë OE “AGmbh” sh.p.k. duke u shprehur/ mjaftuar për shkakun, vetëm me mosplotësimin e njerit kriter, atë të ... *mosdorëzimit të certifikatës së sigurisë për gabinën, xhamat si dhe komplet mjetin të miratuara nga një laborator/qendër balistike...*

Me zbatimin e këtij vendimi nga AK, fitues rezulton të jetë BOE “S& Co Company” sh.p.k.

KPP, megjithëse në vendim është shprehur për shqyrtim në themel të ankesës, e ka shqyrtuar atë pjesërisht dhe është shprehur vetëm për OE “AGmbh” sh.p.k.

Në përgjithësi arsyetimi/vendimi i KPP, bie ndesh me:

- nenin 19/1 “Komisioni I Prokurimit Publik” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin public” I ndryshuar,

- Nenin 27/2 të VKM nr. 184, datë 17.10.2010 i ndryshuar,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

në të cilin është përcaktuar se ... *Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve, apo veprimeve të tjera të AK gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre...*

- nenin 28 pika 1/b, të VKM nr. 184, datë 17.10.2010,

- kriteret e përcaktuara në “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të shtojcës 8, të miratuar me DST nga AK.

Nga sa më sipër, përfundohet se KPP duhet të shqyrtonte/verifikonte edhe dokumentacionin ligjor, kualifikues të BOE “Si & Co Company” sh.p.k .

Për më tepër, shqyrtimi/verifikimi ka qenë i detyruar të shtrihej për të tre OE, për të qenë në koherencë me vendimin e AK(KVO), i cili i ka kualifikuar, si dhe për faktin që për BOE “S & Co Company” sh.p.k. ka pasur ankesë lidhur me plotësinë/rregullshmërinë e dokumentacionit, nga OE “Sh” sh.p.k.).

Grupi i auditimit verifikoi plotësinë/saktësinë e dokumentacionit të paraqitur nga BOE “S & Co Company” sh.p.k. dhe u konstatua se BOE nuk plotëson kriteret e përcaktuar në KVK e tenderit si më poshtë:

- Nuk ka paraqitur *certifikatë ISO 9001- 2000.*

- Nuk ka paraqitur *për furgonat e blinduar certifikatë sigurie për gabinen xhamat dhe komplet mjetin të miratuar nga qendra e balistikes (si dhe OE “AGmbh” sh.p.k.).*

- Nuk ka paraqitur *katalog për mjetet e blinduara (si dhe OE “AGmbh” sh.p.k.).*

Nga sa më sipër rezulton se të dy OE janë me parregullsi/mungesa në dokumentacion, për këtë shkak, KPP duhet të skualifikonte të dy OE.

Në kushtet kur KPP, nuk i ka skualifikuar të dy OE, do të ishte i pranueshëm vendimi i AK (KVO) për përdorimin e nenit 53 të LPP, për kualifikimin e të dy OE ekonomike dhe shpalljen fitues të OE “AGmbh” sh.p.k, i cili ka ofruar çmimin më të ulët.

Nën arsyetimet e mësipërme:

-Vlera prej 1,609,000 lekë (12.890.000 lekë - 14.499.000 lekë), e cila përfaqëson diferencën midis ofertës të OE “AGmbh” sh.p.k. dhe BOE “S & CO Company” sh.p.k. përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi KPP e përbërë nga Kryetar Gentjan Kërri, Zv/kryetar Spiro Kuro, dhe Juliana Hoxha, Leonard Gremshi, Hektor Balluku anëtarë.

- Vlera prej 77,500 lekë, e cila përfaqëson tarifën e pagesës kusht për shqyrtimin e ankesës nga KPP, e cila duhet t’i mbahet BOE “S & CO Company” sh.p.k.

Shuma e dëmit ekonomik për të dy faktorët është **1,686,500 lekë** (trajtuar më hollësisht në faqen nr. 84-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **1,686,500 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, nga e cila:

- KPP të përbërë nga G. K. kryetar, S. K zv/kryetar, L. G. dhe H. B. anëtarë, 1,609,000 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës ekonomike të OE “AGmbh” sh.p.k. prej 12,890,000 lekë i sklasifikuar nga KPP dhe ofertës të BOE “S & CO Company” sh.p.k. prej 14.499.000 lekë, i cili për shkak të vendimit të KPP, u klasifikua në vend të parë dhe në vijim është shpallur fitues i procedurës së tenderit.

- BOE “S & CO Company” sh.p.k. vlera 77,500 lekë, e cila përfaqëson tarifën e pagesës në momentin e bërjes së ankesës nga BOE “S & CO Company” sh.p.k., por që i është kthyer, pasi KPP padrejtësisht, i ka dhënë të drejtë.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve mbi ankimet e paraqitura pranë KPP-së konstatohet se nuk është krijuar arkivi elektronik për të gjithë dokumentacionin për çdo ankimim, në përputhje me rregullat mbi arkivat bazuar në kërkesat e nenit 32 të VKM nr.184,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

datë 17.3.2010 “Për miratimin e për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik dhe për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 659, datë 3.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, me mjete elektronike”.

Rekomandimi:

KPP të marrë masa për krijimin e arkivit elektronik të dosjeve për çdo ankimim, me qëllim sigurimin e transparencës në procesin e administrimit të dosjeve. Për një gjykim në themel, dhe për të lënë gjurmë për mënyrën shqyrtimit, dokumentacioni shoqëruar i ankesës së OE të shoqërohet detyrimisht me CD, e cila të përmbajë material të plotë jo vetëm për OE ankues, por për të gjithë OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Pjesë e dosjes të bëhet dhe vendimi i gjykatës, nëse çështja ka kaluar për gjykim. Në vijim, inspektorët që përgatisin dosjen të lenë gjurmë dhe të mbajnë përgjegjësi për plotësinë e dokumentacionit të ankesës (*trajtuar më hollësisht në fq---- të Projektraportit*).

IV. Konkluzione dhe opinioni i auditimit.

IV.1. Mbi sigurimin e mbikqyrjes së zbatimit të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik në tërësi, si dhe respektimin e procedurave ligjore nga ana e autoriteteve kontraktore, konform ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Baza për opinionin për ligjshmërinë dhe përputhshmërinë e vendimeve të KPP-së janë ISSAI 4100 dhe 4200.

Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Komisioni i Prokurimit Publik, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë **dhënien e opinionit të kualifikuar**.

1. ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështjeje të veçanta.

2. Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti; Komisioni i Prokurimit Publik, të ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatuan devijime materiale të shkaktuara nga vendimmarja e KPP në fushën e prokurimeve publike të shoqëruara me dëm ekonomik në vlerën **248,868,262 lekë gjithsej**, nga i cili 234,733,287 lekë i pa arkëtueshëm dhe 14,134,976 lekë i arkëtueshëm, për të cilin do të kërkohet të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i tij, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyimit.

Nga auditimi i vendimeve të KPP me zgjedhje rastësore, rezultoi se KPP në përgjithësi gjatë shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë, megjithëse është shprehur për shqyrtimin e tyre në themel, në fakt është shprehur vetëm pjesërisht për objektin e ankesës së operatorëve ekonomikë ankimes.

Si rregull, KPP ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në rastet kur OE ankimues është me ofertë me vlerë më të ulët nga OE të tjerë, por i skualifikuar nga AK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

Element i përbashkët në këto vendime është se, si në rastet kur është ankuar OE me vlerë të ofertës ekonomike më të ulët, ashtu dhe në rastet që është ankuar OE me vlerë më të lartë të ofertës ekonomike, gjithmonë fitues ka rezultuar OE me vlerë më të lartë.

Përgjithësisht arsyetimi i KPP, për mosshqyrtimin në themel të ankesave të OE të skualifikuar, të cilët si rregull kanë ofruar vlerën më të ulët, është se në kushtet kur edhe pas gjykimit në KPP OE mbeten të skualifikuar, ata *në kuptim të ligjit, interesit të tyre të ligjshëm, të drejtpërdrejtë e real, nuk ka sesi të dëmtohen nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.*

Me këtë argument KPP, nuk i ka marrë në shqyrtim ankesat që kanë bërë OE të skualifikuar për OE që në vijim të procedurës së prokurimit kanë rezultuar fitues, por që janë vënë në dijeni prej ankimuesve se dokumentacioni i tyre ligjor kualifikues i këtyre OE, është i shoqëruar me parregullsi/mangësi, në dokumentacionin ligjor kualifikues.

Mos shqyrtimi i ankesës në themel, ka krijuar premisa për vendimarrje jo të sakta nga KPP, të cilat kanë çënuar përzgjedhjen e OE fitues të kontratave publike në përputhje me parimet e përgjithshme të përzgjedhjes, shpeshherë të shoqëruara më dëm ekonomik.

Në përgjithësi arsyetimi/vendimi i KPP, është marrë në kundërshtim me:

- nenin 19/1 “Komisioni i Prokurimit Publik” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin public” I ndyshuar në të cilin është përcaktuar se ...

Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj...

- Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime mbi ankesat e paraqitura para tij, duke mbajtur parasysh, **përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 2**, të këtij ligji edhe parimet e mëposhtme: **paanshmërinë** në shqyrtimin e ankesave, **qëndrueshmërinë** në vendimarrje, **ligjshmërinë**, **shpejtësinë** dhe **efiçencën**, **aksesin**, **karakterin publik**, si edhe parimin e kontradiktoritetit.

- Nenin 27/2 të VKM nr. 184, datë 17.10.2010 në të cilin është përcaktuar se ... Përgjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve, apo veprimeve të tjera të AK gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre...

- nenin 28 pika 1/b, të VKM nr. 184, datë 17.10.2010, në të cilin është përcaktuar se ... Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar ... Ndalimin e AK të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor... dhe mbështetur në pikën 2/d ... Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë AK për rifillimin e procedurës së prokurimit.

- Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DST e miratuara nga autoriteti kontraktor, për çdo tender.

IV. 2. Opinion me siguri të arsyeshme “Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit”.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2016, konkludojmë se llogaritë vjetore paraqesin drejt, në të gjithë aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit, rezultatet e operacioneve të tyre dhe flukseve monetare, në përputhje me dispozitat ligjore, që justifikojnë dhënien e opinionit me siguri të arsyeshme.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK”, TIRANË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Tabela e Shkurtimeve

Nr.	Shkurtimi	Emërtimi i Plotë
1.	KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
2	KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
3	M T I	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
4	AK	Autoriteti kontraktor
5	KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
6	SH A	Shoqëri Anonime
7	VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
8	INSTAT	Instituti i Statistikës
9	DST	Dokumente Standarde të Tenderit
10	APP	Agjencia e Prokurimit Publik
11	LPP	Legjislacioni i Prokurimit Publik
12	OE	Operator ekonomik
13	BOE	Bashkim i operatorëve ekonomikë
14	KVK	Kriteret e Veçanta të Kualifikimit
15	Sh.p.k.	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar